



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.07.2016, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi nen per nen i projektligjit “Per organizimin dhe funksionimin e institucioneve per te luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Vexhi Mucmataj.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu, Spartak Braho.

Të ftuar:

John Smibert – ekspert i Nivelit te Larte, përfaqësues i misionit të OPDAT-it në Shqipëri

Artan Hoxha – ekspert i Nivelit te Larte

Korajlka Bumçi - eksperte e Nivelit te Larte, përfaqësuese e misionit të EURALIUS-it në Shqipëri

Arben Rakipi - ekspert i Nivelit te Larte

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar me projektligjin “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”. Ky është projektligji që kemi në rendin e ditës. Kemi bërë seancën e paraqitjes së projektit, pyetje-përgjigje, vlerësimi i relatorit si dhe diskutime. Pra, kemi konsumuar debatin mbi procesin e debatit në parim, gjithashtu kemi edhe votimin në parim. Dakord? Dakord Ulsi?

Faleminderit!

Do fillojmë diskutimin nen për nen në bazë të votimit në parim. Nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë, të cilët kanë punuar me këtë projektligj të rëndësishëm janë të pranishëm zoti Smibert, që njëkohësisht është bashkëkryetar i këtij grupi pune, njëkohësisht dhe përfaqësuesi i OPDAT, zoti Hoxha i cili është bashkëkryetar i grupit të punës për drejtësinë penale, zonja Bumçi, eksperte e nivelit të lartë në grupin e ekspertëve, por njëkohësisht edhe përfaqësuese e misionit të Euralius, e përfshirë në këtë proces lidhur me këtë projektligj si dhe zoti Rakipi, ekspert i nivelit të lartë. Gjithashtu, për të ndjekur procesin janë të pranishëm edhe përfaqësuesit e sekretariatit teknik, kështu që mund të fillojmë.

Relatori të ndjekë... Keni një tabelë?

Ulsi Manja - Po.

Fatmir Xhafaj - Atëherë do të punoni së bashku me zonjën Hysi? Dakord.

Zonja Hysi është si pedagoge e të drejtës penale apo si....?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord.

Atëherë fillojmë.

Neni 1 “Objekti i ligjit”.

Vasilika Hysi – Nuk ka asnjë problem lidhur me përmbajtjen e nenit 1 deri te pika e gjashtë, dhe për të shmangur përsëritjet e fjalëve ne sugjerojmë një riformulim. Nëse ekspertët

janë dakord sipas propozimit të bërë në kolonën ku flitet për ndryshimet e propozuara, kjo pasi pika 2, 3 dhe 4 flasin për të njëjtën gjë, për kritere që duhet të përmbushin prokurorët, oficerët dhe punonjësit e njësive të pavarura si edhe punonjësit në gjykatat kundër korrupsionit, kurse pikat e tjera duhet lënë siç janë, sepse kanë tjetër objekt. Pra, është thjesht riformulim.

Fatmir Xhafaj - Dakord. Faleminderit!

Neni 2 “Qëllimi i prokurorisë së posaçme”.

Vasilika Hysi - Te neni 2 janë dy fjalë për të cilat dua mendimin e ekspertit nëse duhen lënë apo jo. Ne mendojmë që te shprehja “hetim i çështjeve të vështira”, fjala “e vështirë” të hiqet, pasi qëllimi i prokurorisë së posaçme është që të hetojë çdo vepër penale që lidhet me korrupsionin dhe krimin e organizuar, si dhe kategorinë e veprave penale të kryera nga një grup zyrtarësh dhe ish-zyrtarësh. Gjithashtu, kur thuhet ndikimi i brendshëm dhe i jashtëm i papërshtatshëm, sugjeroj që fjala “i papërshtatshëm” të mos jetë, sepse të gjitha ndikimet nga jashtë sistemit nuk lejohen. Si ndikimi i brendshëm ashtu dhe i jashtëm nuk duhet të jenë, sepse është e vështirë të thuhet që e bëra ndikimin në mënyrë të përshtatshme apo të papërshtatshme, kjo sepse pastaj hyjmë në një subjektivizëm, dhe ne duhet të shmangim çdolloj ndikimi.

Fatmir Xhafaj - Ku është kjo?

Vasilika Hysi - Te neni 2, ku thuhet që qëllimi...

Fatmir Xhafaj – Për fjalët “ të vështira” dhe “i papërshtatshëm”?

Vasilika Hysi - Po.

Fatmir Xhafaj - Po. Dakord?

Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Rakipi.

Arben Rakipi - Mbase fjala “ i papërshtatshëm” mund të zëvendësohet me fjalën “i paligjshëm”.

Fatmir Xhafaj – “I papërshtatshëm” me “të paligjshëm”?

Arben Rakipi - Ky është kuptimi që është dashur të thuhet me fjalën “i papërshtatshëm”, sepse ndikim të jashtëm do të ketë, për sa kohë ne kemi lejuar udhëzime të marra nga titullarët...

Vasilika Hysi - Dakord.

Fatmir Xhafaj - Po, ka të drejtë.

Faleminderit! Dakord.

Vasilika Hysi – Mund të bëj edhe një pyetje zoti kryetar?

Fatmir Xhafaj – Te neni 2 apo neni 3?

Vasilika Hysi – Te neni 2. Te neni 2 dhe 3 ju keni përdorur termin “qëllimi i prokurorisë së posaçme dhe qëllimi i njësive të pavarura”. Në fakt, këtu nuk del qëllimi i prokurorisë, por ndoshta është që qëllimi i këtij ligji është që të krijojë struktura të tilla, të cilat do të hetojnë në mënyrë të përgjegjshme dhe të specializuar çështjet e korrupsionit dhe krimin të organizuar. Kur flasim për objektin e ligjit, duhet të flasim edhe për qëllimin e tij, por jo për qëllimin e organeve, sepse në fund të fundit organet krijohen për të përmbushur një qëllim të caktuar.

Cili është qëllimi i këtij ligji në rastin konkret? Qëllimi është që të kemi hetim, procedim, ndjekje të çështjeve të korrupsionit dhe krimin të organizuar, si edhe krimeve të kryera nga kategoria e zyrtarëve dhe ish-zyrtarëve, në mënyrë sa më efektive, dhe jashtë çdo ndikimi të paligjshëm i brendshëm apo i jashtëm. Nëse do të pranojmë që ta quajmë këtë si qëllim të ligjit, neni 2 dhe 3, për shkak se ka përsëritje të fjalëve, mund të bashkohen bashkë.

Fatmir Xhafaj - Më mirë le të jenë të ndarë për të përcaktuar dhe për të qenë më të qartë...

Vasilika Hysi – Është e njëjta fjalë.

Fatmir Xhafaj – Pavarësisht se është e njëjta fjalë, për ta definuar më qartë, të paktën unë e kuptoj nga pikëpamja e teknikës legjislative, do të ishte më e mirë kjo që thoni ju, por duke qenë se këtu kemi prokurorinë e posaçme dhe njësinë hetimore, ka një kakofoni mbi këto që quhen struktura antikorrupsion, dhe mund t’i bashkojmë bashkë. Çështja është për të krijuar një lloj perceptimi edhe mbi to, sepse është e rëndësishme që edhe ligji...

Vasilika Hysi - Po, por nëse do isha unë ajo që e ka formuluar, do thosha se qëllimi i këtij ligji, është krijimi i prokurorisë dhe i njësive hetimore, të cilat do të sigurojnë hetimin, dhe ndjekjen penale në mënyrë sa më efektive të çështjeve të korrupsionit, krimin të organizuar si dhe krimeve të kryera nga një kategori e caktuar zyrtarësh dhe ish-zyrtarësh, në mënyrë të pavarur nga çdo ndikim i paligjshëm, i brendshëm ose i jashtëm. Në këtë mënyrë i ke që të dy nenet, sepse i vetmi ndryshim, zoti kryetar, është fillimi i fjalisë së parë, “qëllimi i njësisë së pavarur hetimore dhe qëllimi i prokurorisë së posaçme”. Si të duan, sepse unë prandaj thashë që ka dy variante, që të lihen siç janë ose...

Fatmir Xhafaj - Zoti Hoxha, keni ndonjë koment për këtë?

Artan Hoxha - Shprehja “ të një prokurorie të përgjegjshme” nuk shkon, sepse duket sikur pjesa tjetër e prokurorisë nuk është e përgjegjshme. Kështu që, duke hequr këtë përcaktim, me atë riformulim unë mendoj se shtënë rregull, sepse ky është edhe qëllimi ynë .

Fatmir Xhafaj – Të jenë të ndara?

Artan Hoxha - Për mua të jenë të ndara, sepse janë dy struktura që edhe Kushtetuta i ka veç e veç.

Fatmir Xhafaj - Dakord edhe me nenin 3.

Vasilika Hysi - Po qëllimi i ligjit cili është?

Artan Hoxha - Krijimi i këtyre strukturave.

Vasilika Hysi – Edhe funksionimi.

Fatmir Xhafaj - Neni 4 “Struktura e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar”.

Ulsi Manja - Dakord me nenin 4.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 5 “Prokuroria e posaçme”.

Vasilika Hysi - Në nenin 5 kemi vetëm një riformulim të paragrafit të dytë që është sipas tabelës. Këtu kam një pyetje për ekspertët. Në nenin 2, ne themi që qëllimi i prokurorisë së posaçme është që të hetojë, ndërkohë në nenin 5...

Fatmir Xhafaj - Jo, qëllimi është që të ushtrojë ndjekjen penale.

Vasilika Hysi - Jo, është për të hetuar dhe ndjekur penalisht.

Fatmir Xhafaj – Po, neni 5.

Vasilika Hysi- Në nenin 5 nuk thuhet hetim, por thuhet që kryen ndjekjen penale. Do ta unifikojmë terminologjinë?

Fatmir Xhafaj - Dakord, por kam përshtypjen se është kur flitet për të dyja strukturat, megjithatë...

Vasilika Hysi - Jo, është prokuroria e posaçme.

Fatmir Xhafaj - Dakord. Ka ndonjë gjë për këtë apo janë normale?

Jon Smibert – *(Përkthen përkthyesja)*. E di që dje ne folëm nëse duhet të themi që hetimi duhet t’i kalojë prokurorisë, por nuk e mbaj mend mirë se çfarë vendosëm që të kishim të unifikuar, ta ruanim si ndjekje penale apo si hetim.

Fatmir Xhafaj - Ndjekje penale, duke qenë se e përfshinë brenda ligjit “Për prokurorinë”, kështu që edhe këtu do ta lëmë kështu apo jo? Dakord zoti Hoxha, sepse kështu e lamë, apo jo?

Faleminderit! Vetëm me paragrafin e dytë, me korrigjimin që keni si ide.

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni?

Artan Hoxha – Fjala “kryen” mund të zëvendësohet me fjalën “ushtron” ndjekjen penale.

Vasilika Hysi - Po ke të drejtë “ushtron”.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Moza, i mbani shënim?

Faleminderit!

Miratohet me ndryshimet e bëra.

Neni 6 “Byroja Kombëtare e Hetimit”.

Ulsi Manja - Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 7 “Juridiksioni kombëtar”.

Ulsi Manja – Për nenin 7 ka një riformulim. Pa prekur thelbin e përmbajtjes që ka ky nen, propozojmë që të hiqet fjala “gjithashtu” si dhe shprehja “për të përmbushur qëllimin e saj”, sepse duken si fjalë “parazite” në formulimin e këtij neni.

Fatmir Xhafaj - Dakord.

Ulsi Manja - Pra fjalia: “Gjithashtu, Byroja Kombëtare e Hetimit mund të krijojë zyra të përkohshme apo të përhershme jashtë Tiranës për të përmbushur qëllimin e saj”, ne propozojmë të thuhet: “Byroja Kombëtare e Hetimit, mund të krijojë zyra të përkohshme ose të përhershme jashtë Tiranës”.

Fatmir Xhafaj - Dakord. Miratohet me ndryshimin e bërë.

Artan Hoxha - Fjalia, “në të gjithë Shqipërinë”, mund të thuhet “në gjithë territorin”

Fatmir Xhafaj - Dakord, por po thashë miratohet, të lutem..

Vasilika Hysi – Në fakt ka të drejtë.

Fatmir Xhafaj - Si?

Artan Hoxha - Kur thuhet në të gjithë Shqipërinë, mund të thuhet në të gjithë territorin.

Vasilika Hysi - Ke të drejtë.

Artan Hoxha - Pra ka juridiksion në të gjithë territorin.

Fatmir Xhafaj - Juridiksioni është territorial, nuk është...

Artan Hoxha - Meqenëse edhe titulli është juridiksion, të mos përdoret fjala kompetencë, por fjala juridiksion.

Vasilika Hysi - Po, ke të drejtë.

Fatmir Xhafaj - Dakord. Shumë faleminderit, si zotit Hoxha ashtu edhe relatorëve! Miratohet me ndryshimet dhe redaktimet e nevojshme.

Neni 8 “kushtet e sigurisë së paracaktimit në detyrë apo emërimi”.

Vasilika Hysi – Në këtë nen ka vetëm redaktime, të cilat ne i kemi dhënë në tabelë thjesht për të unifikuar gjuhën. Lidhur me kushtet e sigurisë së paracaktimit në detyrë, të emërimit të kandidatëve për gjyqtarë apo të personave të tjerë, nuk kemi asgjë. Paragrafët janë pak të gjatë, por mund të lihen edhe kështu siç janë, pasi është shumë domosdoshme që të jetë e qartë se si janë vendosur. Nëse ekspertët janë dakord me riformulimin, për ta unifikuar me të gjithë ligjin në mënyrë që të mos e përsërisim më, unë kam një pyetje në parim. Afatet do t'i japim në muaj apo në ditë? Nëse themi një herë brenda katër muajve, dhe më pas themi brenda 90 apo 300 ditëve, është mirë që t'i unifikojmë në një, por nuk e di se cili është interesi. Në përgjithësi, në rastet e ankimit ne kemi përdorur afatet me ditë, sepse janë afate të shkurtra, kurse kur flitet për periudha të gjata, kemi përdorur afatet me muaj. Në rast se biem dakord për një nga variantet, ekspertët e sekretariatit teknik i pasqyrojnë dhe ne nuk ndalemi në rastet e tjera.

Fatmir Xhafaj - Po.

Jon Smibert - (*Përkthen përkthyesja*) Cilido qoftë versioni më i përshtatshëm për teknikën tuaj legjislative, sepse edhe në Shtetet e Bashkuara ne përdorim ditët dhe pastaj muajt për periudhat më të gjata.

Fatmir Xhafaj – Dakord me nenin 8? Zoti Hoxha, zoti Rakipi janë dakord me ndryshimin. Neni 9, “Përkufizimet”.

Vasilika Hysi –Lidhur me nenin 9, te përkufizimet, përveç aspektit të parë, renditja sipas gjuhës, kemi bërë disa heqje të fjalëve, të cilat janë të tepërta, për shembull, marrim paragrafin e parë termi, “gjyqtar” nënkupton çdo person që shërben si gjyqtar në gjykatën e Shkallës së parë, gjykatën e apelit, gjykatën administrative, gjykatën e lartë, gjykatën e lartë administrative, si dhe në Gjykatën Kushtetuese. Pra, mendojmë që të hiqen shprehje të tilla, për qëllim të juridiksionit të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, sepse i gjithë ligji për këto lloj gjykatash flet, pra flet për gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe, përderisa në fjalinë e parë themi se “në kuptim të këtij ligji termat e mëposhtëm kanë këtë

kuptim”, kuptohet që flasim për këtë lloj juridiksioni. E njëjta gjë është edhe për paragrafin e dytë.

Kam një pyetje lidhur me nenin 3, “anëtarët e afërt të familjes”. Ju thoni që anëtari i afërt i familjes do të jetë ai që banon më shumë se 60 ditë në të njëjtin vendbanim. Kur thoni që banon më shumë se 60 ditë në të njëjtin vend, janë edhe persona të cilët nuk përfshihen te bashkëshorti dhe fëmijët, pra janë persona të tjerë të lidhur, që vijnë jetojnë dy muaj në vit, me ndërprerje, pa ndërprerje, është një çështje që duhet ta sqarojmë, apo bëhet fjalë për kategori të tjerë personash? Kjo është e rëndësishme, sepse lidhet edhe me dhënien e pëlqimit për autorizimet e të tjerë.

Fatmir Xhafaj – Po. Zoti Smibert.

Jon Smibert – *(Përthën përthyesja)* Disa familje mund të kenë kushërinj, nipër të tjerë, që jetojnë në shtëpi dhe duke qenë se ata vijnë nga larg, nga Italia për shembull, qëndrojnë për pak kohë aty. Qëllimi është që të përfshihen me pjesëtarët e tjerë të familjes. Nëse përdorim termin 60-ditor, kuptohet që njerëzit janë aty për një periudhë të shkurtër kohe, thjesht si vizitorë në familje, domethënë bëhet diferenca.

Fatmir Xhafaj – Atëherë, miratohet me ndryshimin. Po, zoti Rakipi.

Arben Rakipi – Thjesht për të saktësuar pikën dy. Në këtë pikë flitet për prokurorinë e shkallës së parë, të Apelit dhe prokurorin e Përgjithshëm. Që të mos kemi keqkuptime, mund të thuhet dhe “Prokurorinë e Përgjithshme”? Sepse kjo duket shumë individuale dhe lë shijen sikur përjashton prokurorët e asaj strukture.

Vasilika Hysi – Po, ke të drejtë, ka edhe prokurorë në Prokurorinë e Përgjithshme, nuk është vetëm prokurori i Përgjithshëm.

Fatmir Xhafaj – Ku?

Vasilika Hysi – Te pika 2 në fund.

Fatmir Xhafaj - Këtu duket sikur është për një individ, në fakt, i nënshtrohen të gjithë prokurorët, edhe prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alba Ibrahim – Ky ka qenë qëllimi, që të jenë prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme.

Ulsi Manja – Kam një pyetje për të marrë një sqarim lidhur me përkufizimet.

Për të bërë dallimin e oficerëve të seksionit të Policisë Gjyqësore me oficerët e shërbimeve, kam përshtypjen se është dhënë përkufizimi i termit "hetues", sepse në vazhdim oficerët e seksionit do të jenë hetues. A është përdorur në të gjithë ligjin termi "hetues" kur flitet për oficerët e seksionit? Mos do të ishte më mirë të flitet kudo për seksionin e BKH-së? Në të gjithë ligjin për të bërë dallimin nga oficerët e shërbimit, përdorim termin "hetues".

Jon Smibert - (*Përkthen përkthyesja*) Mendoj se termi "hetues" përdoret për të bërë dallimin ndërmjet atyre personave që punojnë drejtëpërdrejt me BKH-në, të cilët do të marrin trajnimin e veçantë për këtë gjë dhe çdo gjë tjetër. Këta persona dallohen nga ata që janë në shërbim, të cilët do të jenë oficerët e Policisë Gjyqësore, sepse ju keni nevojë për të bërë një dallim në ligj, me qëllim që të emërtojmë ata persona që kanë nevojë të jenë subjekt i këtyre kushteve të veçanta.

Vasilika Hysi – Unë kisha një koment për pikën pesë, por, meqenëse kolegu Manja kaloi te pika shtatë, po mbetem te kjo pikë. Unë jam dakord me përkufizimin që bëhet për hetuesit dhe në ligj është shumë e qartë që ata janë punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, të cilët janë përgjegjës për hetimin e veprave penale, por dy fjalitë e tjera, ku thuhet se hetuesit gëzojnë statusin e oficerit të Policisë Gjyqësore, por kontrollohen nga prokurorë të posaçëm, oficerët e shërbimit të policisë gjyqësore nuk gëzojnë titullin hetues, unë do të sugjeroja të ishin në tekst, pra të mos ishin te përkufizimet, por të ishin te teksti në dispozitat përkatëse, është pjesë shumë e rëndësishme që flet për statusin dhe nuk është përkufizim, por sqaron pozitën e tyre. Pra, unë mendoj të lihet pika shtatë, që hetuesit nënkuptojnë punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, të cilët janë përgjegjës për hetimin e veprave penale, ndërsa dy fjalive të tjera t'i gjejmë vendin te nenet ku flitet për Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe statusin e këtyre punonjësve. Përkufizimet synojnë të sqarojnë terma që nuk njihen, ndërsa këtu qëllimi nuk është që me dy fjalitë që ju keni futur të sqarojmë se kush është hetues, këtu flitet për statusin e tyre dhe statusi i tyre do të jetë në pjesën reale të përmbajtjes së ligjit. Gjithashtu, për pikën 5, kur flitet për veprat penale të lidhura ngushtë me çështjen dhe vepra të lidhura me hetimin, cili është dallimi mes tyre?

E dyta, a është e mundur që fjalët "shkelje penale" të zëvendësohet me fjalët "veprime ose mosveprime penale të kryera me qëllim për përgatitjen, mbështetjen e të tjerë".

Pyetjen e tretë e kam përsëri për këtë paragraf. Kur themi "përgatitje", ne në Kodin Penal nuk dënojmë çdo lloj përgatitje për të gjitha veprat penale, por për një kategori të caktuar

veprash penale. Në rastin konkret, këtu do të kriminalizojmë çdo veprim dhe mosveprim, që synon përgatitjen për një vepër penale, edhe atëherë kur nuk në Kodin Penal përgatitja nuk dënohet?

Gjithashtu, lidhur me të gjithë pikën 5 do të kërkoja një riformulim, pasi pjesën e dytë të fjalisë, ku thuhet “për çdo hetim, ose ndjekje penale të çështjes në gjykatë”, unë personalisht nuk arrita ta formuloja, sepse nuk e kuptoja, por besoj se ideja duhet të jetë që këtu përfshihen veprat që kanë të bëjnë me kanosjen e dëshmitarëve të viktimës, gjyqtarit, prokurorit, hetuesit, punonjësve, ose shkatërrimin e provave, në qoftë se e kam kuptuar qartë. Këto janë çështjet për pikën 5, kjo pikë është shumë e rëndësishme për të kuptuar më pas të gjithë përmbajtjen e ligjit.

Fatmir Xhafaj – Ka nevojë për t’u riformuluar dhe për të dalë qëllimi më i qartë, sepse nuk arrijmë dot ta kuptojmë, se për kë bëhet fjalë, për pjesën që është te gjykata, apo pjesën që ka të bëjë me prokurorinë. Është pak konfuze. Qëllimi është aty, por në teknikë legjislative ka nevojë të përpunohet.

Po, zoti Smibert!

Jon Smibert — *(Përkthen përkthyesja)* Sigurisht që për mua është e qartë në anglisht, por qëllimi i kësaj është thjesht që të përkufizojmë që ne, kur flasim për vepra penale, që janë të lidhura ngushtë me çështjen apo hetimin, është diçka që është çuar në gjykatë, ose është akoma nën hetim, ky është kuptimi. Ju keni veprime qendrore, kriminale, të cilat SPAK-u është përgjegjës dhe janë pjesë e juridiksionit të tij. Për sa i përket juridiksionit dytësor, që është i nevojshëm për veprat e tjera penale, të cilat mund të bëjnë të mundur këto vepra penale, mund të mbështesin këto vepra penale, ose mund të kryhen gjatë kohës së përgatitjes së kësaj vepre penale. Nuk është për të kriminalizuar çfarëdo gjëje, por kuptimi është për të thënë që juridiksioni është për këtë gjykatë, veçanërisht për ato gjëra, si për shembull prishja e provave, apo çdo veprim kundër dëshmitarit, kur kemi çështje të korrupsionit, një dëshmitar, apo një person që mundohet ta mbulojë këtë, atëherë është pjesë e juridiksionit të kësaj, sepse këtu po parandalohet fshehja e kësaj shkelje ligjore. Gjithashtu, nëse ti do të ishe duke hetuar një çështje të krimit të organizuar në nivel ndërkombëtar, ndërkohë që ti po e përgatit çështjen, atëherë ju mund të kryeni edhe veprën penale të pastrimit të parave, edhe kjo mund të jetë një shkelje. Ne mund ta shikojmë dhe ta riformulojmë këtë, mund të ulemi së bashku me zonjë Hysi dhe të punojmë për riformulimin e saj.

Fatmir Xhafaj – Është i qartë dhe këtu nuk duhet kompetenca kryesore e gjykatave, ka juridiksionin.

Vasilika Hysi – Zoti Rakipi ka koment për këtë.

Fatmir Xhafaj – Ta bëjmë “juridiksioni gjykata kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar” dhe paragrafi i dytë ka nevojë për riformulim. Për mua paragrafi i parë është shumë i qartë, e nxjerr qartë kuptimin se çfarë keni dashur të thoni me konceptin “vepra penale të lidhura ngushtë me çështjen apo hetimin”. Paragrafi i dytë ka nevojë për t’u qartësuar se për cilën fazë bëhet fjalë.

Zoti Rakipi.

Arben Rakipi – Unë i mbajta shënim çështjet që ngriti deputetja Hysi dhe thashë t’i marr me radhë. “Vepra penale të lidhura”, në përmbajtje u kuptuam që është e qartë.

Fatmir Xhafaj – Si paragrafi i parë, ashtu edhe i dyti janë të qartë, por do riformulim, thjesht zhvendoset fjalia dhe duhet ta bëni ju.

Arben Rakipi – Në të dy paragrafët është e njëjta gjë, në koncept ndoshta ka nevojë për një shqipërim të mirë. Dua të heq shqetësimin e deputetes kur thotë “përgatitja”. Këtu bëhet fjalë për veprën “mjet me qëllim” dhe bëhet fjalë për veprën e parë mjetin, i cili nuk është në kompetencë e listuar të kësaj gjykate, por që po shërben për të bërë një vepër, e cila është në kompetencën e kësaj gjykate dhe në këtë rast të dyja futen në kompetencën e kësaj gjykate. Nuk është thjesht çështja e përgatitjes, por është vepra “mjet dhe qëllim”. Pika e dytë, ndoshta do një kryefjalë, por në thelb bëhet fjalë për të njëjtën gjë, që çdo gjë që lidhet me këtë vepër i bashkohet kësaj gjykate.

Fatmir Xhafaj – Shumë mirë që e sqaruam, që të jetë nesër në zbatim, e kemi për rekorde, por kjo duhet qartësuar në riformulim.

Po, zoti Manja.

Ulsi Manja – Për ta bërë të qartë dallimin, kur flitet për përgatitjen, nuk bëhet fjalë për përgatitjen si element përbërës i veprës penale të korrupsionit, por për veprën penale të sigurimit të mjeteve, që çon te kryerja e veprës penale të korrupsionit.

Arben Rakipi - Në terma praktikë mund të jetë që krimi i organizuar, për të hapur një kanal komunikimi në doganë ose në policinë e kufirit, falsifikon një dokument dhe dokumenti në fjalë shërben për të bërë... dhe gjykata për të cilën flasim, i ka të dy çështjet në kompetencë të saj.

Fatmir Xhafaj – Edhe qëllimi që e kanë vënë është i qartë.

Vasilika Hysi – Shumë mirë që është vënë dhe bëmë mirë që i dhamë kohën e duhur dhe e sqaruam, për ta pasur të qartë dhe të mos kemi keqkuptime në zbatim.

Lidhur me pikën 8, “Procesi i hapur dhe transparent”, më pëlqen që në ligj ka një standard të procedurës së aplikimit dhe të rekrutimit të hapur dhe transparent, futet një standard, i cili mungon deri më sot. Për shkak të rëndësisë që ka ky proces, do të sugjeroja që pika 8 të mos jetë përkufizim, por të jetë standard në ligj, brenda në trup. Aty ku do të flitet për procesin e rekrutimit dhe të aplikimit, që nga drejtuesit e prokurorisë, gjyqtarët, prokurorët, zëvendës drejtori, hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, meqenëse fjala “proces i hapur dhe transparent” përdoret për të gjithë procesin e aplikimit dhe të rekrutimit tyre, ai të jetë një nen i veçantë me të gjitha shkronjat siç është “a”, “b”, “c”, sepse e bën shumë më të qartë para se të thuhet se çfarë dokumentesh do të depozitohen personat në aplikime dhe cilat faza duhet të kalojnë me sukses. Këtu flasim për parimet e procesit dhe parimi bazë është transparenca dhe procesi i hapur. Pra, nuk është përkufizim, por është parim bazë themeli mbi të cilën do të ngrihet e gjithë struktura.

Fatmir Xhafaj – Atëherë, janë të gjithë dakord me ndryshimet përkatëse?

Faleminderit!

Neni 10 “Kompetencat”.

Vasilika Hysi – Neni 10 ka disa riformulime, pra nuk ka të bëjë me përmbajtjen, është i qartë, ka thjesht riformulime për t’u përshtatur me teknikën legjislative shqiptare. A janë dakord ekspertët me mënyrën se si ne i kemi riformuluar?

Fatmir Xhafaj – Dakord me riformulimet.

Neni 11 “Kompetenca të tjera”.

Vasilika Hysi – Neni 10 bën fjalë për “kompetencat parësore”, kurse neni 11 për “kompetenca të tjera”, dhe është pikërisht për atë kategori veprash penale, për të cilat ne sapo folëm në përkufizimin “Vepra të lidhura”. Në këtë nen ka thjesht renditje të fjalëve. Në qoftë se ekspertët janë dakord me riformulimin që ne i kemi bërë paragrafit të parë, të dytë dhe të katërt, ne mund të vazhdojmë më pas, pra janë thjesht riformulime.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Dakord me nenin 11 me riformulimet.

Neni 12 “Juridiksioni kombëtar”. Po, zoti Rakipi, për nenin 12?

Arben Rakipi – Te neni 12 duhet “Prokuroria e posaçme ka juridiksion”.

Fatmir Xhafaj – Po, sepse edhe titulli i nenit është juridiksion.

Arben Rakipi – Është më e gjerë si përmbajtje.

Vasilika Hysi – Po, ke të drejtë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 13 “Prokuroria e Posaçme”.

Ulsi Manja – Në nenin 13 janë thjesht riformulime të teknikës legjislative, të cilat nuk e cenojnë aspak përmbajtjen e nenit.

Fatmir Xhafaj – Dakord me nenin 13 me ndryshimet e teknikës legjislative. Neni 14 “Prokurorët e posaçëm të Prokurorisë së Posaçme”.

Vasilika Hysi – Është riformulim i teknikës legjislative dhe riformulimin e kemi dhënë në tabelë.

Fatmir Xhafaj – Dakord, faleminderit për riformulimin e paraqitur.

Neni 15 “Pavarësia e prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme”.

Vasilika Hysi – Zoti Vasili.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Vasili.

Petrit Vasili – Unë kam mjaft rezerva lidhur me këtë nen, me mënyrën se si është ideuar dhe se si është shkruar, kjo pa u hyrë komente të gjata, sepse besoj se nuk ia vlen të marrim çdo pikë më vete.

Ne e kemi kaluar së bashku me mirëkuptim ligjin “Për prokurorinë”. Në atë ligj kemi një nen specifik, i cili flet për pavarësinë e prokurorëve. Nuk mendoj që mund të ketë dy palë pavarësi prokurorësh. E veçanta e Prokurorisë së Posaçme qëndron në kompetencat lëndore që ajo ka, si edhe në veprat që ndjek. Rrethin e zyrtarëve që ajo ka të drejtë të hetojë e çoi përpara gjykatës. Pra, e veçanta e saj qëndron në specifikat që ka.

Lidhur me raportet dhe termin që ne kemi gjetur, “pavarësia” është një term i diskutueshëm, por po e pranojmë që të mos humbasim kohë për këtë gjë. Në nenin 6 të ligjit “Për prokurorinë”, që flet qartë për pavarësinë e prokurorëve, unë mendoj që të mbetemi tek ai përkufizim apo qasje që kemi pasur të gjithë së bashku në një ligj të mëparshëm, i cili rregullon punën e prokurorëve. Nuk mund të jetë normale që shteti shqiptar të ketë dy palë prokurorë me pavarësi të ndryshme. Kjo është pa sens, si nga ana logjike, metodike, por edhe nga ana konceptuale. Shteti shqiptar nuk mund të ketë njerëz që kanë një raport me ligjin, pavarësisht nga detyrat që kanë, të kenë raporte ndërvaresie apo pavarësie të veçanta, disa janë super të pavarur

dhe disa të tjerë qenkan me një pavarësi të diskutueshme si këta të tjerët. Ne ndërtojmë një front të tërë të luftës së prokurorisë për të luftuar gjithçka, që ka të bëjë me çështjet penale, të vogla apo të mëdha. Ne interesohemi të bëjmë drejtësi për të gjithë qytetarët, nuk po bëjmë drejtësi vetëm për zyrtarët e lartë, po të jetë vetëm për zyrtarët e lartë, s’kemi bërë gjë fare, ne e bëjmë për tre milionë shqiptarë këtë punë. Unë mendoj të ruajmë formulimin për atë ligj që kemi kaluar së bashku pak ditë më parë, sepse këto çështjet e teknikës legislative i zgjidhni vetë. Ne jemi në kushtet e një koherence, ku edhe unë do ta kisha të pamundur të shpjegoja në publik pse kam votuar këtu për dy palë pavarësi të veçanta, ndërkohë që, pavarësisht se ç’kanë, diferenca themelore midis tyre është kompetencat lëndore që iu janë dhënë që në fillim të ligjit.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Vasili.

Ka dy gjëra. Nuk e di, s’jam i qartë këtu, sepse nuk e kam para ligjin e prokurorisë, ta shikoj se si e kemi formuluar aty, por, nëse është çështje terminologjie për ta përkufizuar, jam dakord ta shohim se si rrinë të dyja bashkë. Se si e kuptoj unë, thelbi i këtij, i cili ka qenë edhe thelbi i konceptit të ligjit “Për prokurorinë” është që prokurori është i pavarur në bindjen e tij të brendshme në çështjen konkrete, pra eprori më i lartë nuk mund t’i ndikoj për mënyrën se si do të vendosë për fatin e çështjes. Të njëjtin princip kemi ndjekur edhe te projektligji tjetër, në formulim nuk e kam parasysh. Në paragrafët që ju ndërhyuni, bëhet fjalë vetëm për paragrafin e parë dhe të dytë, nuk kanë lidhje me paragrafët tre dhe katër, sepse janë krejt të ndryshëm me zgjidhjen që i kemi dhënë atje. Gjithsesi, ta shohim dhe, në qoftë se ka ndonjë diferencë...

Petrit Vasili – Edhe paragrafi tre dhe katër nuk është normal.

Fatmir Xhafaj –Pse?

Petrit Vasili – Sepse te pavarësia ne nuk mund të hetojmë se kë ka të drejtë prokurori të ndjekë, nuk është pjesë e pavarësisë. “Pavarësia” janë raportet brenda përbrenda institucionit, por nuk është vendi këtu në pikën tre që të themi se ka të drejtë që ky të ndjekë edhe gjyqtarë të gjykatave kundër korrupsionit, vendi është aty ku e kanë.

Fatmir Xhafaj – Mund ta ndajmë si dispozitë më vete.

Petrit Vasili – Sigurisht, por jo këtu, nuk hyn te pavarësia kjo.

Fatmir Xhafaj – Kur kemi bërë një debat në këtë komision, kemi qenë ne që i kemi thënë se këta i hetojnë të gjithë, por këta vetë kush i heton? E kemi ngritur ne këtë çështje, që këta nuk janë të pahetueshëm dhe kjo është diskutuar. Në qoftë se ka një zgjidhje tjetër, unë jam dakord që ta diskutojmë, por nuk do të ishte shumë korrekte që ta merrte një prokurori e

zakonshme të hetonte një prokuror të Prokurorisë së Posaçme. Këta do ta hetojnë vetë, por në ligj duhet thënë, sepse shqetësimi i një njeriu të thjeshtë, imi, juaji, por edhe i çdo qytetari është, dakord, këta do t'i hetojnë të gjithë, por këta vetë kush i heton? Ky është i njëjti problem që kemi ne me Prokurorin e Përgjithshëm. Kush e heton prokurorin e Përgjithshëm në Republikën e Shqipërisë?

Petrit Vasili – Unë nuk po bëj asnjë debat për përmbajtjen, por po them që nuk është vendi që atje ku flitet për raportet, të vijë edhe vepra. Unë jam dakord me ju, por të gjejë vendin atje ku e ka.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Të bëjmë një riformulim të këtyre dhe mund ta ndajmë këtë si dispozitë që ta kuptojmë këtë gjë.

Petrit Vasili – Propozimi tjetër është që të kemi koherencë me ligjin.

Fatmir Xhafaj – Dakord!

Ulsi Manja – Kam përshtypjen që neni 15 flet për pavarësinë në kuptimin e pavarësisë së brendshme që ka Prokuroria e Posaçme, ndërsa nenit 6, që i referohet kolegu Vasili te ligji që kaluam para tre ditësh...

Fatmir Xhafaj – Nuk ka rëndësi, mund të jetë 6 apo 16.

Ulsi Manja – Jo, neni 6 është, sepse e kemi ligjin përpara.

Kam përshtypjen se duhet riformuluar neni 15, që të lidhet ashtu siç duhet me nenin 6 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”, sepse këtu flitet tërësisht për pavarësinë e brendshme në mënyrën e funksionimit të këtij institucioni.

Fatmir Xhafaj – Besoj se koncepti është i njëjtë, nuk ka ndonjë ndryshim.

Ulsi Manja – Si koncept po.

Fatmir Xhafaj – Po, zonja Bumci.

Korajlka Bumci – *(përkthyesja përkthen.)* Më falni, më duhet të kthehem te neni 14, ku reflektoam komentet e Ministrisë së Drejtësisë. Në paragrafin e dytë janë disa parakushte. A mund të mendoheni përsëri për paragrafin e dytë neni 14, të keni parasysh parakushtet shëndetësore? Ky është koment i Ministrisë së Drejtësisë, por a mund ta sqarojmë pak se çfarë nënkuptohet me këto parakushtet shëndetësore?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Duhet të ecim pak më avash.

Unë kam të njëjtin shqetësim si zonja Bumci. Në nenin 8, ku flitet për parakushtet që duhen plotësuar, te “kushtet e sigurisë” nuk është përmendur parakushti shëndetësor. Në paragrafin e dytë është komenti i Ministrisë së Drejtësisë i shtuar me propozimin e tyre, në të cilin ka një kontradiktë dhe në fjalinë e parë thotë që duhet të përmbushë parakushtet e sigurisë së nenit 8 të këtij ligji, pastaj thotë që duhet të përmbushë kushtet e sigurisë, kushtet e aftësisë profesionale dhe parakushtet shëndetësore. Nëse do të lëmë parakushtet shëndetësore, ajo duhet të reflektohet edhe te neni 8, edhe te neni 14, sepse duhet të jenë në koherencë.

Kam edhe një pyetje për ekspertin lidhur me një propozim të Ministrisë së Drejtësisë, ku thuhet se një kandidat, i cili ka marrë një opinion negativ nga grupi i ekspertëve të mjekësisë ligjore nuk mund të caktohet në detyrë. Kur flasim për parakushtet shëndetësore, flitet për çdo lloj sëmundje, apo probleme të shëndetit mendor? Në qoftë se ka sëmundje të tjera, si, për shembull, diabeti, hipertension, kolikrenale veshkash, nuk mund të jetë kandidat?

Unë kam dy çështje. E para, nëse do ta lëmë propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, duhet ta pasqyrojmë edhe te kushtet e nenit 8, ku thuhet se cilat janë kushtet e sigurisë dhe, e dyta, te paragrafi i dytë duhet saktësuar që bëhet fjalë për probleme të shëndetit mendor, s’besoj se ne që kemi syze nuk mund të punojmë, ose kemi shqetësime të tjera.

Ju kërkoj ndjesë që u ktheva, por më shpëtoi ky diskutim. Pra, lidhja e nenit 8 me nenin 14 dhe saktësimi i parakushteve shëndetësore. Njëkohësisht, në një nga nenet 39, 40, 41 nuk e mbaj mend saktësisht, do të shohim terminologjinë se cili është grupi i ekspertëve që do ta vlerësojë, aty nuk thuhet mjek ligjor, thuhet një ekip mjekësh. Mjekët ligjorë janë mjekë që lidhen me çështjet penale, prova e të tjerë, ndërsa këtu duhet të jenë mjekë të specializuar, do të jetë një komision mjekësh që do të bëjnë një skanim të shëndetit. Ndoshta nuk jam e qartë unë, por shumë faleminderit, zonja Bumci, që ma morët pyetjen, por që prapë jemi në një linjë.

Jon Smibert – *(përkthyesja përkthen.)* Ky ishte një propozim i Ministrisë së Drejtësisë, ku edhe unë pata rezervat e mia, sepse duhet përkufizuar lloji i kushtit shëndetësor dhe nuk duhet mbetur si një vendim i hapur arbitrar, kështu që duhet ta përcaktojmë qartë këtë gjë. Vendimi më i mirë është që ta rregullojmë këtë pjesë.

Fatmir Xhafaj – Jam dakord me nenin 14.

Jon Smibert – *(përkthyesja përkthen.)* Te nenin 15 për pavarësinë.

Fatmir Xhafaj – Për të reflektuar komentimin e Ministrisë së Drejtësisë dhe për ta riformatuar.

Po, neni 15.

Jon Smibert – *(përkthyesja përkthen.)* Në lidhje me nenin 15 për pavarësinë e prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme, është ndryshe që të ndërhysh në një sistem ku kemi prokurorë të rinj, të cilët udhëhiqen nga prokurorët më të vjetër. Duhet ta bëjmë të qartë në çfarëdo lloj formulimi që kjo mbetet një pavarësi e njëjtë për të gjitha sistemet. Për shembull, në Kroaci prokurorët ndjekin njëri-tjetrin brenda sistemit në ndjekje penale.

Fatmir Xhafaj – E shton këtë gjë, sepse kjo ka qenë reflektim i debatit që ne kemi bërë këtu. Kjo është përgjigja e asaj shprehjes së famshme se kush i kontrollon kontrollorët, por këtu çështja është për ta sjellë nga pikëpamja e konceptit gjuhësisht dhe terminologjist, që të jetë i njëjti koncept pavarësie.

Dakord, neni 15 me ndryshime.

Neni 16 “Drejtuksi i Prokurorisë së Posaçme”.

Vasilika Hysi – Te neni 16 nuk kemi probleme me përmbajtjen. Meqenëse në fillim të paragrafit dy të këtij neni përmendet fjala “drejtues i Prokurorisë së Posaçme”, mendojmë që në të gjithë gërmat e mëposhtme “a”, “b”, “c” e me radhë të hiqet kjo fjalë, sepse është thënë që në fillim. Po jap një shembull se si do ta lexojmë nenin. “Drejtuksi i Prokurorisë së Posaçme ushtron funksionet, detyrat dhe kompetencat e mëposhtme” :

1. Nga pikëpamja administrative drejton punonjësit e Prokurorisë së Posaçme.
2. Cakton çështjet prokurorëve të posaçëm.
3. Koordinon punën e njësisë.

Pra, hiqet fjala që përsëritet dhe neni pastrohet. Ka edhe disa riformulime të tjera të teknikës legjislativë që ne i kemi dhënë në tabelë.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Besoj se rishikim është, apo jo?

Vasilika Hysi – Mendoj se gërma “e” duhet të ndahet në dy gërma, sepse e para thotë që nxjerr udhëzime të përgjithshme.

Fatmir Xhafaj - Ndërhyrje e teknikës legjislativë është.

Vasilika Hysi - Është e gjitha teknikë legjislativë.

Fatmir Xhafaj – Zoti Rakipi, keni ndonjë gjë?

Dakord. Faleminderit!

Neni 17 “Mbledhja e prokurorisë së posaçme”.

Vasilika Hysi - Në nenin 17 kemi bërë përsëri riformulime duke filluar direkt fjalinë se çfarë mund të miratojë mbledhja e prokurorisë së posaçme, por unë kam një pyetje për ekspertët. Nuk do të ishte mirë që në paragrafin e parë të thuhet se nga kush përbëhet mbledhja e prokurorisë së posaçme? Pra, mund të japim një paragraf hyrës ku të themi që mbledhja e prokurorisë së posaçme është mbledhja e të gjithë prokurorëve apo dhe e stafit. Pra, duhet ta përcaktojmë se cili është kuptimi i mbledhjes së prokurorisë së posaçme, kurse në paragrafin e dytë të japim kompetencat e mbledhjes së kësaj prokurorie.

Fatmir Xhafaj – Unë kam diçka më në parim sesa zonja Hysi. Zonja Hysi ka ndërhyrje të teknikës legjislative, kurse unë kam shikim pak më parimor. Çfarë kuptimi ka mbledhja e prokurorisë së posaçme si një organ vendimmarrës, sepse në fund të fundit këto nuk janë organe kolegjiale, por janë organe monokratike? Prokurori është përgjegjës për çështjen e tij, për hetimin, ndjekjen penale, kurse drejtuesi i prokurorisë është titullari, vendos rregulla, ka këshill të lartë prokurorie dhe ata janë të detyruar që të zbatojnë rregullat. Nëse duhet të ekzistojë mbledhja e përgjithshme për t'u njohur dhe diskutuar për rregullat, si dhe për të tërhequr mendimin, mendoj se është shumë mirë sepse është demokraci e brendshme e organit.

Të të ndihmoj, zoti Rakipi? Vlerësoj se duhet të vendosim për kërkesën sipas nenit 27 të këtij ligji, që do të thotë se ky bëhet organ procedural, sepse ata duhet të vendosin për pushimin dhe pezullimin çështjes.

Nuk e di, e njeh Kodi i Procedurës Penale këtë të drejtë? Po.

Vasilika Hysi - Kam edhe unë një pyetje?

Fatmir Xhafaj - Pyetje pasi unë bëra...

Arben Rakipi - Zoti kryetar, ndërhyrja që ju bëtë është një gjë shumë e madhe, parimore e cila përbëhet nga dy gjëra.

E para prek çështjen e pavarësisë së prokurorëve, kurse e dyta prek çështjet e procedurës. Pse e them këtë? E them sepse të gjithë ata që merren dhe që i prek reforma, prokurorë e gjyqtarë, kanë insistuar në pikën që prokurorët duhet të jenë të pavarur gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe të mos kemi mekanizma proceduralë që të ndërhyhet në vendimmarrjen e tyre. Pra, me fjalë të tjera prokuroria të decentralizohet. Kjo është gjëja e madhe që po ndodh këtu, por ne kemi pasur merakun dhe kujdesin që të gjejmë mekanizma kontrollues në mënyrë që vendimmarrja e prokurorëve të mos na dalë nga një kontroll ligjor i arsyeshëm, si dhe të mos lejohet që prokurorët të mbajnë qëndrime të ndryshme për çështje të

njëjta. Këtë shqetësim ne mund ta rregullojmë me disa lloje mekanizmash, ndër të cilët është edhe çështja në fjalë e cila vjen te neni 27. Ne përpiqemi që prokurorët e tjerë dhe titullari, të mund të kontrollojnë në mënyrë të arsyeshme punën e prokurorëve të thjeshtë. Kjo është e para.

E dyta, lidhet me faktin e elementeve procedurale. Për shkak se ligji organik dhe procedura janë të lidhura ngushtë, dhe përderisa ne flasim për prokuror dhe mënyrën se si punon ai, duan apo nuk duan ne këto janë elementë edhe të karakterit procedural. Edhe për faktin që procedura penale nuk po ecën paralel me ligjet që po flasim, ne nuk mund t'i shpëtojmë dot përmendjes në këtë ligj të disa elementeve proceduralë, të cilët janë elementë të përgjithshëm, por gjithsesi rregullojnë në mënyrë indirekte punën e prokurorit. Neni 27 dhe ato që ju përmendni kanë pikërisht këtë ngarkesë procedurale, e cila çon në disiplinimin dhe kontrollin e punës së prokurorëve pa cenuar thelbin e pavarësisë së tyre. Kjo është e gjithë çështja e neneve 17, 27 e kështu me radhë.

Unë them se frika ka qenë që a janë prokurorët individualisht të përgjegjshëm për të ruajtur prokurorinë si një e tërë në kuptimin struktural të fjalës, për sa kohë që prokurori i Përgjithshëm nuk ka më autoritetin e sotëm, apo jo? Ne jemi përpjekur që këtë shqetësim ta rregullojmë me aq sa mundemi në mënyrë që ta mbajmë strukturën solide.

Fatmir Xhafaj - Po, fjalën e ka zonja Bumçi.

Korajlka Bumçi - *(përkthyesja përkthen.)* Kjo është diçka që e kemi në Kroaci, por më duhet të ndërhyj për këtë gjë. Kjo u ndërtua për të rregulluar dhe për të dhënë, jo vetëm pavarësinë e prokurorëve, por ashtu siç tha edhe zoti Rakipi edhe për t'i kontrolluar ata. Nëse hetojmë zyrtarë të lartë, Kryeministrin për shembull, është shumë e rëndësishme që, nëse do ta ndiqni penalisht, të mos e merrni ju vetë përgjegjësinë, por duhet që të keni edhe të tjerë që ta ndani këtë situatë, dhe ne këtë e bëjmë me Uskokun. Nëse jeni vetëm në këtë situatë dhe nëse nuk keni një skuadër pas vetes suaj, është shumë e thjeshtë që të dilni në vendimin e gabuar. Gjykata nuk mund ta kontrollojë këtë gjë, sepse ajo nuk është mekanizmi për të kontrolluar në këtë fazë të procesit nëse duhet të procedoni apo nëse mund të procedoni më tej, prandaj për këtë arsye ngrihen organet kolegjiale.

Fatmir Xhafaj - Për të thënë të drejtën, me gjithë respektin që kam për ju të dy, nuk më bindët, sepse ajo që ju parashtroni në qëllimin që dëshironi të arrini dhe ajo çfarë është shkruar këtu, nuk janë dy gjëra të njëjta. Unë jam shumë dakord që të krijohet një praktikë e unifikuar për të mbajtur qëndrime të unifikuara, por nuk e kuptoj dot se pse mbledhja duhet të miratojmë

rregulla të brendshme. Për çfarë është drejtuesi i prokurorisë, sepse një lloj pushteti duhet ta kenë këta? Këto nuk janë mbledhje kolektivi që do të dalin disa akte, por jam dakord që t'i diskutoj këto dhe të tërheqë vendimin, sepse më pas do të duhet që të përcaktojmë se si bëhet mbledhja, kush voton, si votojnë e të tjera. Në qoftë se është një praktikë e shëndetshme jam dakord, megjithatë kam rezerva sepse kjo nuk e ndihmon pavarësinë e prokurorëve, përkundrazi, sepse pak më lart folëm për pavarësi, kurse këtu i themi prokurorit që nuk do ta vendosësh vetëm ti, por të gjithë bashkë.

Unë nuk jam ekspert i fushës dhe prandaj nuk insistoј fort, por që...

Korajlka Bumçi - *(përkthen përkthyesja.)* Në fakt, iu referova vetëm nenit 27 dhe jo rregullave administrative.

Fatmir Xhafaj - Neni 17 është i lidhur me nenin 27, por nuk dua të insistoј, megjithëse është një çështje që më preokupon.

Fjalën e ka Zoti Manja.

Ulsi Manja - Lidhur me nenin 17, "Për kompetencat e mbledhjes së prokurorisë së posaçme". Unë e kuptoj që kjo është parashikuar si mekanizëm kontrolli, por edhe si shpërndarje e përgjegjësisë në raport me vendimmarrjen e nenit 27, pra lidhet me pushimin e çështjes ose akuzave penale nga prokurori i posaçëm. Ndoshta do të gjejmë ndonjë riformulim, sepse në nenin 27 ju i referoheni nenit 50 të ligjit "Për prokurorinë", që kemi diskutuar në këtë komision, ku thuhet se prokurori mund të zëvendësohet në rastet dhe kushtet e parashikuara në nenin 27 të Kodit të Procedurës Penale, dhe po të shkojmë këtë nen, kjo kompetencë i jepet drejtuesit të prokurorisë. Pra, në fund, vendimmarrja në lidhje me pushimin e akuzës, pushimin e çështjes apo edhe rastet e zëvendësimit të prokurorit të posaçëm në hetim, do të jetë monokratike. Pra, shprehja e vendimmarrjes e një mbledhje të prokurorëve të posaçëm, në fund do të formalizohet me vendimin që e merr një individ prokuror dhe ky person në referim të nenit 27 të Kodit të Procedurës Penale është drejtuesi i prokurorisë. Pra, nëse do ta ruajmë si mekanizëm kontrolli dhe shpërndarje përgjegjësie, atëherë si mund të funksionojë kjo nesër në praktikë? Do ketë thjesht një procesverbal të mbledhjes së prokurorëve të prokurorisë së posaçme, ku me të njëjtin mekanizëm siç funksionon Komisioni i Ligjeve, që ka një relator për projektligjin, e njëjta situatë parashikohet edhe te mbledhja e prokurorëve të përgjithshëm? Do ketë një procesverbal ku shumica e prokurorëve të prokurorisë së posaçme kanë vendosur që çështja të pushohet? Atëherë, a e ka fuqinë kjo mbledhje për t'i thënë prokurorit të çështjes që shko bëje vendimin e

pushimit të çështjes, sepse vendimi i pushimit të çështjes do të bëhet nga një prokuror? Nëse do ia lëmë drejtuesit të prokurorisë së posaçme, jam dakord, por gjithsesi duhet që ta shikojmë pak në harmoni me të tri...

Fatmir Xhafaj - Gjithsesi e miratojmë me ndryshimet e propozuara për teknikën. Ndërkohë bëni një diskutim për të parë më qartë dhe për ta kuptuar më mirë përvojën dhe nëse është një përvojë e suksesshme, e cila qëndron me praktikën tonë si edhe me Kodin e Procedurës penale, nuk kemi pse të mos e mbështesim, por të krijojmë një bindje që kjo është pozitive.

Dakord, për ndryshimet e kaluara.

Neni 18 “Struktura e...”

Vasilika Hysi - Zonja Bumçi, mendoni se paragrafi i parë duhet të thotë se nga kush përbëhet mbledhja e prokurorëve të posaçëm?

Fatmir Xhafaj – E kemi vënë edhe atë, por nuk ka problem sepse ajo është formale.

Vasilika Hysi - Duhet thënë për të ditur se kush ka të drejtë të votoj dhe këtë e lidh me nenin 27, me kompetencën. Do jenë vetëm prokurorët apo do bëjnë pjesë ekspertët dhe punonjësit e tjerë?

Fatmir Xhafaj – Jo pra, nuk ka nevojë, sepse e kemi saktësuar te kjo që kemi shkruar. Nëse do të qëndrojë, neni 17 riformulohet kështu: “Mbledhja e prokurorisë së posaçme përbëhet nga prokurorët e prokurorisë së posaçme, të cilët...”

Çfarë pune ka eksperti që të marrë vendim, mos e kaloni në ekstrem. Ky nen kalon kështu dhe nuk e diskutojmë më këtë.

Korajlka Bumçi – *(përkthen përkthyesja)* Ne mënyrën e votimit e kemi në ligjin “Për prokurorinë”.

Fatmir Xhafaj - E kemi hequr, dhe nuk e kemi lënë mbledhjen e prokurorëve te prokurori organ vendimmarrës. Më vjen keq.

Vasilika Hysi - Duhet ta unifikojmë pra.

Fatmir Xhafaj - Dakord me ndërhyrjen që u bë.

Neni 18 “Struktura e prokurorisë së posaçme”.

Vasilika Hysi - Kam unë një pyetje.

Zonja Bumçi, ju keni thënë se prokuroria e posaçme përbëhet nga të paktën dhjetë prokurorë.

A duhet detyrimisht ta përcaktojmë numrin dhjetë prokurorë, sepse kjo lidhet edhe me ngarkesën e punës?

Problemi i dytë ka të bëjë me seksionet. Ju përmendni si seksion kancelarin, ndërkohë që në nenin e mëposhtëm kancelari del si një person i vetëm. Ju përmendi si seksion koordinatorin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndërlidhjes për hetimet, ndërkohë që ky del si individ i vetëm dhe jo seksion.

Fatmir Xhafaj – Te ky nen duhet hequr fjala seksion.

Vasilika Hysi - Jo, dua ta sqaroj sepse ka të bëjë me burimet njerëzore dhe buxhetin.

Fatmir Xhafaj - Dakord pra, i gjithë ky nen duhet riformuluar në mënyrë që të thuhet se struktura e prokurorisë së posaçme përbëhet nga prokurorë, kancelari, seksioni filan, seksioni filan e të gjitha me radhë, sepse edhe kështu kancelari dhe seksioni i dokumentacionit nuk rrinë bashkë. Kancelari është drejtuesi i administratës së gjithë prokurorisë dhe rri bashkë me seksionin e dokumentacionit. Do ta shikojmë edhe në një nen më pas që nuk mund të rrinë në një nen dhe do t'i ndajmë neni 19 dhe neni 19, germa “a”, sepse nuk ka kuptim të thuash “Sekretari i Përgjithshëm” dhe “Arkiva”.

Dakord? Riformulohet neni 18 “Struktura e prokurorisë së posaçme”.

Neni 19. Dakord për ta ndarë në dy...

Petrit Vasili - Nuk ju marr kohë.

Fatmir Xhafaj - Jo, më vjen keq

Petrit Vasili – Unë jam i mendimit që të gjitha formulimet kushtetuese, edhe në ligje që u referohen numrave, t'i evitojmë. Ne përcaktojmë strukturat dhe madhësitë, dhe jo vetëm në këtë rast, por edhe në raste të tjera, kur ka ligje jo të kësaj natyre që e kanë mundësinë të jenë të saktë evitohen, sepse detyrimi ligjor bëhet i fortë dhe mundësitë praktike mund të jenë të ndryshme. E kemi me dhjetë, me nëntë, mund ta bëjmë me shtatëmbëdhjetë prokurorë, por thelbi i gjësë është që struktura të vihet në lëvizje. Mendimi im është që ta pastrojmë nga këto, përjashtojmë atje ku domosdoshmëria është absolute dhe koncepti i seksionit nuk mund të funksionojë me më pak se kaq njerëz, por pjesa totale e përbërje nuk shkon në përputhje me këto struktura.

Neni 18 me riformulim, kurse neni 19 “Kancelari dhe seksioni i dokumentacionit duhet të ndahet në dy nene, kancelari më vete, seksioni i dokumentacionit më vete.

Vasilika Hysi - Kam edhe një pyetje.

Fatmir Xhafaj - Po.

Vsilika Hysi - Lidhur me seksionin e dokumentacionit, kancelari është ai që mban përgjegjësi për të gjithë dokumentacionin apo do të ketë ndonjë person tjetër përgjegjës, sepse më lart thuhet që mbikëqyr dosjet, arkivin, shërbimet mbështetëse, kurse në paragrafin e dytë thuhet që seksioni i dokumentacionit mbledh në mënyrë sistematike, por kush është personi përgjegjës? Po, kancelari vetëm këtë detyrë ka, që të mbikëqyrë dosjet, arkivin, shërbimet mbështetëse dhe financat?

Fatmir Xhafaj - Ka të gjithë administratën, prandaj ndoshta duhet riformuluar që të jetë i njëjti koncept që vumë edhe te prokuroria. Kancelari ka të gjithë administratën dhe ai përgjigjet se si funksionon administrata, siguria, shërbimet e brendshme, kancelaria, marrëdhëniet me publikut, sepse nuk do të shikoj drejtuesi i prokurorisë së posaçme që ka apo nuk ka roje godina, ka rënë muri apo duhet lyer me bojë.

Dakord, riformulohet nenit 19.

Neni 20 “Seksioni i ekspertizës”.

Vasilika Hysi - Kam unë një pyetje për nenin 20.

Prokuroria e posaçme ka ekspertë të cilët ndihmojnë në hetime dhe mund të dëshmojnë në gjyq duke qenë vetë ekspertë brenda institucionit.

Fatmir Xhafaj - Në prokurori kështu ndodh edhe sot.

Vasilika Hysi – Pjesa tjetër është thjesht riformulim dhe s’postim që paragrafi i katërt të kaloj para paragrafit të dytë.

Fatmir Xhafaj - Dakord me riformulimin.

Neni 21 ...

Ulsi Manja – Kam një pyetje.

Fatmir Xhafaj – Po

Ulsi Manja - Neni 20 flet për ekspertizën e brendshme që do të ketë kjo strukturë. Ky nen e lejon prokurorinë e posaçme apo prokurorin e posaçëm, nëse nuk ka ekspertët ose kapacitetet e duhura brenda ekspertizës së institucionit, të marrë ekspertë nga jashtë.

A vlejnjë të njëjtat kushte dhe kriteret të marrjes së ekspertit nga jashtë, ashtu siç vlen për punonjësit e prokurorisë së posaçme dhe punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit? Do të merret një ekspert nga jashtë që do të ketë akses në çështjet nën hetim. A vlejnjë të njëjtat kushte sigurie edhe për këtë ekspert?

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni, zoti Smibert!

Jon Smibert – *(përkthen përkthyesja)* Kjo është një pyetje mjaft e mirë. Neni 20 nuk përjashton mundësinë për ta marrë edhe ekspertë të jashtëm, sepse shpesh ju keni nevojë për ekspertizë për gjëra, të cilat nuk merren si rutinë e punës.

Një tjetër pikë që është e nevojshme të thuhet, është se kur eksperti që vjen jashtë fushave të zakonshme, ata duhet të jenë në përputhje me të gjithë procesin e deklarimit dhe në fakt, kjo ka kuptim. Unë jam dakord me këtë. Mbase këtu mund të shtoj që seksioni i ekspertizës është diçka, l të cilën ne e thamë dje, kur flisnim për zyrën e prokurorisë, ku u propozua që të kishim seksionet e ekspertizës. Në fakt ne e kemi këtë, meqë ekspertët bëjnë një farë kontrolli paraprak për disa çështje dhe të gjithë ekspertët, të cilët merren me këtë, gjithashtu, kontrollohen. Bëhet një kontroll i figurës së tyre dhe për këtë arsye, është mjaft e rëndësishme që ju të keni bazat mbi të cilat mund të mbështeteni, përpara se të filloni ndonjë gjë. Kjo vlen sidomos, për taksat apo për krimet që lidhen me punonjësit, ku vetë avokatët apo juristët nuk kanë shumë informacion për këto gjëra.

Është e njëjta gjë edhe me FBI-në, sikurse e thashë. Kanë shumë ekspertë por mund të kenë një çështje të tillë, si për shembull: hyrja e paligjshme në *Iphone* për të cilën ata duhet të marrin një ekspert, i cili ka më shumë njohuri, sesa ekspertët e zakonshëm. Pra, kjo është një rutinë e zakonshme që ndodh kudo.

Fatmir Xhafaj – Është në rregull?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Te njëzeta.

Jeni dakord të reflektohet ndryshimin, për të cilin u fol te njëzeta?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord. Më duket e drejtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me mikrofon, ju lutem!

Ulsi Manja – Do të merren nga jashtë dhe do të përdoren të njëjtat rregulla lidhur kontrollin, pastërtinë e figurës dhe sigurinë për këta ekspertë.

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni!

Arben Rakipi – Neni 20 flet për ekspertët që do të punojnë në prokurori dhe ata, në kuptimin procedural të fjalës janë fillimisht, si këshilltarë të prokurorit, të specializuar në një

fushë të caktuar për të krijuar një bazë shkencore për pyetjet që prokurori mund t'u drejtojë ekspertëve. Në eventualitetin që ky raport ekspertimi nuk kundërshtohet nga pala kundërshtare, nuk ka asgjë të keqe që ai të paraqitet edhe në gjyq. Nëse raporti në fjalë nuk ka mundësi për t'u paraqitur në gjyq, prokurori është i detyruar të marrë një ekspert tjetër dhe ky ekspert tjetër që paraqitet para gjykatës, është ekspert që është në treg, që mund të punojë në Ministrinë e Drejtësisë, mund të jetë i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, mund të punojë në Ministrinë e Brendshme, për shkak të detyrës e kështu me radhë dhe nëse duhet të ketë kritere për t'u paraqitur para gjykatës, ose jo. Ato janë kritere procedurale, që gjykata brenda normave që lidhen me cilësinë e ekspertit, do ta paranojë ose jo atë ekspert. Nuk mund të...

Fatmir Xhafaj – Ideja është që këta kanë një minimum ekspertësh që i kanë... por ndërkohë mund të konsiderohen ekspertë të jashtëm pranë tyre, sepse ai nuk mund të mbajë aty një ekspert për kibernetikën, por ata quhen ekspertë të jashtëm të institucionit, të cilët kanë të njëjtin status, por janë të jashtëm, punojnë *part time*, sa herë që ka nevojë dhe kryejnë funksionet e ekspertit të brendshëm, por nuk janë *full time*. Besoj se kjo është logjika e asaj që thatë dhe jo për ekspertët që është e nevojshme të paraqiten para gjykatës?

Arben Rakipi – Deputeti Manja po pyet për ekspertët që do të paraqiten para gjykatës.

Ulsi Manja – Po marr një rast krejtësisht praktik. Natyrisht, prokuroria e posaçme nuk mund të parashikojë të ketë në dispozicion ekspertë të brendshëm për të gjitha fushat. Lind nevoja që për një çështje hetimi do të kërkohet një ekspert i jashtëm, për shembull, ekspert kibernetik. Nga lista e ekspertëve të pavarur, të regjistruar në Ministrinë e Drejtësisë, që e ushtrojnë këtë profesion në përputhje me ligjin për shërbimin e ekspertizës, mund të jenë iks ekspertë. Nëse do të vendoset që prokurori do të thërrasë njërin nga këta ekspertë, në momentin që caktohet, ai duhet të filtrohet për sa i përket kushteve, që kanë lidhje me kontrollin e pastërtisë së figurës dhe të tjerave, sepse ai mund ta marrë të gjithë informacionin që ka dosja dhe ta nxjerrë në treg, pra flas që të vëmë disa rregulla për të, pasi caktohet si ekspert, për kontrollin e figurës së tij dhe të gjitha të tjerat. Në këtë kuptim e kam.

Arben Rakipi – E kuptoj atë shqetësim. Unë them se ekspertët e jashtëm, që nuk punojnë në prokurori, kanë standardin e tyre të etikës së punës, i cili është shënuar në procedurë dhe në Kodin e Punës së institucionit ku ata punojnë. Ne nuk mund t'u kërkojmë këtyre ekspertëve të plotësojnë kushtet ekstreme që i kanë dhe duhet t'i gëzojnë ekspertët e kësaj prokurorie.

Fatmir Xhafaj – Ai nuk po thotë kushte ekstreme, por po thotë një minimum kushtesh, që do t'i vendosin vetë ata. Të lëshojnë një deklaratë e të tjera e të tjera.

Arben Rakipi – Ato janë elemente procedurale, të cilat janë të shënuara në ligj, ku thuhet, se eksperti merr përsipër ta kryejë detyrën...

Fatmir Xhafaj – Përveç asaj të thuhet: të mos ketë konflikt interesi, të mos jetë i lidhur me palët...

Arben Rakipi – Edhe kjo është e parashikuar në ligj.

Fatmir Xhafaj – Ok, rishikojeni dhe kur të bëni ndërhyrjen na njoftoni!

Dakord?

Jon Smibert – *(përkthen përkthyesja)* Bie dakord me Arbenin dhe mendoj se ai ka të drejtë, sepse kur kërkoni ekspertë të një fushe kaq specifike, ndoshta ata nuk janë as në Shqipëri. Ata mund t'ju pyesin se çfarë po u kërkoni. Ndoshta më e mira do të ishte që unë të bisedoj me Arbenin, për ta riformuluar më mirë dhe për të adresuar shqetësimin tuaj.

Fatmir Xhafaj – Dakord, edhe me ndërhyrjen e zotit Rakipi për nenin 20.

Neni 21, “Seksioni i hetimit financiar”.

Vasilika Hysi – Pa folur për riformulimet, kam dy pyetje, zoti kryetar. Në paragrafin e dytë, ku thuhet se punonjësit e këtij seksioni duhet të jenë të diplomuar në financë, në drejtësi, janë llogaritarë dhe kur thuhet: në fushat e tjera përkatëse, besoj se e keni fjalën në fusha të tjera të nevojshme për hetimin financiar, që mund të jenë tatimet, taksat etj.

Lidhur me pikën 4, kam një pyetje: thuhet se punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, të cilët kualifikohen sipas kësaj dispozite, mund të japin asistencë. Unë nuk e kam të qartë se çfarë keni dashur të thoni, por pyetja më thelbësore është: Një punonjës, një hetues i Byrosë Kombëtare të Hetimit, që po heton një çështje...

Fatmir Xhafaj – Nuk është fjala për atë.

Vasilika Hysi – Jo, për atë është. Sipas përkufizimit të nenit 9, punonjësi i Byrosë Kombëtare të Hetimit, është hetuesi, nëse e kam kuptuar mirë.

Nga ana tjetër, një hetues, që ka hetuar çështjen a mund të ndërhyjë në një fazë tjetër dhe të ndihmojë edhe seksionin e hetimit financiar për të verifikuar mjetet financiare, pasuritë e të pandehurit? Nëse po, duhet ta riformulojmë pak më saktë.

Jon Smibert – *(përkthen përkthyesja)* Pak a shumë nuk e di nëse është e nevojshme teknikisht, por sigurisht, është e nevojshme të sqarojmë që po përpiqet të kuptohet se ku kanë

shtëpinë, apo kanë një zyrë të vogël në prokurori. Ata që kanë një zyrë të vogël në prokurori, do t'u duhet të shkojnë në zona të ndryshme për të bërë hetime, pra është pak a shumë, për të ndihmuar në efikasitet më shumë se në çdo gjë tjetër. Ata janë aty për të ndihmuar njëri-tjetrit, thjesht për t'i dhënë ndihmë njëri-tjetrit. Po ta marrim në këtë këndvështrim, paragrafi i katërt del fare i panevojshëm dhe mund të mos ta përfshijmë. Thjesht përkon me efikasitetin dhe kaq.

Fatmir Xhafaj – Dakord me nenin 21 me ndryshimet. Miratohet.

Neni 22, “Ndërlidhësi për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe hetimet e përbashkëta”.

Vasilika Hysi – Lidhur me ndërlidhësit, ka thjesht riformulime. E vetmja pyetje që unë e përmenda edhe pak më lart, kur diskutuam strukturën e prokurorisë së posaçme, është: Ndërlidhësi nënkupton një person të vetëm, apo mund të ketë edhe persona të tjerë që mund ta asistojnë?

Fatmir Xhafaj – Këtu thuhet: të paktën një punonjës. Ajo mund të jetë edhe një zyrë e bashkëpunimit ndërkombëtar

Vasilika Hysi – Kjo është pyetja ime. Pse e bëj këtë pyetje? Kur kemi folur te neni 18, që fliste për strukturën e prokurorisë së posaçme, ku edhe ju ndërhytë me të drejtë, duhet ta kemi të qartë, sepse kjo ka një faturë financiare në fund. Do të vijmë te pjesa e buxhetit dhe duhet të jemi shumë të qartë për këtë pjesë. Në rast se themi ndërlidhësi, është një person i vetëm në titull. Në rast se do të themi zyra e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe e hetimeve të përbashkëta, është një gjë tjetër. Në varësi të faktit se sa persona do të jenë, nëse do të ketë një ndërlidhës apo do të ketë staf mbështetës, këtu duhet bërë edhe formulimi.

Fatmir Xhafaj – Mund të ketë një ndërlidhës apo do të ketë staf mbështetës. Mund të ketë nevojë të bëhen më shumë hetime dhe do të jenë 5 veta atje. Këta kanë thënë që minimalisht do të ketë një njeri, sepse logjika e punës e ka të detyrueshme të jetë minimalisht një njeri. Më pas mund ta rregullojmë.

Vasilika Hysi – Atëherë, duhet lënë diçka se kush ka të drejtë ta krijojë këto struktura ose te neni 18 duhet të shtojmë një paragraf.

Fatmir Xhafaj – Ku?

Vasilika Hysi – Aty, ku kërkohet, të krijohet një strukturë.

Fatmir Xhafaj – Mjafton ta vëmë aty: zyra e ndërlidhjes. Pastaj nëse është një njeri apo do të jenë dy njerëz...

Vasilika Hysi – Unë mendoj që duhet të jetë zyrë, sepse një person i vetëm nuk mund të bëjë të gjitha dokumentet, të komunikojë apo të ndihmojë hetimet. Mund të ketë disa hetime të përbashkëta, sidomos, në fushën e krimit të organizuar.

Fatmir Xhafaj – Dakord, të mos merremi me këto detaje.

Vasilika Hysi – Çështja është se duhet të shtojmë paragraf, do të bëjmë rregullime pastaj.

Fatmir Xhafaj – Kjo nuk ka efekt në praktikë. Si të thuash një, si të thuash dy. Ligji ka hyrë në disa detaje të panevojshme. Mjafton të shpjegojë se çfarë është ndërlidhësi dhe përse duhet ai, në mënyrë që ai t'i kryejë detyrat në bazë të ligjit. Të tjerat diktohen nga nevoja e punës.

Urdhëroni, zoti Manja!

Ulsi Manja – Unë jam dakord që të lihet në varësi të nevojave, por mendoj se drejtuesi apo personi përgjegjës i kësaj zyre duhet të jetë prokuror, një nga prokurorët e prokurorisë së posaçme dhe pastaj ai mund të asistohet nga një, ose dy, ose tre, në varësi të nevojave, por bëhet fjalë për bashkëpunim ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Kam përshtypjen se detyra e ndërlidhësit, nuk mund t'i lihet një oficeri të policisë gjyqësore të BKH-së. Ai mund të ndihmojë prokurorin e zyrës në këtë fushë, por duhet të jetë prokuror sepse bëhet fjalë për akte procedurale. Bashkëpunim në funksion të hetimit.

Fatmir Xhafaj – Edhe një herë, kjo dispozitë duhet riformuluar, sepse në dy paragrafët e parë të jep idenë që ndërlidhësi mund të mos ta ketë statusin e prokurorit. Paragrafi i tretë dhe i katërt të japin idenë që ai duhet të jetë prokuror dhe duhet të përmbushë disa kritere sigurie. Pra, po të jesh prokuror, duhet të përmbushësh disa kritere sigurie, po të mos jesh prokuror, nuk përmbush asnjë kritere sigurie. Kjo është paradoksale. Përkundrazi, duhet të jetë krejt ndryshe. Kjo duhet riformuluar. Pastaj mund të jetë një prokuror i caktuar me këtë funksion dhe më pas, të vihen kushtet e tjera: duhet të ketë arsim të lartë në drejtësi, në nivelin Master nga të cilat njëra duhet marrë jashtë Shqipërisë, duhen riformuluar. Nuk e di arsye pse e keni vendosur. Mjafton të vendosen kriteret e funksionimit të prokurorisë. Unë e kuptoj. Ju keni të drejtë se me këto që kanë ndodhur vitet e fundit nuk është çudi që të jesh veteriner dhe të bëhesh ndërlidhës. Kjo është e vërtetë, por të paktën riformulojeni se kemi një shprehje që nuk e di sa e kanë kroatët këtë shprehje: “Kur digjesh nga qulli, i fryn kosit”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëro?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni, zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Në vazhdim të këtij riformulimi, unë kam diçka, në lidhje me kriteret. Lidhur me ndërlidhësin, a do të mjaftonte vetëm që të ketë minimalisht arsim të lartë në drejtësi, në nivelin Master, pa e përcaktuar se në çfarë fushe, përvojën etj.?

Unë them që përveç faktit që duhet të ketë minimalisht 5 vjet përvojë në fushën e drejtësisë penale, se mund ta ketë në drejtësinë familjare, administrative etj. Do të doja ta shmangnim edhe kushtin, që të ketë marrë detyrimisht një diplomë jashtë Shqipërisë. Mos është diskriminim ky? Mund të themi që kanë përparësi ata që kanë një diplomë Master të marrë jashtë Shqipërisë në fushën e drejtësisë penale, varet çfarë do të vëmë, por besoj se duhet ta saktësojmë. Ai mund të ketë një diplomë Master në të drejtën e detit, apo në një fushë tjetër. Këto kriteret duhet të saktësohen. Pra, kur flasim për një prokuror, është më e qartë, por kur flasim për një tjetër person, që nuk është prokuror, duhet të jetë akoma më e qartë.

Faleminderit!

Jon Smibert – *(përkthen përkthyesja)* Çështja e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe e ndërlidhësit është jo vetëm për ndihmë, por edhe për të koordinuar hetimet ndërkombëtare që mund të na dalin, është pjesë e detyrimeve sipas marrëveshjeve ndërkombëtare. Ideja për të pasur një diplomë të marrë jashtë Shqipërisë, është sepse kur flet me dikë nga Gjermania, nga Franca, nga Greqia, apo ndonjë vend tjetër jashtë Shqipërisë, mund të jesh më i familjarizuar me standardet dhe proceset që janë në vendet e tjera. Pra, kërkohet që fillimisht personi të jetë jo vetëm i zoti të përkthejë, por të përkthejë edhe konceptet që na vijnë nga vendet e tjera. Mund të vijë nga vendet që e kanë të drejtën civile e kështu me radhë, që kanë eksperiencë dhe praktika të ndryshme.

Gjithashtu, duke pasur parasysh burimet njerëzore këtu, në Shqipëri dhe burimet njerëzore për prokurorinë, patëm diskutime, nëse personi duhet apo nuk duhet të jetë prokuror dhe formulimi erdhi kështu, sepse çfarë ndodh, nëse kemi dikë që është poliglot dhe caktohet në prokurorinë speciale apo ai person që caktohet në prokurorinë speciale, duhet të flasë anglisht apo gjuhë të tjera?

Fatmir Xhafaj – Ne biem dakord, por duhet riformuluar ndryshe: ndërlidhësi mund të jetë prokuror, në rastin kur ka një mundësi të tillë apo një person i jashtëm që ka statusin e një

prokurori dhe duhet të plotësojë disa kriteret dhe të thuhet kriteret. Sa më shumë të jenë, aq më mirë. Nuk ka asgjë të keqe, përkundrazi thashë se nga praktika jonë, realiteti që ka ndodhur, të dikton të thuash gjëra që nuk duhet të ndodhin, por që faktikisht kanë ndodhur. Ne prandaj jemi që ta përmirësojmë problematikën që kemi pasur dhe ligji është një mënyrë për ta bërë këtë. Është vetëm çështja e formulimit i gjithë ku nen që të jetë më i qartë.

Dakord?

Faleminderit shumë për mirëkuptimin!

Si shpjegohet që jeni shumë mirëkuptues? Dashuri madhe për SPAK-un apo për profesionin e zonjës Hysi dhe zotit Manja?

Arben Rakipi – Nuk e di nëse në procedurë na lejohej të bëjmë komplimente, apo jo, por zonja Hysi është një studiuese e thellë e lëndës. Zoti Manja, gjithashtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Komplimente!

Fatmir Xhafaj – Ajo ka mësuar gjithë ata. E pranojmë edhe ne këtë. Edhe unë dua t'i komplimentoj dy kolegët e mi. Më vjen shumë mirë, që i komplimentuat edhe ju.

Faleminderit!

Vazhdojmë me nenin 23, se mos ju rritet mendja tani.

Vasilika Hysi – Lidhur me nenin 23, “Detyrat e ndërlidhësit”, sugjerojmë që pikën “c” ta riformulojmë. Këtu ka dy kompetenca. Kompetenca e parë, lidhet me hetimet e përbashkëta brenda territorit të Shqipërisë, ku ndërlidhësi mbikëqyr zbatimin e rregulloreve të brendshme etj.

Pika e dytë, ku thuhet: “Në lidhje me dobësitë e verifikuara dhe çështjet e debatuar nëpërmjet konsultimeve me organet kompetente të shtetit tjetër, ai informon pa vonesë ...”, ta nxjerrim më vete. Do të bëhet: “Informon pa vonesë drejtuesin e prokurorisë së posaçme, lidhur me çështjet, (jo dobësitë e identifikuar), problematikën etj...”. Këto duhet t'i saktësojmë mirë dhe këtu duhet të jenë shumë të qarta kompetencat: 1, 2, 3, 4. Të mos jenë brenda një pike 2-3 detyra.

Të njëjtën gjë kemi edhe për paragrafin e dytë, për pikën “b” për të cilën sugjerojmë të riformulohet dhe të ndahet, sepse është shumë e gjatë. Ndoshta në anglisht tingëllon mirë.

Fatmir Xhafaj – Ok.

Urdhëroni, zoti Rakipi!

Arben Rakipi – Çështja e gjatësisë së dispozitës, mund të ndreqet, por lidhur me saktësimin e detyrave, siç e përmendi edhe deputetja Hysi, kam idenë që përdorimi i termave të përgjithshme është më i saktë, sepse ne asnjëherë nuk e dimë se çfarë mund të ndodhë. Pra, çështja e hetimit të përbashkët na drejton dhe na orienton të kuptojmë, të gjithë gamën e veprimeve procedurale që mund të ndodhin në këtë çështje dhe ai, përgjegjësi duhet të reagojë, si për shembull: për hetimin pa leje, pyetjen e njerëzve pa leje e kështu me radhë. Pra, personi i ngarkuar duhet të reagojë për çdo rast, ku sheh cenim të sovranitetit të Republikës së Shqipërisë, ose parregullsi të tjera. Sa mund të jenë ato parregullsi, është e pamundur ta shënojmë, prandaj terminologjia e përdorur është përmbledhëse.

Fatmir Xhafaj – Dakord me sugjerimet?

Miratohet neni 23.

Neni 24. Koordinatori për marrëdhëniet me medien.

Vasilika Hysi – Lidhur me këtë nen ne kemi bërë thjesht riformulime të këtij problemi. Kam një pyetje. Ju thoni këtu që personi i autorizuar për të folur me mediet...

Fatmir Xhafaj – Më fal, përpara kësaj hiqeni këtë fjalën “shtypi i një agjencie publike, organizatë ndërkombëtare apo ambasade.”

Vasilika Hysi – Këtë do të thosha. T’i marrim me radhë.

Fatmir Xhafaj – Bëjeni “me eksperiencë në këtë fushë me agjencitë e organizatave vendase dhe ndërkombëtare”, sepse duket sikur...

Vasilika Hysi - Pyetja është, me të drejtë ma kujton edhe zoti Manja: Koordinatori për marrëdhëniet me mediet do të jetë prokuror? Sepse në ligjin “Për statusin e gjyqtarit dhe të prokurorit” ne kemi thënë që në nivelin e një gjykate oseprokurorie një nga magjistratët mund të shërbejë si koordinator për marrëdhëniet me medien.

Nga ana tjetër, në paragrafin e 3 ju thoni që koordinatori i marrëdhënieve me mediet ka diplomë...

Fatmir Xhafaj – E qartë. Dakord. Le të ndjekim logjikën e ndërlidhësit, zonja Hysi. Pra, kur kemi ia japim funksionin atij prokurori. Kur nuk kemi...

Vasilika Hysi – Atëherë, duhet të reflektojmë te ligji “Për statusin e gjyqtarit dhe të prokurorit”.

Fatmir Xhafaj – Nuk është e thënë, sepse në kushtet e një gjykate të vogël nuk mund të marrësh një... Kurse këtu e ke të domosdoshme. Pra, duhet të bëjmë dallimin.

Është njësoj sikur të thuash që në Prokurorinë e Përgjithshme ai duhet të jetë prokuror, sepse e kemi caktuar te ligji “Për statusin e gjyqtarit dhe të prokurorit.” Më vjen keq!

Vasilika Hysi – Pyetja e dytë. Lidhur me koordinatorin për marrëdhëniet me mediet, prokuroria do të ketë koordinatör më vete dhe gjykata më vete? Dua ta saktësoj këtë me qëllim që të reflektojmë edhe te ligji “Për statusin e gjykatësit dhe të prokurorit.”

Fatmir Xhafaj – Nuk ka lidhje ajo, Vasilika.

Vasilika Hysi – Jo, kemi thënë që të njëjtat rregulla zbatohen...

Fatmir Xhafaj – Ai që është koordinatör për marrëdhëniet me mediet është një person nga gjykata, për shkak të numrit të kufizuar që bën edhe këtë detyrë shtesë. Kurse këtu është një njeri që ka vetëm këtë funksion.

Ai mund të jetë një prokuror kur i plotëson kushte të tilla, por mund të jetë një, siç thamë te rasti i ndërlihdësit, që nuk është prokuror, por merr të njëjtin status mbrojtjeje, vlerësimi dhe sigurimi si një prokuror, për shkak të detyrës që bën.

Vasilika Hysi – Unë dua ta saktësojmë këtë...

Fatmir Xhafaj – Nuk ka lidhje me statusin.

Vasilika Hysi – Jam shumë dakord. Te ligji “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit” duhet të themi se rregulli që duhet të jetë një magjistrat bën përjashtim në rastet e prokurorive të posaçme. Pyetja është: A do të ketë edhe gjykata e posaçme...

Fatmir Xhafaj – Këtu nuk e ke dhe nuk ka pse ta ketë. Ndjeshmëria në gjykatë, gjykimi është publik.

Vasilika Hysi – Ne kemi vënë një rregull që gjyqtarët nuk mund të flasin për çështjet e tyre. Do të kenë një zëdhënës që do të flasë.

Fatmir Xhafaj – Më falni, ju lutem, po te statusi juaj që përmendet, si është? Një magjistrat. Në rregull. Edhe atje do të jetë një magjistrat. Këtu do të ketë një përjashtim, sepse është specifike. Ka një lloj ngarkese mediatike, ka nevojë për transparencë shumë më të madhe se atje. Atje është transparencë vetë gjykimi. Kurse ky nuk është transparencë hetimi dhe ka nevojë të sqarohet për aq sa mund të sqarohet dhe për ta mbajtur të informuar publikun.

Ulsi Manja – Mmund të bëj një ndërhyrje për nenin 24?

Fatmir Xhafaj – Po, urdhëroni!

Ulsi Manja – Duhet të adresojmë një shqetësim që është sot në prokurori. Për shumë vite ka qenë problem. Koordinatori i marrëdhënieve me mediet do të jetë personi i autorizuar.

Ky person i autorizuar e nënkupton faktin që mund të jetë edhe një prokuror i kësaj zyre? Pse? Sepse kjo strukturë do të hetojë vepra penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar me një ndjeshmëri shumë të madhe për publikun.

Në rast se do të dilet përpara, të informohet publiku pa cenuar sekretet e hetimit, mund të gjendesh përballë pyetjeve të gazetarëve që ky person i autorizuar dhe i specializuar në fushën e medieeve, nuk e bart detyrimin për të ditur se ku fillon dhe ku mbaron sekreti hetimor.

Ndaj, te ligji “Për statusin e magjistratëve”, është lënë që komunikimin me publikun ta ketë një person, magjistrat, i cili përpos detyrave funksionale që ka gjyqtar ose prokuror, të ketë disa aftësi të tjera në komunikimin me publikun.

Fatmir Xhafaj - Ideja është po ta ketë një prokuror këtë cilësi, shumë mirë.

Ulsi Manja – Pyetja është: A e nënkupton personi i autorizuar fjalën “prokuror”?

Fatmir Xhafaj – Koncepti është, po të kemi një prokuror ekspert për mediet do të vendosim atë, por në kushtet që mundësia më e madhe është të mos e kemi një prokuror ekspert që të dijë të bëjë edhe profesionistin e medias do të marrim një profesionist të medias, i cili do të trajnohet, kualifikohet dhe të di kufijtë e punës së tij. Të mos e zgjasim shumë se nuk është thelbësore.

Vasilika Hysi – Përderisa ju thoni që koordinatori është personi i autorizuar për të folur me medien, mendon se ky është një person që prokurori mund të autorizojë edhe dikë tjetër në pozitën e koordinatorit? Ndërsa, po të ishte si thoni ju, që është koordinatori për marrëdhëniet me publikun, është person...

Pozicioni i këtij personi është shumë i rëndësishëm dhe unë e lidh me kompetencat që ju i keni dhënë në paragrafin e 4. Ju thoni që koordinatori i marrëdhënieve me medien informon publikun për rrezikun dhe dëmet e korrupsionit.

Fatmir Xhafaj – Është shumë e rëndësishme kjo?

Vasilika Hysi – Pyetja ime është: Pse vetëm për korrupsionin, rrezikun dhe dëmet e korrupsionit dhe nuk përmendni krimin e organizuar? Sepse do të ishte me shumë interes për t’u ofruar informacion viktimave të krimit të organizuar, ose të ofrojmë informacion se si mund të adresohet një kërkesë një ankesë.

Fatmir Xhafaj – Shikojini dhe i reflektoni edhe këto me ndryshimet.

Miratohet.

Neni 25. Seksioni për asistencën për individët me status të posaçëm.

Ka ndonjë gjë që është thelbësore përveç reflektimit të teknikës?

Keni pyetje? Urdhëroni!

Vasilika Hysi – Lidhur me pikën 2 pse duhet të themi “të paktën dy koordinatorë?” Këtu flitet për koordinatorë? Cilat do të jenë kompetencat ose çfarë lloji kriteresh do të përmbushin përveç faktit që duhet të kenë mbaruar një diplomë nga një universitet i licencuar që ofrojnë programe?

Fatmir Xhafaj – Ju lutem, pikat 2 dhe 3 t’i shkrijmë te pika 1 që të mos ketë shumë pika. E dyta të ketë kualifikimin në fushën përkatëse.

Vasilika Hysi – Ky është seksion shumë i rëndësishëm në vlerësimin tim, pasi ky ofron mbështetje për viktimat e krimit etj, dhe duhet të ketë disa kritere. Nuk mjafton thjesht të ketë një diplomë.

Fatmir Xhafaj – Domethënë duhet të ketë kritere, kualifikim në fushë.

Vasilika Hysi – Kualifikime në fushë dhe duhet të dijë...

Fatmir Xhafaj – Dakord, pra duhet të ketë një diplomë nga një universitet i licencuar. Pse mund të merret nga një universitet i palicensuar? Ma gjeni këtë!

Faleminderit!

Miratohet edhe neni 25 me ndryshimet.

Neni 26. Mbikëqyrja e punonjësve dhe ekspertëve. Si është ky titull, sepse nuk e kuptoj. Keni vetëm ndryshime teknike?

Vasilika Hysi – Terminologjia këtu duhet të ndryshonte dhe të ishte në përputhje me terminologjinë që është përdorur në ligjin “Për statusin e magjistratit”. Kur themi “mbikëqyrje”, këto janë të gjitha procedura të rekrutimit, të formimit vazhdues, procedurat disiplinore, procedurat e vlerësimit të ekspertëve. Ky është një sugjerim për paragrafin e parë.

Lidhur me paragrafin e dytë, kur thuhet “prokurorët e posaçëm mbikëqyrin çdo punonjës dhe ekspert në hetime dhe në çështje që u janë caktuar”, përsëri dua të qartësohesha: E mbikëqyrin nga pikëpamja administrative në këtë rast apo merren me përmbajtjen?

E treta, termi “special” nuk e kemi përdorur më parë në ligj. Unë shikoj që në nenin 26 dhe 27 përdorim për herë të parë termin “special”. Ndërkohë që ne kemi “prokuror të posaçëm”. Pra, bëhet fjalë për të njëjtën kategori apo janë dy kategori të ndryshme?

Korajlka Bumçi – (përkthen përkthyesja) Është e njëjta kategori. Edhe pse përdoret termi “special”, duhet “i posaçëm”.

Fatmir Xhafaj – Duhet formuluar dhe kam një gjë, Moza, këtu flasim për departamente. Kur shkojmë te struktura, te neni që kaluam, ishte seksione. Tani vendoseni departamenti atje, kur e shikoni ligjin një të tërë...

Diskutojeni dhe përdorni një terminologji. Departamenti si koncept në administratë është më i madh se seksioni.

Dakord për t'u riformuluar neni 26. Edhe pika 3 ka nevojë të riformulohet. Për shembull nuk mund të thuhet “ajo që ndalohet para asaj që i lejohet.” Mund të thuhet “ekspertët japin mendimin bazuar në prova, fakte, ekspertizë dhe rezultate analizash”, por ata nuk mund të shprehen thjesht mbi udhëzimet e prokurorit special për themelin.

Neni 27. Pushimi i çështjes ose akuzave nga prokurori special.

Vasilika Hysi – Unë këtë nen do ta lidh pikërisht me një nen që ne e diskutuam pak më parë dhe që kishte të bënte me nenin 17, kompetencat e prokurorisë së posaçme.

Ndoshta e kuptoj gabim, por në logjikën e krijimit të kësaj strukture, ne kemi thënë që prokurorët janë të pavarur. Pra, prokurorët e posaçëm janë të pavarur nga njëri-tjetri.

Tani në këtë nen prokurorëve të tjerë u japim shumë kompetenca. Unë e kuptova shumë mirë zonjën Bumçi që tha se një prokuror i vetëm të mos marrë përgjegjësinë dhe duhet të ketë një vendim kolegjal.

Çfarë do të ndodhte nëse mbledhja e prokurorëve bazuar në relatorin e ri që cakton, ia hedh poshtë mënyrën e vendimit dhe i thotë prokurorit të posaçëm që ka hetuar që e njeh shumë mirë çështjen, se pushimi i çështjes është i pabazuar, nuk duhet ta pushosh çështjen, duhet ta çosh në gjyq. A ka cenim të këtij parimi të pavarësisë?

Korajlka Bumçi – (*përkthen përkthyesja*) Në këtë nen, në kuptimin që ndoshta duhet ta prezantojë përpara trupit kolegjal, që do ta kalojë çështjen, trupi kolegjal nuk do të ketë të drejtën të marrë vendimin përfundimtar. Pra, e diskutuam edhe me njëri-tjetrin, do ta riformulojmë, që të mos e diskutojmë më.

Fatmir Xhafaj – Neni 27 miratohet me ndryshimet me riformulimet.

Vasilika Hysi – Më fal, se ju drejtoni të gjithë paketën. Në nenin 27 kemi një referim te ligji “Për Prokurorinë e Përgjithshme”. A do të ketë ndonjë ligj për Prokurorinë e Përgjithshme apo ky shfuqizohet?

Fatmir Xhafaj - Është ligji “Për Prokurorinë e Republikës së Shqipërisë.”

Vasilika Hysi – Dakord.

Korajlka Bumçi – *(përkthen përkthyesja)* Ne në versionin e anglishtes nuk e kemi ligjin te Prokuroria e Përgjithshme. Pra, ndoshta është gabim i përkthimit.

Fatmir Xhafaj – Përkthimi nga shqipja në anglisht ka qenë më i mirë se në shqip.

Dakord.

Neni 28. Apelimet.

Vasilika Hysi – Po e nis me titullin, lidhur me apelimin mendojmë të përdorim termin “ankimimi”, sepse në të gjitha rastet kemi përdorur termin “ankimim”.

Gjithashtu, për paragrafin e parë sugjerojmë të sqarohet pak më mirë. Nuk është vendi të themi që nuk ka prokurori të veçanta për Gjykatën e Shkallës së Parë dhe Gjykatën e Apelit, sepse këtu flasim për ankimimin. Nëse ne duam ta bëjmë të qartë strukturën e këtyre institucioneve të posaçme, duhet ta bëjmë në një nen të mëparshëm.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 28, miratohet me riformulimin.

Neni 29. Detyrimet e autoriteteve të tjera shtetërore.

Dakord me riformulimin që është bërë këtu.

Faleminderit!

Neni 30. Detyrimet e Policisë së Shtetit.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, këtu kam disa pyetje, sepse shikoj komentet e Ministrisë së Drejtësisë.

Në nenin 30, paragrafi 2, ju thoni që pas marrjes së informacionit prokuroria e posaçme, nëse vlerëson që është kryer një veprë penale... Sugjeroj që duhet të thotë “nëse ka dyshime të arsyeshme”, “nëse është kryer një veprë penale”. Në qoftë se e ka vlerësuar që është kryer një veprë penale, nuk ka pse të fillojë hetimin.

Shprehja “mund të fillojë punën për atë çështje” çfarë do të thotë? Do të fillojë hetimin, do të fillojë ndjekjen penale, do të bëjë verifikimin e të dhënave që ka? Këtu do të doja edhe ndihmën e kolegut Manja dhe të zotit Rakipi, që janë profesionistë, prokurorë me përvojë të gjatë.

Lidhur me nenin 3, sugjeroj që në vend të fjalës “shkelje” të përdorin “vlerëson se nuk ka të dhëna të mjaftueshme”, “të dhëna që jemi përpara kryerjes së një vepre penale”.

Lidhur me pikën 4 thuhet që pas raportimit, nëse drejtuesi i prokurorisë së posaçme çmon se vepra penale e dyshuar, që është kryer, nuk i përket reduksionit të saj, prokuroria

njofton zyrën përkatëse të prokurorisë të vazhdojë procedurën. Pra, unë shqetësimin e kam për këtë “si dhe informon çdo strukturë tjetër të duhur.” Cili është kuptimi “informon çdo strukturë tjetër të duhur”? Cilat janë strukturat e tjera të duhura?

Gjithashtu, në pikën 5, ndoshta nuk është në variantin anglisht, mund të jetë në shqip. Ju thoni që në bazë të kërkesës së një prokurori të posaçëm ose në përputhje me urdhrat e drejtuesit të prokurorisë së posaçme oficerët e policisë së shtetit shqiptar, ose një agjent, ose një oficer i Policisë Gjyqësore... I cilës? Sepse këtu themi oficer dhe policisë së shtetit shqiptar.

E para, ta saktësojmë, pra, flitet edhe për kategoritë e oficerëve dhe agjentëve të tjerë? Dhe kur thuhet “duhet të hetojnë”, është detyruese?

Në paragrafin 6, ju bëni dallimin e oficerëve të Policisë së Shtetit shqiptar dhe më pas thoni një agjent ose një oficer i Policisë Gjyqësore. I cilës? I një shteti tjetër? Pra, këtu flitet për hetime të përbashkëta, për procedime të përbashkëta? Kjo duhet të qartësohet.

Gjithashtu, në lidhje me nenin 30, sugjeroj që detyrimi që ka drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit për të nxjerrë një rregullore mbi metodologjinë e informimit, mund të ishte në fund të fjalisë, sepse mendoj se do të rregullojë të gjithë procedurën e bashkëpunimit midis Policisë së Shtetit dhe strukturave të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Në qoftë se do të ketë bashkëpunime me struktura jashtë Shqipërisë, duhet t’u referohemi marrëveshjeve, të gjitha konventave në fushën juridiksionale. Pra, duhet ta saktësojmë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Besoj se edhe te pika 1, ku thuhet: “në qoftë se një punonjës i Policisë së Shtetit vihet në dijeni për kryerjen e një veprë penale, ai/ajo njofton menjëherë”, besoj se nuk është fjala për çdo lloj veprë penale, apo jo? Sepse mund të jetë për shembull ndonjëri për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor.

Urdhëroni!

Fatmir Xhafaj – Po.

Jon Smibert – (*flet anglisht*) Nëse vërejmë se çfarë përmend Kushtetuta është e gjitha për këta anëtarë të Parlamentit, do të ishte një vepër penale në qoftë se ne do të përjashtonim shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor apo ndonjë gjë tjetër, që unë mendoj se është në fakt ...

Fatmir Xhafaj – E mora si shembull, sepse këtu thuhet: “njofton për çdo lloj veprë penale”. Jo, nuk është për çdo lloj veprë penale. Nuk e kisha për deputetin apo për zyrtarin e lartë si kategori, por e kisha për veprën penale që është në përputhje me juridiksionin e kësaj.

Jon Smibert – *(përkthen përkthyesja)* Në nenin, 30 pika 1, mendoj se në shqip nuk është përfshirë diçka këtu në shpjegim. Në fakt versioni në shqip ka harruar një fjalë e cila ndodhet në versionin anglisht dhe u referohet veprave penale të cilat janë të përcaktuara në kod. Për këtë arsye është ky keqkuptim. Pra, në anglisht është e specifikuar se për cilat vepra penale bëhet fjalë.

Fatmir Xhafaj – Dakord me ndryshimin.

Keni pyetje? Po.

Arben Rakipi – Lidhur me diskutimin nëse agjentët ose oficerët e policisë gjyqësore janë apo jo shqiptarë, bëhet fjalë për shqiptarë. Kjo mbase duhet reflektuar në pikën 5 dhe në pikën 6.

Lidhur me pikën 2 mbase terminologjia e përdorur mund të modifikohet, ashtu siç kritikoi dhe deputetja Hysi. Por ideja është që me të mbërritur e dhëna në prokurorinë e posaçme, ai menjëherë regjistron procedimet dhe fillon hetimin. Kjo është përmbajtja e pikës 2.

Pika 3 bën fjalë për një eventualitet tjetër kur prokurori i Prokurorisë së Posaçme vlerëson se materiali që i ka ardhur nuk lidhet me juridiksionin që ai ka dhe e transferon procedimin në një prokurori që është kompetente. Nëse do të informojë ose jo çdo strukturë tjetër ky është përfundimi i pikës 4 dhe lidhet pikërisht me këtë lloj detyrimi, njofton oficerët e tij të Policisë Gjyqësore, hetuesit e vet të byrosë, edhe Policinë e Shtetit, që nga ky çast të dhënat lidhur me këtë vepër që u kallëzua në prokurorinë e posaçme do t'i dërgoni në prokurorinë e zakonshme, sepse është ajo tani që është kompetente për hetimin e kësaj veprë penale. Kjo është pak a shumë përmbajtja e informimit të çdo strukture tjetër. Mbase ka nevojë për një Shqipëri më të qartë, por kjo është përmbajtja.

Ulsi Manja – Unë kam një pyetje. Dhe sot është më tepër çështje e aspektit praktik në veprimtarinë e bashkëpunimit mes policisë dhe prokurorisë sepse asnjëherë nuk ka pasur rregulla të qarta nga momenti i marrjes në dijeni për kryerjen e një veprë penale deri te fillimi i ndjekjes penale. Pra, momenti se ku ndahen veprimet policore dhe ku fillojnë veprimet e prokurorisë. Është një moment që më tepër këtë e ndan praktika. Problemi është i qartë kur merr dijeni prokuroria e posaçme dhe nëse në juridiksion është e qartë, do t'ia transferojë prokurorisë përkatëse. Por në rast se konstaton që është në juridiksionin e kësaj prokurorie dhe nuk ka elemente të veprës penale, do të ndjekë rregullat e Kodit të Procedurës Penale për vendimin për mosfillimin e ndjekjes penale?

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Rakipi.

Arben Rakipi – Shqetësimi i zotit Manja rregullohet nga procedura penale.

Fatmir Xhafaj – Biem dakord me riformulimin e këtij neni?

Miratohet neni 30, me riformulimin.

Neni 31. Kush do të flasë, zonja Hysi apo zoti Manja?

Vasilika Hysi – Jo, te neni 31 kam një pyetje. Kur thuhet: “Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit të Parave informon Prokurorinë e Posaçme për instrumente”, çfarë do të thotë? Cili është kuptimi?

Fatmir Xhafaj – Me mikrofon, ju lutem!

Arben Rakipi – Ndoshta nuk është fjala e përshtatshme, por bëhet fjalë për mekanizmin, për mënyrën e kryerjes.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jon Smibert –(përkthen përkthyesja) Në anglisht, mjetet financiare...

(Kryetari i komisionit flet pa mikrofon.)

Vasilika Hysi – Për mua, zoti kryetar, ishte e qartë kjo që tha zoti Xhon, por duke dashur të lë disa gjurmë këtu, sepse nuk dua që të kemi më pas, në zbatimin e ligjit, paqartësi dhe konflikte midis institucioneve. Pra, duhet bërë e qartë se Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin dhe Pastrimin e Parave duhet të informojë prokurorinë për transaksione, veprime, blerje, shitje, apo jo, që janë të dyshimta, që themi ne: të ardhura, pasuri e të tjera. Pra, për çdo lloj transaksioni që mund të jetë i dyshuar, që ka të bëjë me pastrimin e produkteve të veprës penale.

Por kur flasim për pastrimin e produkteve të veprës penale, ne kemi bërë ndryshime në Kodin Penal dhe kemi folur jo vetëm për pastrimin e produkteve të veprës penale, por ne këtu kemi folur edhe për rastet kur nuk kemi të bëjmë me vepër penale, apo jo, për ligjin Antimafia, por kemi të dhëna, dyshime, indicie që personi ka disa pasuri që nuk i justifikon, pra jo detyrimisht duhet të kesh një vepër penale. Mund të jetë edhe një veprimtari kriminale.

Në qoftë se ju kujtohet ndryshimi i nenit 287, në mos gaboj tani, të më ndihmojë Ulsi dhe kolegu Rakipi, ne kemi ndryshuar terminologjinë: “Pastrim i produkteve të veprimtarisë kriminale”, e kemi zgjeruar, gjithmonë nëse jam e saktë.

Arben Rakipi – Saktë jeni. Në këtë rast, bëhet fjalë vetëm për ndjekjen penale. Domethënë, rregullimi i “a-së” nuk ndikon as te ligji Antimafia; është histori tjetër.

Fatmir Xhafaj – Biem dakord me nenin 31, me ndryshimin e diskutuar?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, pra, dakord me ndryshimin. Do ta gjeni ju.

Neni 32 “Byroja Kombëtare e Hetimit”.

Vasilika Hysi – Lidhur me Byronë Kombëtare të Hetimit, kam një pyetje në lidhje me paragrafin e pestë për buxhetin. Në qoftë se i qëndrojmë sugjerimit që dhatë ju, zoti kryetar, që kur bëhet fjalë për buxhetin, duhet të përdorim pak a shumë të njëjtën terminologji që janë te rregulli, pyetja ime qëndron dhe këtë e kam për ekspertin: “Buxheti i Byrosë Kombëtare të Hetimit...”, thoni ju “...dhe pagat e oficerëve të Policisë Gjyqësore, të shërbimeve, përfshihen në buxhetin e prokurorisë”. Pagat e oficerëve të Policisë Gjyqësore të shërbimeve nuk janë pjesë e buxhetit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, që duhet t’i diferencojmë?

Oficerët e Policisë Gjyqësore të shërbimeve të Byrosë Kombëtare të Hetimit kanë vetëm paga, apo kanë edhe buxhet, kosto të tjera...? Në rast se ju do të lini vetëm pagat, mund të përjashtoni nga buxheti zëra të tjerë.

Sugjeroj që kjo të qartësohet dhe në bazë të qartësisë të kemi edhe një riformulim.

Jon Smibert – *(përkthen përkthyesja)* Sigurisht, është edhe e mundur. Nuk e di si përcaktohen buxhetet sipas legjislacionit tuaj, por thjesht për të thënë që buxheti i BKH-së dhe i shërbimeve të Policisë Gjyqësore, thjesht për të përcaktuar vetëm pagat, mendoj se do të ishte e papërshtatshme për ta adresuar këtë, pasi qëllimi këtu është që buxheti për atë çfarë BKH-ja heton dhe Policia Gjyqësore është e bashkëngjitur me të, vetë Zyra e Prokurorisë së Posaçme mund të jetë nën kontrollin e saj ose nën kontrollin e dikujt tjetër. Ky ishte qëllimi kryesor i kësaj pike.

Fatmir Xhafaj – Ideja e kësaj është që do të ketë një buxhet, nuk do të ketë një buxhet për prokurorinë, një buxhet për atë, prandaj duhet thënë: “Pagat e oficerëve të Policisë Gjyqësore...”

Vasilika Hysi – Jo pagat.

Fatmir Xhafaj – Prit, pra, një minutë!

“...dhe shpenzimet për veprimtarinë e... janë pjesë e buxhetit”. Kaq, pikë. Kur të bëhet formulimi...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po.

Arben Rakipi – Pika 5 duhet parë në raport me pikën 4. Ideja është kjo që çfarë do të thërrasë prokuroria nga shërbimet, sipas renditjes së pikës 4, do t'i paguajë vetë ajo.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për të hequr gjithë atë kaos që ekziston sot.

Prandaj është theksuar te pika 5 se çfarë do të ndodhë me oficerët e shërbimeve, që do t'i vijë kësaj prokurorie nga Policia e Shtetit.

Vasilika Hysi – Duhet qartësuar.

Arben Rakipi – Këta të fundit do të paguhet nga buxheti i prokurorisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po.

Fatmir Xhafaj – Edhe kur është i përkohshëm? Vjen të punojë gjashtë muaj?

Arben Rakipi – Ka disa rregulla më poshtë, që vjen për dy vjet, ku e di unë se çfarë, dhe pagën do t'ia paguajë prokuroria.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Në rregull, dakord.

(Deputetja Hysi ndërhyrje pa mikrofon.)

Po?

Vasilika Hysi – ...për të ndihmuar për buxhetin, zoti Rakipi, përveç pagave dhe shërbimeve, ka edhe kosto të tjera. Të gjitha duhen paguar nga Prokuroria e Posaçme për aq kohë sa personi i shërben Byrosë Kombëtare të Hetimit?

Arben Rakipi – Domethënë, qëllimi ynë ka qenë të qartësojmë njëherë e përgjithmonë faktin se oficerët e policisë që vijnë nga Policia e Shtetit, ajo Tatimore e të tjerë, e shkëpusin lidhjen me origjinën dhe do të paguhet këtu.

Ky ka qenë shqetësimi kryesor. Pastaj është e kuptueshme që çdo gjë që rrotullohet rreth kësaj marrëdhënieje pune do të paguhet nga prokurori përkatës.

Fatmir Xhafaj – Në rregull. Biem dakord?

Miratohet, me ndryshimet (me riformulimet që do të bëni).

Neni 33 “Punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit”.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, unë kam një pyetje për paragrafin e parë të këtij neni. Këtu flitet për kriteret që duhet të përmbushin kandidatët për punonjës ose oficerët e shërbimeve të Policisë Gjyqësore. A mos është përsëritje, me kriteret e përcaktuara në nenin 8 të po këtij

ligji? Edhe fjalia e dytë: “Një kandidat nuk mund të emërohet në Byronë Kombëtare të Hetimit apo në shërbime pa plotësuar kriteret dhe pa iu nënshtruar kushteve të sigurisë” është thënë disa herë në ligj.

Unë e kuptoj shqetësimin se sa shumë rëndësi i është dhënë faktit që duhet të ketë disa parakushte lidhur me sigurinë, se do të flasim edhe për pjesën e shëndetit e të tjera, por mos e rëndojmë ligjin duke përsëritur të njëjtat gjëra? Të themi: “Kandidatët për punonjës ose oficerë të shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit...”, të gjithë, se nuk kemi pse të themi: “përfshirë drejtorin, zëvendësdrejtesin e të tjerë”, duhet të përmbushin kushtet e sigurisë të përcaktuara në nenin 8 të këtij ligji. Kështu i kemi thënë të gjitha. Te neni 8 është me detaje çdo lloj gjëje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Me mikrofon, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull.

Miratohet, me ndryshimin.

Neni 34 “Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit”.

Vasilika Hysi – Nuk kemi mbaruar, se po pyes pak zotërinë.

Fatmir Xhafaj – Ndjesë!

Ulsi Manja – Kam një pyetje. Në nenin 33, ku flitet për punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, bëhet një përshkrim se cilët do të jenë punonjësit e kësaj Byroje, dhe fillon që me drejtorin, zëvendësdrejtorin, hetuesit, punonjësit deri tek administrata. A mos është e nevojshme ta përfshijmë, të kthehemi te neni që folëm për përkufizimet dhe ta japim aty përkufizimin e punonjësit të Byrosë Kombëtare të Hetimit? Sepse në ligj përmendet diku termi “punonjës”, për ta bërë kështu të qartë se cilët janë punonjës. A mos duhet ta vëmë te përkufizimet?

Vasilika Hysi – Ose edhe këtu; nuk është e thënë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Vasilika Hysi – Në mbështetje të sugjerimit të zotit Manja, për të krijuar një ide se cilët janë punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, unë kam një pyetje më pas për paragrafin e dytë të po këtij neni. Ju këtu thoni rëndësinë që ka, se askush nuk mund të emërohet pa mbaruar më parë një program trajnimi të miratuar nga Komisioni i Pavarur i Rishikimit, qoftë drejtor,

zëvendësdrejtor, oficer i shërbimeve të Policisë Gjyqësore. Absolutisht jam dakord, por a mos duhet thënë me një fjali: “Kandidatët për drejtor, zëvendësdrejtor, hetues, oficer të shërbimeve të Policisë Gjyqësore, të cilët përmbushin kriteret dhe kushtet e sigurisë, para se të fillojnë të emërohen, të kenë përfunduar me sukses një program trajnimi të miratuar nga Komisioni i Pavarur i Rishikimit”?

Qartë dhe saktë, pra janë dy kushte, nuk mund të punosh në këtë institucion pa përmbushur kushtet e sigurisë dhe, e dyta, pasi i ke përmbushur ato, detyrimisht do të kalosh një program trajnimi, të miratuar nga Komisioni i Pavarur. Nuk ka rëndësi se çfarë je: drejtor, zëvendësdrejtor, punonjës, oficer.

Pra, t’i numërtojme, t’i kemi të qarta për këdo, sepse fjalia e parë e paragrafit të dytë dhe fjalia e dytë tregojnë të njëjtën gjë: të gjithë duhet të kalojnë një program trajnimi, të miratuar nga Komisioni i Pavarur i Rishikimit. Në këtë mënyrë jo vetëm që pastrohet gjuha, por janë shumë të qarta detyrimet që duhet përmbushin personat dhe kush do t’i përmbushë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Me mikrofon, ju lutem!

Fatmir Xhafaj – Ja, një minutë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, me mikrofon.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull, dakord.

Vazhdojmë me nenin 34.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Për nenin 34 kam një pyetje dhe pastaj një sugjerim për një riformulim. Në pikën 4 të këtij neni është theksuar: “Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit raporton te një komision i përbërë prej 3 prokurorësh të Prokurorisë së Posaçme, njëri prej të cilëve është drejtuesi i saj dhe dy të tjerët zgjidhen çdo vit me short”. Pra, mendohet se do të ndryshojnë.

Pyetja ime është: pse detyrohet drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit të raportojë? E dyta, përse do të raportojë?

Fatmir Xhafaj – Te neni 34?

Vasilika Hysi – Po.

Do të raportojë për aspektet administrative të punës, për problemet e buxhetit, apo për përmbajtjen e çështjeve? Kjo duhet qartësuar.

E dyta, që i takon më shumë teknikës legislative lidhur me paragrafin e dytë. Këtu hidhet një ide që rekomandimin për një kandidat për drejtor të Byrosë do ta bëjë një komision i përbërë nga drejtori i Prokurorisë së Posaçme dhe dy prokurorë që kanë eksperiencë më shumë vite pune.

Vite pune në fushë, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tani kam dy pyetje. Në momentin fillestar kur do të ngrihet kjo Byro Kombëtare Hetimi, cilat do të quhen “më shumë vite eksperiencë pune:” eksperiencia e mëparshme? Kjo ishte e para.

E dyta, përderisa kemi një proces rekrutimi të hapur dhe transparent që ka një sërë kushtesh, ky komision është i vlerësimit të përmbushjes së kushteve? Nëse është ky, unë mendoj se paragrafi i dytë duhet riformuluar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më pas të themi se çfarë kriteresh, se sa është mandati i drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe nëse ka të drejtë të rizgjidhet ose jo.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Smibert.

Jon Smibert – *(përkthen përkthyesja)* Fillimisht kur thuhet: “Me një proces të hapur, transparent rekrutimi”, është komiteti për prokurorët e veçantë dhe dy prokurorët me eksperiencën më të gjatë, çka do të thotë jo me më shumë vite eksperiencë. Nuk është 9, 10, 11, 12 vjet, por 11 dhe 12, pra ai me vitet më të shumta. Për ta thënë më qartë, janë ata me eksperiencën më të lartë, me numrin më të lartë të viteve.

Për sa i përket pyetjes së dytë: “Cili është qëllimi për të pasur në Byronë Kombëtare të Hetimit, përveç kryeprokurorit, edhe dy prokurorë të tjerë?, ka pasur një diskutim politik të gjatë këtu sesi drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit do të kontrollohet dhe një nga metodat që u diskutua, kaloi edhe këtu dhe u miratua pas shumë diskutimesh, duke pasur këtu një grup prokurorësh.

Qëllimi është që të mos ndërtojmë korporatizmin dhe për të mos pasur një a dy njerëz që drejtojnë gjithë botën. Pra, duke pasur një grup njerëzish, kemi një transparencë në të gjithë procesin. Prandaj preferohet të kemi disa njerëz, jo vetëm një ose dy.

Vasilika Hysi – T’ju bëj një pyetje: a shihni një konflikt interesi midis vartësve dhe eprorit, pra që drejtori të raportojë te një komision i përbërë nga vartësit e tij dhe që këta të fundit të gjykojnë drejtorin e Byrosë Kombëtare të Hetimit?

Ndoshta nuk isha e qartë te pyetja që bëra në fillim: përse do të raportojë drejtori për funksionet që ai ka në administrimin e stafit, të personelit të rekrutimit apo edhe për përmbajtjen, pra për efektivitetin e punës së kësaj drejtorie në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe hetimit të akuzave për funksionarët dhe ish-funksionarët e lartë?

Jon Smibert – *(përkthen përkthyesja)* Në anglisht thuhet: “do të mbikëqyret”. Kjo nuk ka të bëjë direkt me raportimin me numrin e çështjeve apo... Pra, mbikëqyret nëse bën diçka të gabuar ose nëse është e nevojshme që t’i tregohet, t’i thuhet që të rregullojë disa veprime ose diçka që po ndërtohet nga zyra e prokurorisë dhe nuk po respektohet apo nuk po zbatohet mirë nga Byroja Kombëtare e Hetimit. Pra, është e qartë në variantin e anglishtes. Mund të jetë: “raportim” ose mund të jetë: “drejtuar”, pra qëllimi është që drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit nuk është një organ më veçan, nuk bën çfarë të dojë ai, por ka një mekanizëm që e mbikëqyr atë për të minimizuar mundësinë që dy njerëz të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe të sulmojnë dikë të cilin, për shembull, ata nuk e pëlqejnë, pra të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për t’i bërë keq dikujt që nuk e pëlqejnë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vasilika Hysi – Ndërkohë, unë do të sugjeroja që ta riformulonim, për ta qartësuar përse raporton drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit, ndoshta duke bërë edhe referencën te neni ku thuhet funksionet e tij.

E dyta, do të sugjeroja, nëse do të ishit dakord, që pikën 4 ta kalojmë pikë 3 dhe, anasjelltas, pikën 3 ta kalojmë pikë 4, pasi mendoj që ky nen ka të bëjë me faktin se kush e zgjedh drejtorin e Byrosë Kombëtare të Hetimit, sa zgjat mandati i tij, ku dhe për çfarë raporton, si dhe e fundit fare, ku duhet të shkojë kur i mbaron mandati. Pra, ai ka të drejtë të kthehet në pozicionin e mëparshëm.

(Kryetari i komisionit flet pa mikrofon.)

Duke qenë se ky nen ka lidhje dhe me të drejtë, zoti kryetar, na kalon te neni 35, duhet ta shohim pak në raport edhe me nenin 35, me “Emërimin”. Ndoshta ajo që thuhet: “sa zgjat mandati dhe a ka të drejtë të rizgjidhet” mund të shkojë te neni 35, se aty qëndron më mirë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

I gjithë procesi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Këto dy nene lidhen me procesin e përzgjedhjes së rekrutimit, emërimit, si dhe me kompetencat, pra edhe me nenin 34, edhe me nenin 35. Ndoshta do të ishte mirë t'i saktësonim.

Nuk kam gjë me përmbajtjen, por përsëri jam e paqartë me variantin shqip për raportimin. Që të mos kemi më problem, e thotë drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit: “nuk raportoj për këtë çështje, nuk e kam në kompetencë”.

Arben Rakipi – Çështja e raportimit këtu nuk ka alternativë që unë nuk raportoj për këtë çështje. Domethënë, ai është një drejtues i hetimit dhe titullarë të tij ka prokurorët.

Çështja e raportimit, pa asnjë dyshim, do të përfshijë edhe çështjet, madje jo vetëm ato, por edhe një raportim më të...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pa diskutim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër, prandaj nuk është...

Gjithçka, patjetër!

Vasilika Hysi – Pra, edhe aspektin administrativ, edhe përmbajtjen?

Arben Rakipi – Po, patjetër!

Domethënë, këtu bëhet fjalë për një raportim tek titullarët e tij. Kështu që nuk ka çfarë fsheh më.

Fatmir Xhafaj – Në rastin konkret nuk kemi titullarë. Këtu ne po krijojmë një komision, një grup. Ndaj duhet ta ndajmë kur ai raporton për veprimtarinë e përditshme administrative, që duhet të raportojë tek titullari i prokurorisë, sepse është veprimtari administrative. Ndërsa kur raporton për çështjet dhe për të mos pasur një lloj korporatizmi e të tjerë, shkon te komisioni i ngritur posaçërisht. Pra, është logjikë tjetër dhe duhet ta ndani këtë gjë, pasi nuk do të mblidhet komisioni të dëgjojë sesi e ka përdorur buxhetin, apo ku ta di unë, administrativisht, çfarë problemesh kanë e të tjerë. Këtu bëhet fjalë që të jetë e organizuar çështja apo rasti kur raportohet për çështjet konkrete, kur debatohet për çështjet konkrete, kur diskutohen çështje konkrete. Në këtë rast duhet të bëhet kjo gjë.

Arben Rakipi – Domethënë, në qoftë se...

Fatmir Xhafaj – Ndajeni raportimin administrativ nga raportimi i funksionit për çështjet konkrete.

Arben Rakipi – Raportimi mund të marrë edhe natyrën proceduralo-administrative. Domethënë, drejtori i hetimit mendon të ndiqet një politikë e caktuar lidhur me mënyrën sesi zhvillohet hetimi në fusha të caktuara, sa para duhen për t'i arritur këto objektiva e kështu me radhë. Pra, është një raportim miks, i cili ndonjëherë nuk mund të pritet me thikë nëse është administrativ apo thjesht procedural. Megjithatë...

(Kryetari i komisionit flet pa mikrofon.)

Vasilika Hysi – Është thjesht riformulim, saktësim sipas sugjerimit që kemi dhënë në tabelë. Nuk kam gjë me përmbajtjen.

(Kryetari i komisionit flet pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – ...te pika 1, mund të vijë nga radhët e Policisë së Shtetit dhe këtu pastaj pretendojmë që mund të jetë edhe një prokuror, pra mund të jetë një polic i rendit, që po të merret karriera e tij, është marrë me kufirin ose me rendin ose drejtori duhet të jetë me arsim të lartë policor ose në drejtësi, ose ekonomi. Tani, sikur e keni zgjeruar pak si shumë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Këtë gjë, e para një herë, se ky është polic. Policia e Shtetit është shumë e gjerë. Kur themi: “Një nga radhët e Policisë Gjyqësore”, në rregull, e kuptoj, sepse është seksioni i Policisë Gjyqësore dhe merr një nga policët më të mirë gjyqësorë, që ka eksperiencë, se për këtë arsye e keni marrë, drejtin, nuk e keni marrë për të kontrolluar kufirin. Iku kjo. Pastaj, kur thoni: e kemi marrë për veprimtari policore/hetimore, duhet të jetë me drejtësi, do të kontrollojë vartësit e tij, do të kontrollojë dosjen, do të flasë për nenet, se nuk do të flasë për seksionet e specializuara që duhet të jetë ekonomist fiskal.

Nga kjo pikëpamje, unë mendoj se edhe formimi në ekonomi duhet hequr.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pra, kufizojmë pak rrethin në raport me atë për të cilin e kemi marrë këtë drejtor, sepse ata të gjithë oficerë të Policisë Gjyqësore janë me këtë *background*.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po?

Vasilika Hysi – ...zoti kryetar, sepse nuk është zbardhur në tabelë dhe mua më shpëtoi. Kam dy pyetje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Shumë ndjesë, pasi te shënimet e mia e kisha, por nuk është zbardhur në tabelë!

Po lexoja kriteret e drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe duke pasur parasysh rolin dhe pozicionin e tij, që është shumë i rëndësishëm, është kërkuar që të mbajë gradën “drejtues i parë” ose “drejtues”, nëse vjen nga Policia e Shtetit. Nga ana tjetër, kemi vënë një kriter: “Përvojë jo më pak se shtatë vjet në hetimin e veprave penale në fushën e korrupsionit, të krimit të organizuar ose të krimeve të rënda”. Unë kam një pyetje, pasi nuk e kam idenë sesi është gjendja në Policinë e Shtetit: sa drejtues të lartë me përvojë mbi shtatë vjet, që të plotësojnë të gjitha këto kriteret, kemi në realitet? Pra, a kemi njerëz që kanë titullin “Drejtues i parë” ose “Drejtues”, pasi janë grada shumë të larta?

Nga ana tjetër, i duam që të kenë edhe gjuhë të huaja, të kenë edhe përvojë, të kenë punuar të paktën shtatë vjet në këtë kategori, në tri grupe.

E kam merak që të mos ngelemi në ndonjë vakum, ku të mos gjejmë njerëzit e duhur, që plotësojnë edhe të gjitha kushtet e sigurisë (neni 8), të bëjnë betimin dhe ato deklaratat në fund për familjen, për veten e të tjerë.

Shqipëria është një vend kaq i vogël, sa kur të vijë bilanci i të gjitha kushteve që duhet të përmbushë një person, të mos ndodhemi në një situatë, ku nuk do të gjejmë persona ose kandidatë të mundshëm.

Më falni që e them!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jon Smibert –*(përkthen përkthyesja)* Këto ishin pyetjet që ne ngritëm kur Ministria e Punëve të Brendshme na ofroi këtë koment. Unë i bëra këto pyetje, por nuk mora ndonjë përgjigje aq të mirë. Për këtë arsye, nëse ju dëshironi ta modifikoni këtë, atëherë kjo do të jetë një arsye që do të thotë: nëse kandidati vjen nga Policia e Shtetit shqiptar, sepse, në fakt, ishte kur kandidati vjen nga Policia e Shtetit shqiptar, ai duhet të jetë një drejtues i parë apo drejtues, ose me përvojë shtatë vjet.

Në fakt, ne menduam se ishte mjaft e kufizuar. Kjo është arsyeja pse ne e kemi zgjeruar pak për të pasur Policinë e Shtetit, Policinë Gjyqësore dhe t’i kenë ndoshta edhe anëtarë të Byrosë Kombëtare të Hetimit, të cilët do të jenë prokurorë, që kualifikohen dhe janë edhe kandidatë për këtë gjë. Pra, duke pasur parasysh këtë pjesë të ligjit, nuk ishte thjeshtë një proces ekspertësh, por ishte një proces që përfshinte mjaft diskutime edhe politike nga partitë dhe

ministritë. Domethënë, ishte një nga pjesët më të rëndësishme të ligjit për t'u hartuar. Ne menduam se përvoja prej shtatë vjetësh mund të ishte ndoshta pak e ekzagjeruar, por ne do të kishim preferuar një përvojë me më pak vite.

Ndërsa për sa i përket gradës “Drejtues i parë” ose “Drejtues”, kjo është një kategori mjaft e lartë dhe ne e kemi kufizuar këtë procedurë vetëm nëse kandidati është punonjës i Policisë së Shtetit, por ai kandidat mund të vijë edhe nga vende të tjera. Për sa i përket arsimimit, nëse ai duhet të ketë një diplomë në ekonomi, ky ishte një nga propozimet të cilat ata bënë dhe ne nuk kishim ndonjë argument të mirë për t'i kundërshtuar, por nëse ju doni ta hiqni këtë gjë, atëherë ne nuk shohim ndonjë problem.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Smibert, por, bazuar të paktën në përvojën time pak modeste në mësimdhënie, të punosh në Byronë Kombëtare të Hetimit nuk mjafton të jesh vetëm ekonomist, por duhet të kesh edhe njohuri në fushën e ligjit. Ne mund të thoshim: “preferohet”, “ka mbaruar Fakultetin e Drejtësisë dhe ka formim në fushën ekonomike” ose “ka formim bazë ekonomikun me një master në degën “drejtësi”.”

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të ketë disa kushte të detyrueshme dhe kriteret shtesë. Pse? Sepse një njeri që ka mbaruar ekonomikun, nuk e di procedurën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ulsi Manja – Ekonomiku të jetë kusht preferencial.

(Kryetari i komisionit flet pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – ...bëjmë kushtet bazë dhe kushtet preferenciale.

Më falni, edhe një herë, të bëjmë një riformulim në tërësi të nenit 35 dhe, ndër të tjera, në riformulimin, krahas këtyre që janë paraqitur në këtë tabelë, të ndajmë edhe kushtet ligjore bazë që duhet të plotësojë kandidati dhe kushtet preferenciale që avantazhojnë...

(Deputetja Hysi ndërhyr pa mikrofon.)

...njërin nga tjetri.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, zoti Manja dhe unë kemi edhe dy çështje për gerat “e” dhe “ë”.

Ne kemi kaluar një ligj “Për integritetin e figurave...” dhe kushti që është vënë këtu: “Të jesh drejtor i Byrosë Kombëtare të Hetimit...”, por “të mos kesh qenë i dënuar për kryerjen e një vepre penale në Shqipëri ose në vende të tjera” bie ndesh me ligjin “Për pastërtinë e figurave...”.

Fatmir Xhafaj – Vendoseni thjesht: “të plotësojë kushtet e ligjit “Për ...”, të iks ligji.

Vasilika Hysi – Sepse kjo është shumë më e ngushtë nga... Ne po heqim njerëzit nga administrata vetëm se janë dëbuar ose sepse mund të kenë pasur...!

Fatmir Xhafaj – Mirë, dakord, por ai është edhe i kufizuar ama, sepse ti mund ..., ku e di unë, atje nuk i ka disa vepra penale...

Vasilika Hysi – Ky është më i rëndësishëm.

Fatmir Xhafaj – Tani, edhe të ketë qenë...

Vasilika Hysi – Atëherë, do të themi...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – E pra, të mos ketë qenë kurrë.

Vasilika Hysi – Por kjo është...

Fatmir Xhafaj – T’i jetë nënshtruar...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ulsi Manja – ...konceptin e ligjit.

Vasilika Hysi – Kjo kërkon shumë pak, ndërkohë unë them se duhet të jetë kriter më i fortë, jo thjesht i dënuar.

Fatmir Xhafaj – Në rregull. Tjetër gjë?

Vasilika Hysi – Mund të jetë edhe i dëbuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Çështja e fundit që kam lidhet me testin e poligrafit. E kam bërë si pyetje në diskutimin kur ekspertët paraqitën ligjin. Ne kemi vënë si kriter këtu: “Duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme: “...të kalojë me sukses testin e poligrafit për integritetin dhe motivimin”.

Në fakt, kur unë bëra këtë pyetje zoti Smibert më tha: “Ky nuk është një kusht, por mund të jetë diçka shtesë”. Ndërkohë, duke ia vënë si kusht drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, që të ketë kaluar me sukses testin e poligrafit, kjo mund të na krijojë probleme dhe unë nuk do të doja që ky nen të shkojë në Strasburg.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Praktika e Gjykatës së Strasburgut lidhur me procesin e rregullt ligjor, dyshimin e arsyeshëm, bazuar në prova dhe fakte, të cilat i njeh përvoja dhe praktika europiane, mund të na vërë në vështirësi me këtë lloj parashikimi.

Nuk e di nëse e kam kuptuar siç duhet zotin Smibert kur më dha përgjigjen: “Jo, nuk është kusht, por thjesht e ka kërkuar policia dhe mund ta përdorim”, sepse, po e renditëm si një kusht, personi mund të thotë: “Unë i plotësoj të gjitha kriteret. Në qoftë se unë jam tip emocional, shoh një pajisje që nuk është përdorur më parë e të tjerë...”, nuk e di, kam frikë në lidhje me praktikën e Gjykatës së Strasburgut për provat dhe krijimin e bindjes nëse një person me të vërtetë gënjen, mashtron, nuk është i sinqertë apo këto lidhen me emocionet që mund të ketë një person në atë moment.

Për këtë do të kërkoja edhe ndihmën e ekspertëve të EURALIUS-it, pasi ata e njohin më mirë përvojën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut lidhur me nenet 5 dhe 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Smibert.

Jon Smibert – *(përkthen përkthyesja)* Së pari, edhe unë kam një diplomë në të drejtën europiane dhe përdorimi i testit të poligrafit, si një provë, mund të nxjerrë probleme në Gjykatën e Strasburgut, por kontrolli i një poligrafi (mënyra sesi) dhe unë e kuptoj, është përdorur në Poloni, në Rumani, është përdorur me ndihmën e Amerikës edhe në Kroaci, madje ky *screening* është përdorur edhe në Belgjikë. Kështu që, si një mjet kontrolli apo mjet ekzaminimi, është një mjet i cili nuk vjen në kundërshtim me të drejtat e njeriut, me të drejtën europiane, sepse është përdorur edhe në vende të tjera të Europës.

Edhe ne në Amerikë nuk e përdorim këtë si provë, madje mendoj se kjo nuk përdoret si provë askund, por thjesht si një mjet kontrolli apo mjet ekzaminimi. Prandaj testi i poligrafit nuk përdoret për të thënë nëse ti kalon apo ti dështon. Testi është thjesht një mjet marrjeje në pyetje. Kur unë të bëj një pyetje, shpesh mund të them: “Jo vetëm që ti e the këtë gjë, por ka edhe një problem”. Pastaj, nëse ti fillon të shpjegosh edhe më shumë përgjigjen, atëherë ti mund të marrësh edhe më shumë të dhëna për këtë person. Kjo është arsyeja pse FBI-ja e përdor. Kjo është hartuar pikërisht në bazat e arsyeve pse përdoret nga FBI-ja.

Nëse ju zgjidhni të mos e përdorni këtë, sigurisht është diçka që duhet ta diskutoni vetë.

(Kryetari i komisionit flet pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – ...zonjën Hysi, me këtë fjalën “me sukses”?

Po ta hiqni..., domethënë “të ketë kryer testin e poligrafit për integritetin dhe motivimin dhe atë me sukses”, se ju thatë që nuk është kusht, okej, apo jo?

Jon Smibert – *(përkthen përkthyesja)* Mendoj që mënyra sesi është shprehur është marrë kryesisht nga rregullorja e FBI-së.

Fatmir Xhafaj – ...kjo dhe jemi okej.

Derisa kroatët e kanë kaluar me sukses, ne nuk kemi pse të mos e kalojmë me sukses!

Koraljka Bumči –*(përkthen përkthyesja)* Ne e kemi këtë kusht, gjithashtu, për punonjësit e USKOK-ve dhe PNUSKOK -ve, ku ne duhet të japim pëlqimin tonë me shkrim para se ta bëjmë këtë test. Nuk është diçka që bëhet automatikisht, pra ne duhet të japim, së pari, pëlqimin me shkrim për ta bërë ose jo këtë test dhe nuk mund ta përdorim si provë në gjykatë.

Fatmir Xhafaj – Nuk është për provë. Kjo është thjesht për të...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Si?

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, kjo nuk është provë, sepse ne jemi te neni ku flitet nëse një person mund të merret ose jo drejtor.

Në rast se personi A do të kandidojë për drejtor të Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe nuk firmos, siç thotë zonja *Bumči*, deklaratën që të kalojë testin e poligrafit...

Më falni, të bëj një pyetje.

Fatmir Xhafaj – Pse çfarë të keqeje ka ta bëjë?

Vasilika Hysi – Për mua le të jetë, nuk ka problem personalisht.

Fatmir Xhafaj – Po, por...

Vasilika Hysi – Po flas për ata që do të konkurrojnë.

Fatmir Xhafaj – ...hallin e kujt ke pastaj?

Vasilika Hysi – Kam hallin të mos na shkojë në Strasburg.

Po e them hapur edhe një herë...

Fatmir Xhafaj – Pse do të shkojë në Strasburg?

Vasilika Hysi – Sepse zonja *Bumči* tha: “Te ne nuk i nënshtrohen...”

Fatmir Xhafaj – Po, shumë mirë!

Vasilika Hysi – ...testit të poligrafit”.

Fatmir Xhafaj – Po ata të Strasburgut me çfarë do të merren në qoftë se nuk merren me këtë?

Vasilika Hysi – Më falni!

Zonja *Bumči* tha: “Ai duhet të firmosë që është dakord ta kalojë këtë test”, apo jo?

Fatmir Xhafaj – Le të shkojë njëri dhe...

Vasilika Hysi – E zëmë se nuk firmosi. Atëherë, po t’i referohemi formulimit të pikës 4 në variantin shqip, ne themi që drejtori nuk mund të emërohet në Byronë Kombëtare të Hetimit nëse nuk e kalon testin, madje edhe me sukses.

Fatmir Xhafaj – Dakord, por...

Vasilika Hysi – E dyta, në Kroaci, nëse e kalon testin, nuk pranon të firmosë, pra nuk përmbushet një kusht, nuk bëhet drejtor.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Koraljka Bumči –*(përkthen përkthyesja)* Jo, ne nuk kemi BKH, ne kemi PNUSKOK-un, që është pjesë e Policisë së Shtetit, por është komplet e veçantë dhe e atashuar ndaj USKOK-ut. Ky nuk përdoret si një kusht paraprak, përdoret nëse është e nevojshme, nëse ka ndonjë pasiguri dhe atëherë kandidatit mund t’i kërkohet të kalojë edhe testin poligrafik. Pra, nuk është një kusht, por është opsionale e thënë ndryshe, që mund të përdoret për gjyqtarët dhe për prokurorët, të cilët punojnë atje.

Fatmir Xhafaj – Domethënë, kushtet bazë dhe kushtet që avantazhojnë, si me thënë, në kriteret shtesë...

(Deputetja Hysi flet pa mikrofon.)

Dakord, riformuloheni dhe po të ketë nevojë...

Biem dakord me riformulimin?

Në rregull.

Neni 36 “Lirimi/shkarkimi nga detyra e drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit”.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, në këtë nen nuk flitet vetëm për lirimin dhe shkarkimin, por edhe për pezullimin. Ne kemi bërë një sugjerim për të shtuar fjalën “pezullimi” në titull pas fjalëve “lirimi, shkarkimi”, pra “Lirimi, shkarkimi dhe pezullimi...”. Kemi bërë një riformulim me gjuhën e ndryshimeve kushtetuese të pikës së parë.

Gjithashtu, kam një pyetje për ekspertët lidhur me germën “ç”. Një nga kushtet pse personi mund të lirohet nga detyra është kur aftësia për të ushtruar detyrën i është kufizuar shumë me vendim gjyqësor të formës së prerë. Por cilat janë rastet kur gjykata mund të kufizojë, pra të shprehet për aftësinë?

Këtu flitet për aftësinë, për problemet e shëndetit mendor, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Edhe për aftësitë fizike? Është gjykata, e cila shprehet që personi po vuan shumë, ka raporte mjekësore afatgjata e të tjera? Pra, do të doja më shumë informacion lidhur me germën “ç”, qoftë edhe për të pasur rekorde të regjistruara, se cili është kuptimi i këtij formulimi.

Gjithashtu, kam një pyetje lidhur me paragrafin e tretë për pezullimin. Thuhet: “Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit pezullohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë bazuar në rekomandimet e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme nëse drejtori bëhet subjekt i një hetimi penal”. Këtu, zoti Rakipi, ju jeni më specialist se unë (jam më shumë më poshtë se ju), por do të thosha...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Bëhet subjekt i hetimit penal, ka filluar ndjekjen penale, ka filluar procedimi penal, ka dyshime të arsyeshme që personi mund të bëhet subjekt... Pra, duhet të verifikojmë se çfarë do të thotë subjekt i një hetimi penal.

Arben Rakipi – Çështja e ndjekjes penale u përmend gjatë këtu dhe ndoshta duhet ta sqarojmë.

Ndjekja penale në Kodin e Procedurës Penale nuk rregullohet dhe çështja se kur fillon ndjekja penale është thjesht e teorisë dhe e referimit në kode të ngjashme.

Është pranuar që ndjekja penale lidhet me çastin kur personit i komunikohet akuza, pra kur merret i pandehur, që do të thotë se ndërkohë ka filluar një hetim i cili mund të zgjasë edhe vite të tëra. Kjo kohë quhet thjesht hetim paraprak.

Tani, në rastin konkret pezullimi nuk mund të lidhet me ndjekjen penale, sepse duke kaluar një kohë kaq e gjatë dhe personi nën hetim është në detyrë, presupozohet që dëmi që mund t'i shkaktohet hetimit të jetë i madh. Prandaj është lënë në këtë term, në mënyrë që të bëhet e mundur kur dyshimet janë të plota, të arsyeshme. Mendohet që drejtori duhet të lëvizë për arsye që të mos dëmtojë hetimin, të kërkohet në prokurori, në këshill, te drejtuesi për ta pezulluar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Mirë pra, por duhet ta riformuloni këtë pikë me këtë koncept që tha.

Logjika është që nuk mund të rrijë drejtuesi i Byrosë Kombëtare të Hetimit. E kuptojmë ndërkohë që sa ka filluar një çështje penale për të, se është njësoj tani sikur, ku e di unë, nejtë...

(Zoti Rakipi ndërhyt pa mikrofon.)

Po.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord, u kuptuam.

Vasilika Hysi – Lidhur me germën “ç”...

Fatmir Xhafaj – E thamë, pra!

Vasilika Hysi – Jo, jo, germa “ç” është tjetër gjë: “...kur aftësia për të ushtruar detyrën është kufizuar shumë me vendim gjyqësor të formës së prerë”.

Në Kushtetutë ne kemi një tjetër riformulim terminologjik, që është pamundësia për të ushtruar...

Ma jep pak Kushtetutën, të lutem!

Kemi bërë një riformulim tjetër kur mund të mbarojë mandati. Thuhet: “Kur vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën” në disa raste, si: “gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, gjyqtari i Gjykatës së Lartë”, te këta.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pra, vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën dhe me vendim gjyqësor të formës së prerë.

A mundet që një gjykatë të vendosë, meqenëse personi shtrohet shpesh në spital, për shembull, me kriza veshkash ose me probleme të diabetit, pra nëse ai është në pamundësi për të vazhduar detyrën dhe duhet të mbarojë ndërkohë mandatin? Më duket se nuk është kompetencë e gjykatës, pasi ajo vendos për probleme të shëndetit mendor, gjithmonë nëse e kam kuptuar saktë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Në rregull?

Jon Smibert –(përkthen përkthyesja) Ka pasur edhe një çështje që u ngrit nga Ministria e Drejtësisë, e cila nuk pranonte kur ne flisnim për kapacitetin mendor dhe nëse ai është i kufizuar. Ne nuk mendonim se do të ishte e nevojshme për t’u shtuar këtu, në fakt mund të jetë edhe e dëmshme, sepse mund të jetë një vendim arbitrar pastaj. Por nëse ai e ka kapacitetin për të ushtruar detyrën dhe i është kufizuar shumë me vendim gjyqësor të formës së prerë, mendoj se ky formulim ishte ofruar edhe nga Ministria e Brendshme, si një mënyrë për t’u përpjekur që të thotë: nëse ka ndonjë vendim gjyqësor, që shpreh se ai nuk është i aftë për të ushtruar detyrën e

tij si drejtor, në një mënyrë abstrakte, pra që ne të mos e harrojmë këtë fakt, atëherë kjo do të ishte një arsye për të që të pezullohej.

Kjo mund të riformulohet dhe nuk ka të bëjë fare me sëmundjet mendore apo fizike, kjo është thjesht për aftësinë e tij ligjore për të kryer detyrën e tij. Pra, lidhet vetëm me këtë fakt.

(Deputetja Hysi ndërhyr pa mikrofon.)

Vasilika Hysi – Atëherë, po vazhdoj unë, zoti kryetar?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pra, ju mendoni që germa “ç” të riformulohet, për të kuptuar se për çfarë lloj aftësie bëhet fjalë? Ju thoni: “Aftësi ligjore”. Me fjalë të tjera, unë prapë nuk jam e qartë, nëse është i paaftë apo...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Rakipi – Praktikisht mund të ketë situata, kur një drejtues apo një nëpunës mund të bëhet i paaftë për të kryer detyrën. Në këtë pikëpamje nuk ka asgjë për t’u çuditur dhe kjo shkon me standardin që kemi vendosur tjetërkund, që personi që është i paaftë për të kryer detyrën, duhet të largohet. Dakord?

Pyetja që shtrohet është: Për çfarë paaftësie bëhet fjalë dhe se cili është roli i gjykatës?

Deri sot që flasim, ne gjithmonë kemi parashikuar paaftësinë mendore në standardet që kemi vendosur. Unë, personalisht, mendoj që krahas paaftësisë mendore, kemi edhe paaftësi të tjera të karakterit fizik, të cilat ndikojnë në aftësinë mendore për të ushtruar në mënyrë të drejtë, të paanshme detyrën e caktuar.

Të më falni për shembullin, por duhet marrë tani. Një person në detyrë, i cili vuan nga kanceri, do të ishte mirë që të mos ta ushtronte më këtë detyrë, për shkak të ndikimit shumë të thellë që kjo sëmundje ka (edhe shkencërisht), në aftësinë e tij për të ushtruar detyrën. Sigurisht, unë nuk jam për të diskriminuar persona të tillë, por mendoj që në një moment të caktuar, duhet mbrojtur puna publike dhe vetë personi konkret duhet mbrojtur në mënyrë indirekte, sepse garancia që ai jep për të ushtruar profesionin larg emocioneve që mund t’i shkaktojë sëmundja, është e ulët. Për këtë arsye, dispozita mund të përmbledhë edhe këtë rast.

E dyta, që është pak me pikëpyetje është: Cili është roli i gjykatës në këtë çështje? A kemi ne procedurë që këtë rast që u mor, ta çojmë para gjykatës për ta vërtetuar, ose jo? Në pikëpamjen e dytë, unë mendoj se e komplikojmë shumë situatën, sepse nëse do të pranojmë një eventualitet të tillë, do të duhet të parashikojmë edhe procedurën se kush e bën kërkesën, cilat

janë provat që duhen paraqitur para gjykatës, kundërshtueshmëria me të sëmurin, e cila na vë në një pikëpyetje të madhe, nëse duhet të sillemi, apo jo në një mënyrë të tillë me nëpunësin tonë. Kjo procedurë është pak e komplikuar, por për të qenë brenda edhe brenda shqetësimeve që ka pasur dhe rekomandimeve që jep Ministria e Drejtësisë, unë do të përkrahja idenë që të përdornim standardin që përdoret në Kushtetutë: kur është i paaftë për të kryer detyrën, që nënkupton paaftësinë e karakterit mendor dhe ta lëmë pastaj këtë

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si e përdorim në Kushtetutë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Në pamundësi për të ushtruar detyrat e tij, por nuk flitet në rastin që ai është i pamundur, sepse...

Këtu nuk flitet për shkarkim, por flitet për lirim. Ai nuk ka bërë ndonjë gabim apo ndonjë faj, si shkelja e ligjit apo e Kushtetutës. Flas për germën “ç“, kur personi lirohet nga detyra. Unë pajtohem plotësisht me argumentet që ju thatë. A kemi ne në përvojën tonë që gjykata të mund të shprehet për një person që është i sëmurë? Cilat janë palët? Kush do ta bëjë kërkesën? Gjykata thotë vetëm për problemin e shëndetit mendor.

Arben Rakipi - Gjykata mund të shprehet dhe ka një procedurë si shprehet për problemin e shëndetit mendor. Në këtë rast para se të shkojmë te përmbajtja, në pikëpamjen etike, nuk e shoh të pranueshëm faktin që prokurori antikorrupsion, të dalë para drejtorit të BKH-së dhe të luftojë me të për një çështje të tillë. Në pikëpamjen etike, kjo më duket e papranueshme. Larg qoftë, në eventualitetin që kjo situatë do të jetë prezente, kjo çështje zgjidhet me bisedime.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prandaj bie dakord me variantin që për të përmbushur shqetësimin e Ministrisë së Drejtësisë, ne mund të përdorim një term të përgjithshëm kushtetues dhe ta mbyllim këtë çështje.

Vasilika Hysi – Zoti Rakipi, kështu siç thuhet: “me vendim gjyqësor të formës së prerë”, është shumë subjektive. Kjo e ka kufizuar shumë aftësinë, nuk shkon. Kush do të thotë që është kufizuar shumë, apo pak? Gjyqtarët nuk janë mjekë. Ata do të marrin ekspertë, do të ketë raporte. Prandaj nëse ne do të vendosim formulimin që përdor Kushtetuta, a na kënaq për të thënë që një person që është në pamundësi qoftë fizike apo mendore dhe s’duhet ta ushtrojë më detyrën?

Vasilika Hysi – Zonja Bumçi,

Ky term është përdorur në disa nene, si për shembull neni 127, që flet për gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese. Në pikën “dh” thuhet që mandati i tij mbaron, nuk shkarkohet. Në rastin konkret drejtori i BKH-së lirohet, kur vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.

Edhe në rastin e nenit që flet për anëtarin e Gjykatës së Lartë ose te mandati i anëtarit të KLGJ-së, neni 147, pika “dh”, thuhet: “Mandati i anëtarit të KLD-së mbaron, kur vërtetohet rasti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.” Ai është i paralizuar tashmë në krevat, nuk ka mundësi dhe nuk ke pse të shkosh deri në gjykatë.

Edhe në rastin e anëtarit të Gjykatës së Lartë, po e njëjta gjë. Nuk do të doja ta vinim gjykatën në pozitat e shkeljes së etikës.

Arben Rakipi – Jam dakord me këtë variant, por në eventualitetin që asnjë nga pikat “a”, “b”, dhe “c”, nuk janë prezente, si do ta zgjidhim këtë situatë? Ai nuk paraqet dorëheqjen, nuk largohet nga detyra.

Vasilika Hysi – Zoti Rakipi, unë them që duhet të ketë një rregullim, por mënyra se si është thënë, na krijon probleme me etikën dhe do të na krijojë edhe një problem (mos ndodhtë gjë në praktikë), por nëse ndodh diçka, mund të vihet gjykata në konflikt. A mund ta shihni edhe një herë, ta gjykoni dhe të na jepni ju vetë një riformulim që të jemi të saktë?

Koraljka Bumçi –(përkthen përkthyesja) Siç thuhet edhe në Kushtetutë, a është e kuptueshme me mënyrën siç është aty? A është i kënaqshëm për ju ky variant? Ne thjesht po ju pyesim. Nëse është mjaftueshëm e qartë sipas variantit të Kushtetutës, atëherë ne jemi dakord. A jeni dakord ju me variantin e Kushtetutës, sepse për mua është paksa e gjerë, neni 27, pika “b” dhe te paragrafi i parë, shkronja “d”.

A keni një ligj që i përcakton këto kushte? Në Kroaci ne e bëjmë këtë gjë me anë të procedurës civile. Ndoshta, Shqipëria ndjek të njëjtën procedurë. Nëse është e kuptueshme në Kushtetutë, është Ok. Ky formulim nuk përfshin rastin që përmendi zoti Rakipi, se mbetet pak e gjerë. Zoti Arben po thotë që mund të ruajmë formulimin e Kushtetutës. Atëherë, le të mbetemi me formulimin e Kushtetutës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kora sapo tha që formulimi i Kushtetutës nuk e përfshin rastin e sëmundjes me kancer, që u përmend pak më parë.

Pyetja e dytë, është se kush do ta përcaktojë këtë papërshtatshmëri. Kora po thotë që pjesa e Kushtetutës është disi e gjerë.

Vasilika Hysi – Në fakt, zonja Bumçi, ne po flasim për germën “dh” dhe jo për germën “d”. Germa “d” në shqip, siç e lexoj unë Kushtetutën, në disa nene dhe më konkretisht, morëm rastin e nenit 127, flitet për kushtet e papajtueshmërisë, si konflikti i interesit etj., ndërsa për germën “dh”, është e gjerë, jam dakord me ju që ajo është e gjerë. Vërtetohet rasti i pamundësisë. Ne e kemi me Kodin e Procedurës Civile. Ose mund të jetë pamundësi fizike, ose mund të jetë pamundësi mendore.

Në rastin e pamundësisë mendore, është rasti i ligjit “Për shëndetin mendor”, që përcakton procedurën etj, ndërsa pamundësia civile është përcaktuar me Kodin e Procedurës Civile, është rasti i kufizuar për të vepruar.

Fatmir Xhafaj – Dakord me nenin 36, siç u propozua me ndryshimet e propozuara.

Kalojmë te neni 37.

Për çështjen e pezullimit të neni 36, e sqaruam, zoti Rakipi, që do të bëni ju një formulim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord. Kalojmë te neni 37, “Zëvendës drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit”.

Vasilika Hysi – Këtu kemi bërë thjesht riformulime të teknikës legislative, duke filluar që nga paragrafi i parë deri te paragrafi i tretë.

Ndërkohë, gjërat e tjera janë të qarta.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit shumë që i qartësuat!

Kalojmë te neni 38, “Hetuesi i Byrosë Kombëtare të Hetimit”.

Vasilika Hysi – Këtu, te neni 38, kemi bërë riformulim të nenit.

Fatmir Xhafaj – Ok. Dakord. Faleminderit!

Kalojmë te neni 39, “Kriteret për emërimin dhe për largimin e hetuesit të Byrosë Kombëtare të Hetimit”.

Vasilika Hysi – Këtu, përveç riformulimit, të cilin s’po e përmend, sepse e keni në tabelë, unë kam një pyetje për germën “c”: Ne themi që kandidati për hetues në Byrosë Kombëtare të Hetimit, duhet të plotësojë edhe një nga këto kushte: duhet të ketë më shumë se një

vit dhe kur thuhet: “më shumë se një vit”, nënkuptohet që një vit duhet patjetër në agjencitë e zbatimit të ligjit. Unë mendoj se përfshihet edhe policia tek agjencitë e zbatimit të ligjit.

Ju lutem, sa të bëj pyetjen! A hyn policia te institucionet e zbatimit të ligjit? Ajo është e para, sipas mendimit dhe formimit tim. Pse kemi thënë: “Policinë, institucionet e zbatimit të ligjit”?

Unë them t’i përcaktojmë se cilat janë institucionet e zbatimit të ligjit që të mos kemi më pas probleme e të vijë dikush e të thotë: Pse të mos emërohem unë si hetues në Byronë Kombëtare të Hetimit, se unë vij nga Shërbimet e Inteligjencës.

Arben Rakipi - Ai është termi i përgjithshëm.

Vasilika Hysi – Ai është termi i përgjithshëm.

Arben Rakipi – Jam dakord të ndërrohen vendet: “Institucionet, në polici, etj...”

Fatmir Xhafaj – Dakord. Ai mund të jetë te policia hetimore në dogana. Tani nuk do të përmenden të gjitha. Policia është pak specifike, sepse preferenca do të jetë prej atyre.

Vasilika Hysi – Atëherë, në qoftë se Policia e Shtetit është një nga agjencitë e zbatimit të ligjit...

Fatmir Xhafaj – Po mos pyet për këtë gjë, se edhe ti e di që nuk mund t’i përmendësh të gjitha.

Vasilika Hysi – Atëherë, mund të thuash edhe policinë nga institucionet e tjera të zbatimit të ligjit.

Fatmir Xhafaj – Po ke gjysmë ore që i bie vërdallë. Mund ta thoshe vetë dhe të na e lehtësoje edhe neve, se ne do ta pranohim menjëherë. Po ta thuash kështu, ne e pranojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si nuk i kupton ti institucionet e zbatimit të ligjit?

Miratohet neni 39 me riformulimet që janë bërë në tekst dhe me sqarimin që bëri vetë zonja Hysi, me forcat tona.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Te neni 40?

Vasilika Hysi – Jo, kam një sqarim te neni 39 për zotin Smajbert.

A është menduar që personat që do të punojnë në Byronë Kombëtare të Hetimit do të kenë një distinktiv? Pra, pasi të ketë mbaruar, të ketë marrë trajnimin e certifikuar, kandidatit do t’i jepet distinktivi, si në FBI të SHBA-së dhe më pas do të konsiderohet hetues? Meqë ju do t’i

jepni një distinktiv, mos duhet rregulluar në ligj se kush e nxjerr, kush e miraton, se tani po hyjmë te simbolet, ashtu siç i ka ligji “Për Policinë e Shtetit”. Unë nuk po gjej rregullim të ky ligj për simbolet, stemat, uniformat nëse do të kenë dhe shumë gjëra të tjera, që ligji “Për Policinë e Shtetit” i ka për pjesën e vet.

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jon Smibert – *(përkthen përkthyesja)* Unë mendoj se nuk është e nevojshme të kenë patjetër një distinktiv. Kjo është e ndryshme në vende të ndryshme. Kjo bëhet thjesht për të identifikuar punonjësit e FBI-së dhe kjo është specifike për ata. Autoriteti mbetet. Për të qenë ose jo, nuk ka ndonjë problem.

Vasilika Hysi – Unë mendoj se nëse do ta lëmë që të kenë distinktiv, duhet lënë një dispozitë që të thotë se me akt nënligjor të përcaktohet simboli, formati, lloji. Mendoj se kjo është e detyrueshme dhe këtu e kemi vënë si kusht që nuk konsiderohesh hetues, pa marrë këtë distinktiv. Këtë duhet ta mbajmë shënim dhe ta saktësojmë mirë që në dispozitat kalimtare kë do të ngarkojmë për të nxjerrë formën, kriteret, ngjyrën madhësinë dhe gjithçka tjetër, që lidhet me simbolet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jon Smibert – *(përkthen përkthyesja)* Thjesht mund të thuhet që me të mbaruar studimet dhe trajnimin e tij, ai mund të konsiderohet hetues.

Fatmir Xhafaj – Mund të bëhet një riformulim këtu dhe në fund të fundit, le ta ketë distinktivin. S’ka asnjë gjë të keqe. Distinktivi mund të mbahet në xhep apo këtu dhe nuk ka asnjë gjë të keqe. Nuk e di, por ka shumë mënyra. Le të ketë një shenjë dalluese.

Urdhëroni!

Vasilika Hysi – Përderisa ne kemi një problem që e kemi diskutuar gjatë shqyrtimit të projektligjit, që mund të ketë moskuptim mes Policisë së Shtetit dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe të mos dallohet, ndoshta mund të ketë një distinktiv apo një shenjë dalluese, që të mos shkojë pjesa tjetër në atë hetim, ku kanë hyrë këta, ashtu siç i kemi parë në filmat me FBI-në dhe me Policinë.

Në dispozitat kalimtare duhet vënë një dispozitë që përcakton nxjerrjen e një akti nënligjor.

E dyta, për ta mbyllur diskutimin e këtij neni, përsëri te kushtet, që të jesh punonjës i Byrosë Kombëtare të Hetimit, kemi thënë të ketë si kusht detyrues të kalojë me sukses provën e poligrafit.

Fatmir Xhafaj – E thamë që do të bëhet i njëjti riformulim.

Vasilika Hysi — Do të bëhet i njëjti riformulim edhe këtu?

Fatmir Xhafaj – E thamë që do të bëhet riformulimi të të gjitha pikat.

Miratohet neni 39 me riformulimet.

Neni 40, “Shërbimet e Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit”.

Vasilika Hysi – Neni 40, ka thjesht riformulime, rregullime të teknikës legjislative dhe gjuhësore, sidomos paragrafi i tretë dhe paragrafi i katërt, që është disi i gjatë.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Miratohet neni 40 me reflektimet e bëra. I bashkëngjiten tekstit që kemi në shqyrtim. Miratohet. Neni 41, “Statusi i Policisë Gjyqësore”.

Vasilika Hysi – Këtu kam vetëm një pyetje për paragrafin e tretë, të nenit 41, për referimin të ligjet e tjera të zbatueshme. Thuhet që punonjësi i Byrosë Kombëtare të Hetimit ruan sekretin e hetimeve penale në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe ligjet e tjera të zbatueshme. Cili është kuptimi e shprehjes: “dhe ligjet e tjera të zbatueshme”? E keni fjalën ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, apo për mbrojtjen e sekretit?

Arben Rakipi – Kam diçka: te ligji “Për prokurorinë” dje apo pardje, është thënë diçka për sekretin, kështu që ai mund të jetë një ligj tjetër i zbatueshëm,

Fatmir Xhafaj – Edhe te paragrafi i parë më duket e tepërt shprehja: janë oficerë të Policisë Gjyqësore, por nuk janë nën kontrollin e kësaj apo asaj. Nuk ka nevojë të thuhet që drejtori, zëvendësdrejtori, hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe drejtuesit e Policisë Gjyqësore janë oficerë të Policisë Gjyqësore dhe janë nën kontrollin e prokurorëve të posaçëm. Të hiqen fjalët: “nuk janë” këtu. Pse nuk e shënoni që nuk janë nën kontrollin e kryetarit të Komisionit të Ligjeve?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jua thashë unë që nga meraku, kur digjeni nga qulli i fryni kosit.

Miratohet neni 41 me ndryshimet. Paragrafi i tretë të vijë në një formulim siç e kemi bërë te ligji “Për prokurorinë”.

Faleminderit!

Miratohet me ndryshimet.

Neni 42, “Largimi i punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit”.

Vasilika Hysi – Këtu nuk kemi probleme me përmbajtjen e nenit, por vetëm fjala “anëtari i Byrosë Kombëtare të Hetimit”, do të zëvendësohet me: “punonjësi i Byrosë Kombëtare të Hetimit”.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Miratohet neni 42 me rregullimet e bëra, të cilat janë paraqitur në tekst.

Neni 43, “Oficeri përgjegjës për mbikëqyrjen”.

Vasilika Hysi – Këtu ka thjesht riformulime fjalësh. Paragrafët 4 dhe 5 janë riformuluar.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Personalisht, e kam të qartë. Nuk e di nëse edhe kolegu Manja e ka të qartë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Dakord, por desha të di se kush e cakton këtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jon Smibert – *(përkthen përkthyesja)* Mendoj se në paragrafin e dytë thuhet që ata zgjidhen me short dhe se drejtori organizon shortin, me pëlqimin e kryeprokurorit të prokurorisë së posaçme të hetimit. Pra, kjo do të monitorohet nga dy persona, kemi dy subjekte të cilat monitorohen dhe gjithashtu, roli i tyre është si vëzhgues atje.

Fatmir Xhafaj – Ky rast është si puna e skuadrave të përgjimit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk është SHKB.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një minutë, do të ishte SHKB, nëse do të ishte vetëm për të vetët, ndërsa ky është edhe për gjyqtarët. Më vjen keq!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kam një merak: duke qenë vetëm një individ, a është rregulluar sa...

Dakord, kur raporton shkeljet e etikës, por ky ka në dorë të gjithë komunikimin e tyre. Duke qenë një njeri i vetëm, pa qenë nën kujdesin e prokurorit hap pas hapi, sa larg mundësisë abuzive mund të jetë ky?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, por kush e kontrollon rojën? Thjesht hidhet shorti një herë në dy vjet dhe ky ka pavarësi të plotë gjatë kësaj periudhe. Kjo nuk është shumë e qartë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jon Smibert – *(përkthen përkthyesja)* Ky është shqetësimi, i cili na ka dalë gjatë gjithë procesit: kush i kontrollon këta kontrollues? Pra, deri në një farë pike, duhet të ndalojë diku. Procesi i përdorur në Kroaci është pjesë e shërbimeve sekrete dhe nuk besoj se duam të besojmë të njëjtin proces edhe këtu. Edhe në Rumani kanë të njëjtin gjë dhe kanë një strukturë, e cila ka pasur këto probleme, gjithashtu. Kjo ishte një masë. BKH-ja ka një person, i cili do të ketë një mandat 2-vjeçar dhe arsyeja që zgjodhëm këtë mandat 2-vjeçar, është se nuk duam dikë, që do ta kryejë këtë funksion përgjithmonë. Mandati mund të jetë 6-mujor dhe kjo do ta bënte edhe më mirë. Arsyeja që e lamë kështu, është që ketë një njeri atje. Mbase një mandat 6-mujor, do të kishte edhe më shumë kuptim.

Fatmir Xhafaj – Unë nuk jam për mandat 6-mujor, sepse atë mandat do ta marrin njerëzit më të aftë, më të sigurt dhe më të zotë brenda strukturës, sepse jo të gjithë ata kanë të njëjtat cilësi. Problemi është që ky njeri minimalisht në fund të çdo jave apo të çdo muaji është mirë të bëjë një raport që të dokumentojë punën që ka bërë që nëse ka shtuar diçka, ka lënë gjurmë në proces. Të ketë organizim të brendshëm, një raportim të periodik dhe jo ta bëjë vetëm kur e çmon ai, por të jetë i detyruar. Kur ka një rast që përbën shkak, mund ta raportojë në çdo moment. Ai ka detyrimin ta bëjë në çdo moment, por ama në fund të çdo jave apo në fund të çdo muaji, apo të çdo 15-ditëshi ky njeri të bëjë një raport, për ato që ka parë apo që ka arshivuar, në mënyrë që t'i dokumentojë të gjitha veprimet e tij. Në fund të thotë: mbyllet fletët e përgjimit apo tabulatet me kaq faqe, që ato të depozitohen, që të mos ketë mundësi abuzimi dhe ndërkohë mbi të ketë një kontroll të herëpashershëm, këto t'i raportojë te një njeri pra të ketë një raportim periodik edhe për gjëra të zakonshme që mund t'i mbyllë në kurriz të cilësisë apo të dëmtimit të punës, për shembull një çështje, sepse personi që hetohet, mund të jetë kolegu, miku apo shoku i tij.

Nga ana tjetër, të mos ketë mundësi të abuzojë në ato që do të bëjë. Për shembull, zëvendës drejtori i byrosë mund ta ketë detyrë të tij funksionale për ta mbikëqyrur këtë gjë. Të ketë diçka të tillë. Është shumë e rëndësishme, që ky të jetë një njeri i mbikëqyrur.

Vasilika Hysi – Ky është më i rëndësishmi.

Fatmir Xhafaj – Është më i rëndësishmi, aq sa ç'janë këta të SHKB-së më të rëndësishmit.

Vasilika Hysi – A mund të bëj një pyetje?

Fatmir Xhafaj – Zgjidhja që të mos ta kenë shërbimet sekrete, siç e thatë ju që e ka Kroacia. Më duket një zgjidhje e mirë që të jetë një gjë brendapërbrenda, por duhet të jetë nën kontroll.

Vasilika Hysi – Kush e kontrollon këtë?

Fatmir Xhafaj – Kam gjysmë ore që po e them.

Vasilika Hysi – Unë kam një pyetje, lidhur me shkatërrimin e ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

Fatmir Xhafaj – A keni një ide si mund të realizohet, apo do ta mendoni dhe më pas do ta reflektoni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jon Smibert – *(përthën përthyesja)* Në fakt, unë po mendoja për një pyetje tjetër, që më erdhi në këtë moment. Shqetësimi tjetër që ne do të kishim dhe kjo ishte diçka të cilën nuk e kemi shkruar pa u menduar gjatë dhe thellë, sepse pyetja që del: Cili do të jetë procesi dhe ai punonjës përgjegjës, i cili do t'i raportojë dikujt në zyrën e prokurorisë së posaçme, por kujt do t'i raportojë? Ju i jepni atij detyrimin që ai të raportojë te dikush, nëse mund të dalë diçka.

Pyetja tjetër që doli gjatë diskutimit është që ti mund të krijosh një raportim javor apo mujor dhe ajo mund të jetë si një provë apo si dokument që dikush mund të përpiqet të kontrollojë të tjerët. Kjo na çon në aq fusha të ndryshme shqetësuese, sepse sapo ti del me diçka, mund të ketë një lloj arsyetimi apo një arsye. Ju mund të keni një raportim periodik, le të themi ndaj zëvendës drejtorit të BKH-së, por duke prezumuar që vetë zëvendës drejtori është i përfshirë në diçka, ai vetë po monitorohet dhe ti vete dhe raporton tek ai, kjo na çon në përfundimin se vetë zëvendës drejtori, i cili do të marrë këtë raport, do të bëhet edhe më i fuqishëm, sepse ai do të ketë edhe më shumë informacion për çfarë janë duke bërë të tjerët. Kjo gjeneron edhe më shumë dinamikë brenda strukturës dhe unë mendoj që nëse ju do të bëni diçka, gjëja më e mirë që do të bëni, është ta reduktoni mandatin e tij. Pra, një personi të vetëm të mos t'i jepet një mandat 2-vjeçar dhe ai të mos jetë aq i fuqishëm për këtë 2 vjet.

Çështja tjetër, të cilën ne e patëm atje dhe ishte gjithashtu një shqetësim, ishte për mbajtjen e dokumentacionit. Ti shpesh duhet t'i shkatërrosh ato. Ti mund të shkosh te prokurori dhe ai mund të thotë që duhet t'i mbash këto të dhëna, sepse ka diçka aty, por kjo në fakt do të ishte mjaft tunduese për t'i mbajtur të gjitha këto regjistrime (le të themi, të zotit Rakipi). Për shembull, mund të themi që zoti Rakipi ka folur me zonjën Bumçi dhe munddo ta përdorim këtë përsëri kundër tij.

Këto ishin shqetësimet e mija dhe kjo i jep një fuqi të jashtëzakonshme këtij personi, por pa krijuar një person tjetër, i cili do të jetë akoma më të fuqishëm se ky, apo nëse ju do të krijoni një strukturë raportimi, së cilës ky person do të duhet t'i raportojë gjatë gjithë kohës, si për shembull zëvendës drejtorit, ai jo vetëm që bëhet më i fuqishëm, por bëhet edhe më imun. Pra, gjithmonë ka diçka të pazakontë, është diçka që ne gjithmonë kemi menduar brenda realitetit shqiptar, sepse kudo shikohet si një institucion i veçantë.

Edhe në Kroaci, thotë zonja Bumçi, është e njëjtë, apo nëse do të fusnim edhe shërbimet e sigurisë, të cilat do të ishin të papërshtatshme këtu.

Unë do të rekomandoja që nëse do të bëjmë një ndryshim, ky ndryshim të jetë thjesht reduktim mandati. Edhe këtu mund të keni një mandat të ri të rinovueshëm, sepse këtu thuhet: i parinovueshëm. Nëse mbas 6 muajsh kemi një person dhe pas 1,5 vjetësh kemi të njëjtin person në këtë mandat, atëherë nuk do të ishte e përshtatshme që të kemi një mandat kaq të gjatë, apo mbase do të ishte e vështirë të zgjidhnim dikë ku ky person do të shkojë dhe do të raportojë. Mbase këtu do të fusim më shumë rregulla dhe detaje, por rregullat mund të jepen nëpërmjet akteve nënligjore, ku mund të përcaktojmë shumë gjëra, sepse sigurisht, shërbimet sekrete funksionojnë në mënyrë komplet të ndryshme dhe ne jemi duke ndërtuar diçka brenda strukturës, që mund të jetë diçka e rrezikshme.

Jam dakord me Xhonin që thotë se ata duhet të ndryshohen brenda 6 muajve, sepse vetëm nëse ti nuk do të ndryshosh brenda 6 muajsh, ti mund të bëhesh shumë i fuqishëm, sepse do të dish gjithçka për këto.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Jam absolutisht dakord me këtë shqetësim, por unë kam një pyetje lidhur me shkatërrimin e regjistrimeve. Në ligj keni bërë një përjashtim që ruajtja e tyre mund të urdhërohet me shkrim nga një prokuror apo nga një gjyqtar. Fjala është për çdo prokuror apo

çdo gjyqtar? Mund të jetë çdo prokuror dhe gjyqtar i gjykatës së posaçme, apo çdo prokuror dhe gjyqtar i gjykatave me juridiksion të përgjithshëm?

Gjithashtu, duke ndarë të njëjtin shqetësim me zotin Xhon, lidhur me fuqinë e këtij personi, nëse reduktohet mandati në 6 muaj dhe rezulton që një prokuror apo një punonjës është duke folur apo duke mbajtur kontakte me botën e krimit apo shet informacione edhe mbi 6 muaj, për shembull, 8 muaj. Atëherë, i bie që 6 muaj i mban iks person i ngarkuar dhe mbas 6 muajve, do të hyjë një person tjetër. Si do të rregullohet ky kalim apo rotacion, nëse do ta kemi brenda kësaj periudhe 6 mujore? Zakonisht, të paktën nga përvoja e Gjykatës së Krimeve të Rënda dhe me ç'dëgjojmë nga mediet, ata e përgjojnë për gati një vit një person apo aktivitetin e tij. Këto janë çështje, të cilat do të doja t'i rregullonim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jon Smibert – *(përkthen përkthyesja)* Le të mendojmë për këtë në mënyrë pragmatike. Nuk mund të mendohet vetëm në mënyrë ligjore për këto gjëra. Jetojmë në një botë pragmatike, ku gjërat ndodhin në një realitet, jo vetëm në teori. Nëse dikush flet për 6-8-10 muaj dhe oficeri përgjegjës e kap, e kupton këtë gjë për një periudhë shumë të shkurtër kohe, i bie që ai të flasë me prokurorin dhe do të angazhojë prokurorët përkatës ose një gjykatës nga gjykata antikorrupsion, për shembull. Më pas, do të realizohet një hetim për këtë person, ku do të merret edhe urdhri nga një gjykatë për hetimin, për investigimin, për përgjimin e këtij personi, pra ky proces do të vazhdojë për 8, 9, 10 muaj, por në këtë rast, do të na duhet urdhri i gjykatës për të filluar hetimin apo përgjimin e këtij personi.

Do t'ju tregoj sesi përgjohemi ne. Ne jemi në një fushë të caktuar fjalësh aty dhe nuk e dimë se cilat janë fjalët kyçe, që do të përdoren, jo vetëm “paratë”, por janë disa fjalë kyçe që të lidhin me përgjimin brenda sistemit. Nuk është vetëm fjala “para”, por janë disa fjalë, të cilat të implementojnë në fushën e krimit.

Vasilika Hysi – Unë do të bëj një pyetje këtu dhe nuk e kam vetëm për këtë nen, por për disa nene dhe nuk do të doja ta ribënim përsëri, nëse qartësohemi. Ne i japim oficerit mbikëqyrës të BKH-së një kompetencë që jo vetëm të mbikëqyrë punonjësit, por edhe të afërmit e të gjithë personave të mësipërm, duke filluar që nga drejtuesi, prokurorët, punonjësit e tjerë të BKH-së, zëvendës drejtori, hetuesit etj.

Kur thoni: “punonjësit e prokurorisë së posaçme”, besoj se flitet për administratën, sepse nuk u kemi dhënë një përkufizim punonjësve të prokurorisë së posaçme.

E dyta, këtu thuhet edhe të gjithë anëtarët e afërm të familjes së personave. Nëse e mbaj mend, kur diskutuam nenin e përkufizimeve, i bëra një pyetje zotit Xhon, se cilët ishin njerëzit e afërm dhe aty futëm edhe persona që kanë ardhur dhe kanë jetuar 60 ditë me personin. Pra, shoh që emërtimi i njerëzve të afërt të familjes, nuk është emërtimi që përcakton ligji i deklaramit të pasurive, për kategorinë e personave të afërm të familjes.

Pyetja lidhet me nenin 8 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut: Unë për shembull, pranoj, firmos që do të punoj si hetuese në Byronë Kombëtare të Hetimit. Por njerëzit e tjerë që mund të kenë ardhur të jetojnë në shtëpinë time, një nip, një mbesë, ka ardhur për gjashtëdhjetë ditë, nuk e jep pëlqimin. Nga ana tjetër, në bazë të Kodit Civil, personi që mbush moshën tetëmbëdhjetë vjeç ka përgjegjësi vetë dhe është për të vepruar. A mundemi ne t'i japim pëlqimin, që t'i përgjojë mbikëqyrësi ose oficeri përgjegjës për mbikëqyrjen e telefonit edhe të njerëzve të tjerë, që kanë ardhur e kanë jetuar për pak kohë? Sepse këtu cenohet neni 8 i Konventës për privatësinë.

Ne nuk kemi të drejtë të firmosim për kontrollin e telefonit, të pasurisë, të llogarive bankare, për njerëz të tjerë, të cilët mund të jenë kushërinjtë tanë, por që s'kanë lidhje fare, e thotë: “ç'më duhet mua, o zonjë apo zotëri, që ti do të punosh në këtë punë e mua më fut në kontroll?!”

Mirëpo fisin ti s'e bën dot hasha, pra nuk e mohon dot. Nga ana tjetër, nuk mund t'ia riskosh jetën atij, sepse do të bësh karrierë e të marrësh një pagë të mirë, e të kesh një emër të mirë.

Fatmir Xhafaj – Dakord!

Zoti Rakipi.

Arben Rakipi – Delikate është. Më duhet të them se, përveç përgjimit, me këtë ngarkesë që u trajtua deri tani. Ky përgjim do të sigurojë edhe mbrojtjen e të gjithë këtyre nëpunësve, sepse bëhet fjalë për nëpunës që mund të jenë të kërcënuar nga krimi i rrugës, nga krimi i organizuar, ndaj përgjimi i tyre ka edhe efekt të thellë parandalues. Në këtë pikëpamje duhet parë edhe pozitivisht, domethënë, jo vetëm thjesht në ngarkesën e keqe.

Megjithatë, për të evituar shkeljet, paligjshmërinë e kështu me radhë, dua t'ju paraqes dy çështje. E para është çështja e pëlqimit, që kërkohet, dhe e dyta është çështja e vëzhgimit periodik, që do të thotë se përgjimi nuk është njëzet e katër orë në njëzet e katër orë, por do të realizohet vetëm në rastet kur të dhënat janë të tilla, që duhet ushtruar.

Këto dy elementë e bëjnë pak të kufizuar dhe e zbusin të gjithë atë shqetësim, që deputetja paraqiti.

Fatmir Xhafaj – Në rregull!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jon Smibert – *(përkthen përkthyesja)* Edhe nja dy gjëra të tjera. E para është se, nëse synon të punosh aty dhe nuk mund të marrësh pëlqimin e të gjithëve që janë aty, në shtëpinë tënde, atëherë ndoshta nuk je personi i duhur për të shkuar dhe punuar atje.

Kategoria e dytë është, gjithashtu, që ti po punon aty, dhe fëmijët bëhen tetëmbëdhjetë vjeç, për shembull, ose gjyshja lëviz dhe jeton me ty, e ata nuk duan që të përgjohen. Në këto rrethana, realiteti i situatës është që, ose ata e japin pëlqimin apo jo, ose ndoshta ti duhet të marrësh një urdhër gjykatë për ta bërë këtë gjë.

Gjithashtu, ndoshta duhet marrë në konsideratë që nuk do të vazhdoni të punoni më si prokuror në mandatin tjetër. Po ashtu procesi mund të jetë periodik, që do të thotë se ka një orar të caktuar: nga ora 3 deri në orën 5 do të dëgjojë telefonin e Korës, ndërsa nga ora 5 deri në 8 do të dëgjojë telefonin e diku tjetër.

Në rregull, pra! Arbenin po e lëmë pak më vonë.

Për ta bërë këtë gjë, nuk do të jetë një përgjim njëzet e katër orë, gjatë gjithë ditës, por do të jetë një përzierje e rastësishme, dhe përzgjedhje e rastësishme nga një listë numrash telefoni marrim listën e numrave të telefonit, që na jep personi. Aty kemi numrat e tij, e këta janë njerëzit që kanë rënë dakord për këtë gjë.

Pra, është një limitim pragmatik. Nuk është se ju po përgjoni të gjithë numrat, sepse duhet të kesh pëlqimin personit në fjalë, në tërë listën e numrave që do të të dorëzojë personi.

Vasilika Hysi – Shumë faleminderit për sqarimin, por unë kam një pyetje: a mund të përgjojme fëmijët nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç? Një prokuror, një punonjës, kanë fëmijë adoleshentë, të cilët flasin gjithë ditën në telefon me njëri-tjetrin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk janë fëmijë madhorë. Këtu tani hyjmë te të drejtat...

Fatmir Xhafaj – Po mirë, pra! I zgjat shumë. Më shkurt.

Vasilika Hysi – Këtu hyjmë tani te të drejtat e fëmijës. Tashti ka edhe një pyetje zoti Manja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jon Smibert – *(përkthen përkthyesja)* E ndryshuam këtë gjë. E ndryshuam përkufizimin e anëtarëve të ngushtë të familjes: njerëzit mbi tetëmbëdhjetë vjeç brenda shtëpisë. Ata nuk janë përmendur, ata kanë të drejta më të veçanta, sepse një tetëmbëdhjetëvjeçar mendohet e nuk do të marrë në telefon nëpërmjet Viber-it a ËhatsApp-it, nuk mendohet se do të përdorin këto aplikacionet.

Ulsi Manja – Nëse do të bëjmë paralelizma, ky është, as më shumë e as më pak, inspektori i SHKB-së, i Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm.

Tani, në ç'raport qëndron ky oficer me..., sepse ne i kemi dhënë Këshillit të Prokurorisë, si qeveri e prokurorisë, edhe këta prokurorë. Pra, struktura e prokurorisë së posaçme do të jetë në varësi të atij këshilli. Pra, Këshilli i Lartë i Prokurorisë emëron, shkarkon.

Ndërkohë, nga ana tjetër, si strukturë ose si institucion që do të hetojë shkeljet e gjyqtarëve dhe të prokurorëve të të gjitha niveleve, është Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, i cili inicion procedimin disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Tani, këtij oficeri i është lënë e drejta të raportojë për shkeljet e etikës së gjyqtarëve dhe të prokurorëve të posaçëm tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë. A mund të shohim, që t'i gjejmë një vend këtij oficeri, në lidhje me mekanizmin e kontrollit mes Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. T'ia gjejmë një vend, se ku mund ta kontrollojmë këtë, që të mund të abuzojë me superpushtetin që i jepet? Sepse, në finale, çfarë do të bëjë ky? Do të përgjigje telekomunikimet e prokurorëve të posaçëm, të punonjësve të BKH-së, të gjyqtarëve antikorrupsion, dhe në fund, me inspektoratin dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë do ta ketë punën ky. Kjo varet nga natyra e shkeljes, se për shkelje të natyrës penale...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, a mund t'ia lëmë mekanizmin e kontrollit të këtij... ndoshta ka vend për ta parë në këtë bosht? Pyetje e kam këtë.

Fatmir Xhafaj – Zoti Rakipi.

Arben Rakipi – Tashti, nëse çështja e kontrollit ndaj këtij personi është një gjë që duhet bërë, le ta bëjmë. Nëse do ta bëjmë, unë mendoj se ky kontroll duhet bërë brenda strukturës, dhe jo jashtë saj. Kjo sepse, kontrolli brenda strukturës shkon paralel me qëllimin pse është vendosur ky oficer, lidhet ngushtësisht me faktin se këtu bëhet fjalë për një strukturë të mbyllur, e cila

kërkon një standard sigurie shumë të lartë. Çështjet e sekreteve janë shumë thelbësore, ndaj shkelja e tyre është me pasoja të rënda.

Këtu bëhet fjalë për gjëra serioze. Domethënë nuk bëhet më fjalë për gjëra të tipit: “e lagu, s’e lagu”. Bëhet fjalë për krimin e organizuar, i cili kërkon të godasë prokurorin ose gjyqtarin që është në shërbim të tij. Për rrjedhojë, përgjimi i realizuar, për të gjitha ato qëllime që përmendëm, duhet të trajtojë e të shqyrtojë brenda strukturës. Të ngelet atje.

Kështu, nëse pika 5 ka vend për t’u modifikuar lidhur me kontrollin...

Fatmir Xhafaj – Dakord. Rishikojeni i këtë, nëse keni hapësirë.

Miratohet neni 43, me riformulimet dhe reflektimin, për sa diskutuam dhe u dakordësua.

Neni 44: “Paga dhe buxheti i Byrosë Kombëtare të Hetimit”.

Vasilika Hysi – Të paktën sipas një komunikimi me ekspertët, lidhur me nenin 44 ata kanë kërkuar një riformulim, sa i takon buxhetit, nëse i kam kuptuar korrekt.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, e keni sjellë me e-mail, por nuk kam mundur ta printoj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shikoni, në tërë këtë ligj ka një problem shumë të madh: edhe te prokuroria e posaçme, ku flitet për buxhetin, edhe te BKH-ja për buxhetin, e të gjitha. Mblidheni këtë në një nen për të dyja e të biem rehat, të jemi të qetë. Riformulojeni për të dyja. Se çfarë kuptimi ka të vëmë në ligj një buxheti për prokurorinë, një buxhet për ata, kur buxheti është një. Ai thjesht ka të drejtën të propozojë pjesën e vet, por në finale fare është prokurori i Prokurorisë së Posaçme ai që e çon buxhetin, e mbron buxhetin, e vjen edhe në parlament që ta përfaqësojë për buxhetin. Nuk vete njeri tjetër.

Jemi të qartë apo s’jemi të qartë? Të ketë një nen për buxhetin, jo tre nene për buxhetin, si dhe të kuptohet se një përgjegjës ka për buxhetin. Se si e zgjidhin brenda ata, është çështja e tyre. Nuk do merret ligji me këto detaje.

Në rregull

Neni 45: “Marrëdhëniet e Byrosë Kombëtare të Hetimit ne strukturat e tjera policore”.

Vasilika Hysi – Ka vetëm tek-tuk ndonjë fjalë që ka nevojë për riformulim. Nuk ka problem tjetër.

Fatmir Xhafaj – Dakord me riformulimet.

Neni 46: “Komisioni i Pavarur i Rishikimit”

Keni gjë ju, zoti Manja?

Ulsi Manja – Jo.

Fatmir Xhafaj – Në rregull. Faleminderit!

Vasilika Hysi – Dua vetëm të saktësoj se ky komision përbëhet komplet nga ekspertë të huaj, 100%, nëse e kam kuptuar saktë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jon Smibert – *(përkthen përkthyesja)* Kjo është pjesë e pritshmërisë, që SHBA-ja dhe BE-ja ka pasur për formimin e BKH-së, sidomos për sa i përket financimit të SHBA-së, ky komision do të ndihmojë. E di se një prej personave do të jetë nga FBI-ja, atashe ligjor dhe përfaqësues i ICITAP-it. Kështu që Komisioni i Rishikimit apo Komisioni i Monitorimit, sido që ta quani këtë... Propozimi pra, ka qenë që të japë ndihmën e vet në drejtimin dhe të japë një mbikëqyrje ndërkombëtare mbi BKH-në.

Pra, kjo ishte në ligjin fillestar dhe është mbajtur gjatë parasysht gjatë gjithë kohës në këtë proces.

Fatmir Xhafaj – Ka një kufi, sepse këtu ka nja shtatë misione asistence nga BE-ja, nja shtatë misione asistence nga SHBA-ja. Të gjithë këto do të jenë këtu, te Komisioni i Pavarur i Rishikimit? Vendosi se kë do të jetë i përbërë dhe me çfarë marrëveshje. Sepse do një marrëveshje me qeverinë shqiptare, në kuadrin e marrëveshjeve të bashkëpunimit. Si do të bëhet pa një marrëveshje, sepse është edhe çështje kushtetuese?

Jon Smibert – *(përkthen përkthyesja)* E di për të dyja marrëveshjet që ne keni pasur; keni një marrëveshje dypalëshe me SHBA-në, që lejon OPDAT-in dhe ICITAP-in, ndihmën në mbrojtje, që ju merrni, por kjo do të jetë baza për këtë proces. Gjithashtu, ju keni edhe një Marrëveshje Stabilizim Asociimi me Bashkimin Europian, e cila është një marrëveshje para aderimit.

Fatmir Xhafaj – Mund të mos ketë detaje lidhur me këtë gjë. A do të duhej që kjo të ketë një marrëveshje të drejtpërdrejt, për ta rregulluar gjithë këtë proces, që të jetë në përputhje me Kushtetutën e vendit. Një kjo.

E dyta, nuk keni lënë nen pa thënë këtu e pa përmendur detaje nga më të hollësishmet. Vetëm kjo është një gjë e përgjithshme e pa asnjë detaj. Nëse do të rregullohet te marrëveshjet

dypalëshe, jam dakord: sa veta janë? Si funksionojnë? Çfarë mandati kanë? Të gjitha këto përbëjnë elementë të rëndësishëm.

Jon Smibert – *(përkthen përkthyesja)* Unë nuk mendoj se sa shtrihet. Kjo është që ju të keni një EULEX të ri këtu, por nënkuptohet që të jenë ata ofrues të ndihmës, që ekzistojnë tashmë, dhe të caktojnë personat, të cilët do të jenë pjesë e këtij komisioni, mbase komision s'është fjala e duhur për t'u përdorur, por do të tjetër thjesht një komision personash, të cilët do të japin këtë këshillë e këtë transparencë.

Ju, nëse doni një marrëveshje ndërkombëtare vetëm nga kjo e kaluar, e miratuar nga senati në SHBA, kjo gjë nuk ndodh. Nëse ju i doni paratë nga FBI-ja, që të jenë këtu të pranishme, dhe FBI-ja të ofrojë ndihmën e saj, atëherë hapja e këtij procesi është e nevojshme dhe pjesë e këtyre marrëveshjeve dypalëshe, që janë të nënshkruara mes Departamentit të Shtetit dhe Shqipërisë. Mbase këto do të jenë brenda marrëveshjes kuadër, që ka me Bashkimin Europian, me PAMECA-n apo me të tjera. Këto do të përzgjidhen nga misionet, e kjo do të thotë se delegacioni i BE-së do t'i caktojë ata persona?

Fatmir Xhafaj – Prandaj po them se, për shembull, BE-ja ka këtu nja katër misione asistence policore. Duhet ndalur se për çfarë bëhet fjalë, për një moment: çfarë statusi kanë këta? Çfarë mandati? Cilat janë detyrat që kryejnë këta?

Kështu, kam përshtypjen se kjo është një gjë që duhet të qartësohet. Neni 46 duhet të riformulohet e të mbetet e hapur për t'u riparë. Edhe unë, nga ana ime, do të ulem ta shoh më me vëmendje, që ta shqyrtojmë përpara miratimit në tërës.

Vazhdojmë me nenin 47: “Mbrotjtje sipas shërbimit civil për punonjësit e gjykatave, kundër korrupsionit, krimin të organizuar, dhe strukturave të posaçme kundër korrupsionit”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, te paragrafi i dytë, në logjikën e diskutimeve që kemi bërë edhe te ligji për statusin e gjyqtarëve e prokurorëve dhe statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë, duhet të flasim – në fakt nuk e di nëse keni marrë ndonjë përgjigje nga DAP-i, pasi ju keni folur – nëse mund t'i zbatojmë këto dispozita, sepse ligji “Për statusin e nëpunësit civil” e përjashton në mënyrë laksative zbatimin dispozitave të këtij ligji për administratën gjyqësore, për prokurorët dhe gjyqtarët. E ka të fusha e zbatimit përjashtimin, çka do të kërkojë ndërhyrje në atë ligj, për të bërë...

(Ndërprerje shumë e shkurtër incizimi)

Fatmir Xhafaj – ...dispozita shumë të qarta lidhur me nëpunësin e shërbimit civil te ligji “Për prokurorinë”. Pse s’u referohemi të njëjtave? Cili është ndryshimi, përveç atyre që mund të bien në kundërshtim me këtë ligj. Pyetja ime.

Pra, ato që keni vënë atje për statusin, te ligji “Për prokurorinë”, t’i marrim këtu. Jo t’i vendosim, se s’është e thënë, por thjesht në një nen ta themi: zbatohen dispozitat e parashikuara për këtë e për këtë e për këtë, për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Dakord?

Jon Smibert – *(përkthen përkthyesja)* Në fakt, kur kjo gjë është shkruar ose mënyrat se si këto dispozitat për mbrojtjen e statusit civil, si dhe në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, unë nuk mendoj se ky nen do të jetë i nevojshëm më këtu. Pra, është një nen i panevojshëm, pasi del atje. Te dy ligjet e tjera është më e zhvilluar.

Fatmir Xhafaj – Mund të përmendim thjesht, që i nënshtrohet, referencën dhe kaq. Thjesht që statusi, e të tjera, rregullohen sipas parashikimeve që janë bërë në ligjin për prokurorinë, dhe mbyllet. Është thjesht një nen reference.

Dakord? Në rregull! Faleminderit!

Neni 48: “Standardet e sjelljes së punonjësve”.

Nuk ka ndonjë gjë. Besoj se është thjesht...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Unë kam një pyetje, por edhe një sugjerim, gjithashtu.

Ne kemi një ligj “Për kontrollin e deklarimit të pasurive dhe konfliktin e interesave”. Në paragrafin 1 të këtij neni, ne e kemi zgjeruar rrethin, për të bërë deklaram një grup shumë më i madh se sa vetë ligji. Pyetja ime, zoti kryetar, qëndron...

Fatmir Xhafaj – Ku? Në paragraf janë të detyruar të bëjnë deklaram financiar vjetor, nëpër inspektorate, por s’ka këtu.

Vasilika Hysi – Po ke futur punonjësit e administratës. Në bazë të ligjit për deklarimin e pasurive, e ke vetëm për funksionarët e lartë. Ligji nuk parashikon se duhet të deklarojnë pasurinë sipas këtij ligji punonjësit e administratës.

Fatmir Xhafaj – Nejse, ky është një ligj me tre të pestat, ndaj prevalon mbi atë.

Vasilika Hysi – Jo, se i është referuar edhe ligjit, pra.

Fatmir Xhafaj – Mirë pra, dakord, derisa i ke futur, ata thjesht do të zbatojnë detyrimet e atij ligji. Pikë. Kur të ndryshosh ligjin atje, do të fusësh edhe këta.

Vasilika Hysi – Pyetja qëndron: a do të ndryshojë ai ligji, që do të zgjerojë fushën e zbatimit të tij?

Fatmir Xhafaj – Patjetër! Deri sa të biem dakord këtu...

Vasilika Hysi – Kjo është. Ta kemi parasysh për gjithë këtë.

Fatmir Xhafaj – Po, dakord!

Vasilika Hysi – Gjithashtu, kemi një ndryshim të rrethit të anëtarëve të familjes. Në përkufizim, rrethi i anëtarëve të familjes është lënë më i ngushtë, dhe është lidhur me faktin se kush është. Është bashkëjetuesi dhe ata persona, që kanë jetuar për gjashtëdhjetë ditë. Këtu zgjerohet rrethi. Këtu fillojnë nipërit, mbesat, gjyshët, gjyshet, xhaxhallarët, dajat, kushërinjtë e parë, kushërinjtë e dytë, të gjithë.

Fatmir Xhafaj – Në rregull! Cili është qëllimi, që është kërkuar kjo listë, ku renditen të gjithë anëtarët e familjes së vetë punonjësit dhe bashkëshortes? Thjesht është si listë apo këta do të jenë pjesë e një kontrolli të posaçëm?

Jon Smibert – *(përkthen përkthyesja)* Kjo është thjesht një listë, që thjesht sqaron se cilët janë ata të tjerët. Kjo nuk do të thotë se ata do të monitorohen, por do të thotë se ndonjëherë, kur unë flas për dikë, atëherë unë të them: “ok, ky që po flet është kushëriri i personit, apo ai me të cilin është takuar; për shembull, ai me të cilin është takuar Arbeni, për atë marrëveshjen apo për atë ujdinë”.

Pra, është e thjeshtë për t’u siguruar që, kur ata janë të listuar, të renditur, ne e dimë se kush është atje dhe me kë është duke folur apo me kë është takuar. Kjo mundëson një kuptim sa më të mirë.

Fatmir Xhafaj – E keni caktuar, besoj, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është edhe për efekt të konfliktit të interesit, kur ai ka një çështje të caktuar, dhe dihet që lista është kjo. Pra, ata, dajat, hallat, xhaxhallarët, nuk do të bëjnë deklaram pasurie, e as do të jenë subjekt kontrolli. Pikë.

Jemi dakord, besoj. Qartë!

Miratohet, me ndryshime neni 48.

E kemi thënë tashti: këta do të marrin përsipër një punë të veçantë, por do të kenë edhe ca rregullime të veçanta në statusin e tyre, nga pikëpamja e pozitës që kanë. Kusur e kanë, por me dëshirë do të venë. Ka shumë kërkesa për të shkuar atje, më kanë thënë.

Korajlka Bumci – *(përkthen përkthyesja)* Mbase kjo mund të jetë edhe pyetje e pyetësorit, që ata do të plotësojnë. Pra, mund të jetë edhe pjesë e pyetësorit. Mund të mos jetë thjesht pjesë e ligjit.

Fatmir Xhafaj – Në rregull! Kijeni parasysh! Dakord!

Neni 49: “Siguria e mjediseve”.

Vasilika Hysi – Nuk kemi. vetëm ndonjë formulim të vogël gjuhësor. Është Siguria nga Policia e Shtetit, mbrojtja.

Fatmir Xhafaj – Këtë Policia e Shtetit do ta bëjë, por

Vasilika Hysi – Po, e kanë lënë me Policinë e Shtetit.

Fatmir Xhafaj – Po gjykatat, prokuroritë, e kanë me polici private? Do të bëjmë përjashtim për këta?

Vasilika Hysi – Në dijeninë time është lënë Policia e Shtetit edhe te ligji tjetër. madje, nëse ju kujtohet... Megjithatë, më lini të verifikoj edhe mbrojtjen e të gjykatave të tjera!

Fatmir Xhafaj – Në rregull!

Vazhdojmë me nenin 50.

Vasilika Hysi – Në nenin 50 kemi bërë ndonjë redaktim të vogël, por të vetmen gjë që do të mbajmë mend, është që kur të kalojmë ligjin “Për statusin e gjyqtarit e të prokurorit”, të kemi parasysh referimin e nenit, se mos kemi ndonjë ndryshim të referencës në numrat e neneve. Vetëm kaq.

Fatmir Xhafaj – Në rregull!

Në rregull neni 50, me këtë sugjerim.

Neni 51.

Vasilika Hysi – Te neni 51, kemi përsëri përdorim të termave “anëtarë të afërm të familjes së personave”.

Fatmir Xhafaj – Po e keni shpjeguar në “Përkufizime” se cilët janë të afërmit.

Vasilika Hysi – Nëse i referohemi paragrafit të parë të këtij neni, këtu s’kemi ndonjë referim për “anëtarët e afërm të familjes”. Diçka mungon. Duhet të jetë edhe një paragraf i ndonjë neni tjetër. Këtu flitet se kush ka të...

Fatmir Xhafaj – Po paragrafi i parë është që firmos vetë ai, me sa kuptoj unë. Paragrafi i dytë është për të afërmit e tij. Pika 2 është për anëtarët e afërm të familjeve të peronave.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, të këtyre personave, që janë në pikën 1, familjarët e atyre të pikës 1.

Vasilika Hysi – Po, dhe kam një pyetje...

Fatmir Xhafaj – Se cili është koncepti i anëtarëve të afërt, të familjarëve të tyre, është dhënë në përkufizim, apo e kam gabim? Në rregull!

Kemi tjetër në gjithë këtë? Përjashto këto...

Vasilika Hysi – Jo, çështja tjetër është pyetje...

Fatmir Xhafaj – Rregullime?

Vasilika Hysi – Po, rregullime të vogla janë bërë, por kam një pyetje, e cila dua të regjistrohet dhe të mbetet përgjigja: nëse një nga anëtarët e afërm, njëri, nuk pranon të firmosë deklaratën, çfarë ndodh? Ai thotë: s’ka të drejtë, unë s’flas fare me kushëririn tim, nuk kam lidhje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë edhe persona që kanë ardhur për të jetuar gjashtëdhjetë ditë në vit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, a mund ta përkufizojmë edhe një herë se cilët janë anëtarët e afërm të familjes? Sepse ka përkufizim tjetër te neni 9, ka përkufizim tjetër te ligji “Për deklarinimin e pasurive”.

Fatmir Xhafaj – Edhe një herë: ky është një ligj i posaçëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo për efekt të pasurive, Vasilika, po për efekt të deklarinimit dhe të kontrollit ndaj tyre. Për këtë gjë do të prevalojë ky ligj. Konceptin se cilët janë të afërmit e familjarëve, e kemi pranuar. Në qoftë se ata nuk pranojnë fëmijët e mi, në qoftë se nuk deklarojnë sot pasurinë, kanë pasoja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po e ke te fillimi fare, te përkufizimet, se cila është.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si, do të rrinë gjashtëdhjetë ditë në shtëpi dhe do të firmosin?

Vasilika Hysi – Unë do të doja të saktësoja, se është e sata herë që pyesim: “anëtari i afërt i familjes nënkupton”, thotë neni 9, “bashkëshortin, bashkëshorten, fëmijët mbi

tetëmbëdhjetë vjeç, si dhe çdo person të lidhur nga gjaku ose martesë, i cili banon më shumë se gjashtëdhjetë ditë në vit në të njëjtin vendbanim”.

Fatmir Xhafaj – Në rregull! Çfarë do të thotë kjo: “më shumë se gjashtëdhjetë ditë”? Në qoftë se unë marr një mbesën time dhe e mban daja gjashtëdhjetë ditë, duhet të bëjë deklarinin ajo? Ky është koncepti që keni?

Korajlka Bumci – *(përthën përthyesja)* Mendoj se jemi dakord që do ta riformulojmë këtë gjë, dhe do të kemi variantin atyre që do të jetojnë në banesë, kanë apo s’kanë lidhje gjaku.

Funksioni fillestar i kësaj gjëje është të kapim ata njerëz, të cilët janë në shtëpi, në banesë. Nëse janë në banesë, atëherë kjo është ideja, nëse ajo çfarë ndodh me ata të ndikon ty në punën tënde.

Fatmir Xhafaj – Për një kohë të gjatë, është e drejtë, logjikisht.

Dakord me nenin 51, me ndryshimet e plotësimet.

Neni 52: “Deklarimi dhe kontrolli fillestar për gjyqtarët”. Dakord?

Vasilika Hysi – Është e njëjta....

Fatmir Xhafaj – Është e njëjta logjikë. Dakord me vërejtjet dhe ndryshimet që janë bërë

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, tani këtu ndryshon koncepti për anëtarët e afërm të familjes, sepse i referohen ligjit “Për deklarinin e pasurive”.

Fatmir Xhafaj – Po mirë, pra, janë për efekt pasurie këto.

Vasilika Hysi – Pyetja ime është: do ta referojmë numrin e ligjit, apo do ta lëmë në bazë të legjislacionit në fuqi, për deklarinin dhe kontrollin e pasurive? Si mendoni.

Fatmir Xhafaj – Mjafton.

Vasilika Hysi – Në rregull!

Fatmir Xhafaj – Më falni: nëse ka pasuri me vlerë më shumë se 133 % e pasurive. A mund të ma thoni se ç’do të thotë 133 %? Po sikur ta bëjmë 135 %, çfarë bëhet?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – ka një ndryshim. Në Kushtetutë ke thënë dyfish.

Fatmir Xhafaj – Mos është shtypur gabim, ose është ndonjë paqartësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, ju lutem!

Jon Smibert – *(përkthen përkthyesja)* Me atë çfarë mund të kuptoj, ajo çfarë bën ILDKP-ja është se ka një program që bën vlerësimin se cilat prona duhet të keni, cilat asete mund t'i përballoni, ndërsa më pas, nëse keni asete më shumë se sa kaq, atëherë kalon një margjinë specifike për atë vlerësim, pra 150 % garanton që ti të mos jesh jashtë asaj margjine të përcaktuar, ose atij kufiri, marzhi të përcaktuar.

Fatmir Xhafaj – Dakord, vetëm se kjo 133 % ta vret pak veshin. ILDKP-ja duhet të ketë ndonjë term tjetër: dyfishin, më shumë se trefishin. Sepse unë mund të ngrihem e të them: po sikur ta bëjmë 137? Kam një koleg deputet, Erion Braçe, i cili më ka mbajtur dy orë për këtë gjë. Sepse ai thotë se, edhe sikur 1 % ta kesh...

Vasilika Hysi – A mund të bëj një pyetje, zoti kryetar?

Fatmir Xhafaj – Kemi ndonjë gjë për këtë?

Vasilika Hysi – Po, për këtë. Pyetjen e kam për zotin Xhon: te aneksi i Kushtetutës, te neni “D”, ne kemi thënë: “dyfishi” i pasurisë së ligjshme.

Fatmir Xhafaj – Po pra, duhet unifikuar kjo.

Jon Smibert – *(përkthen përkthyesja)* Jo domosdoshmërisht, sepse ajo është për të pasur një sanksion për dikë që humbet pozicionin. Është për të sqaruar se hyn në një pozicion të ri. Neni 52 dhe 53, e ka 135 % për anëtarët e ngushtë të familjes dhe ëpr familjarët. Unë nuk mund ta shpjegoj, se pse diku është 133 % e diku tjetër është 135 %. Pra, nuk është se kemi ndjekur ndonjë rrugë shkencore, që kemi ardhur te këto llogaritje.

Fatmir Xhafaj – Duhet të jetë ndonjë term më i gjetur. Kaq.

Në rregull. Dakord me nenin 52, me ndryshimet.

Vasilika Hysi – Jo, jo, ka diçka tjetër.

Fatmir Xhafaj – Po.

Vasilika Hysi – Lidhur me detyrimin që, për të përshkruar udhëtimet nga 1 janari i 2010-ës, dhe detyrimi për të përshkruar çdo lloj takimi, komunikimi të bërë nga 1 janari i 2010-ës, çfarë ndodh, nëse një person nuk mban mend se me kë ka folur nga 1 janari i 2010-ës, ose nuk është në dijeni që personi me të cilin ka folur është ën ndjekje penale? Janë disa detyrime. Sepse ju keni thënë: nga 1 janari i 2010-ës do të bëj një listë të të gjitha komunikimeve, takimeve, marrëdhënieve që ka pasur me të gjithë personat, të cilët në dijeninë e kandidatit, janë arrestuar e dënuar. Më parë apo më pas?

Fatmir Xhafaj – Mirë pra, thuhet: “në dijeninë”. Në qoftë se s’e ka ditur...

Vasilika Hysi – Më parë apo më pas?

Fatmir Xhafaj – Nuk e ka ditur, mbaroi. Në dijeni. Në qoftë se s’e ka ditur, nuk do ta thotë. Kur të dalë, do të provojë se ai s’kishte dijeni. Në qoftë se ai ka pasur dijeni dhe e ka fshehur, se ka qenë një fakt publik, e të tjera, bëhet shkak për të mos plotësuar kriteret. Kështu kuptohet, besoj.

Korajlka Bumci – *(përkthen përkthyesja)* Një sugjerim. Nuk e kam diskutuar me kolegët, por mund të jetë edhe pjesë e pyetësorit. Mund të mos jetë në ligj fare.

Fatmir Xhafaj – Nga 1 janari 2010, dakord, për arrestimet që mund të ketë. Ok, në rregull!

Korajlka Bumci – *(përkthen përkthyesja)* Sepse ju e dini se për pak vite periudha do të bëhet ndryshe. Prandaj nuk është për ligjin. Duhet të jetë ëpr dy-tre vjetët e fundit. Sepse, dy vjet pas këtij momenti, do të ndryshojë periudha.

Fatmir Xhafaj – Zonja Hysi, në qoftë se ai nuk e di se qenka arrestuar, tashti, dreqi e mori...

Vasilika Hysi – Para apo mbrapa?

Fatmir Xhafaj – Ja s’e mban mend. Po si s’e mbaja mend ai?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, por më thua: pse nga 2010 e këndeje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Hiqeni këtë “aeroplanët”. Më falni, a dini se ka ndonjë njeri aeroplan në Shqipëri? Ju ka ngelur vetëm të shtoni edhe raketën. Mos e kaloni në ekstrem tashti.

Jon Smibert – *(përkthen përkthyesja)* Kam parë dikë këndeje nga plazhet, me një aeroplan, në fakt. Ishte vetëm shaka.

Fatmir Xhafaj – Jemi lodhur tashti, dhe s’ka asgjë të keqe të bëjmë edhe një çikë shaka. Vetëm zonjën Hysi mos ma mërzisni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, e gjithë kjo duhet ripunuar, në mënyrë që të shikohet se çfarë do të shtohet tek aneksi, te pyetëtori e të tjera e të tjera, dhe çfarë të ngelet në ligj, të të bëhet e mundur të mos ketë ca gjëra të detajuara. Në Gjermani e në Amerikë mund të jetë normale të kesh aeroplan, por në Shqipëri shyqyr që kemi ndonjë makinë. Bile tashti na kanë thënë se i kemi fshehur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

Korajlka Bumci – *(përkthen përkthyesja)* Ka diçka këtu: është bërë një gabim te paragrafi 5. Është dhjetë vjet, ndërkohë që në Kushtetutë është 9 vjet.

Fatmir Xhafaj – Në rregull! Faleminderit! E miratojmë me këto ndryshime. Ju lutem, edhe ato detyrat që lamë për t'u riparë, bashkë me inspektoratin, për t'i pastruar dhe për t'i kaluar një pjesë te deklaratat shoqëruese, që ligji të mos jetë detajist në gjëra që s'ka kuptim të jetë. Mjaft të themi se ai do të bëjë deklarimin që lidhet me këtë e me këtë e me këtë, sipas deklaratës që do të ketë në dispozicion.

Faleminderit!

Neni 53: “Deklarimet e kontrollit fillestar për punonjësit dhe anëtarët e afërt të familjes”.

Vasilika Hysi – Është e njëjta gjë, si te neni 52. Tani është për punonjësit e thjeshtë.

Fatmir Xhafaj – Po kjo duhet të jenë një çikë më e thjeshtë, besoj unë. Do t'ju lutesha. Ai punonjës është, s'do të ketë të njëjtën ngarkesë me prokurorin. Ky sidomos duhet ta ketë në një deklaratë të listuar atë që firmos. Të mos vendosim në ligj që sekretari i gjykatës të tregojë se ku ka qenë, ka çadër apo s'ka çadër.

Dëshira është e mirë. Unë jam shumë dakord. në parim jam dakord. unë që vendos të bëj politikanin, duhet të di që kam disa kufizime në jetën time, në lirinë time private, si dhe në mënyrën se si sillem, për sa kohë që e kam marrë përsipër. Përndryshe s'ka pse bëhem politikan, por rri avokat.

Edhe këta e marrin përsipër këtë gjë, por ligji nuk duhet të jetë kaq detajist, t'i ndajë paksa. Nuk është njësoj si prokurori, si hetuesi dhe ky punonjësi i administratës. Kështu që kjo duhet reflektuar. Dakord?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Këtu është parashikuar detyrimi i Shërbimit Informativ Shtetëror të dorëzojë një raport te secili autoritet ku të thuhet nëse deklarimi është i plotë dhe i saktë. A mundet që Shërbimi Informativ, Shtetëror, në momentin kur ligji hyn në fuqi, të ketë informacion nga viti 2010 e këtej për çdo lloj personi, ku në bazë të ligjit “Për Shërbimin Informativ Shtetëror”, personat që mund të jenë në përgjim? Nuk e kam idenë shumë për këtë shërbim... A do të ishte mirë të pyeten nëse ka ose jo informacion? Dhe nëse informacioni që zotëron shërbimi...

Fatmir Xhafaj – Çfarë të keqe ka ta ketë detyrimin ai?

Vasilika Hysi – Ma dëgjoni deri në fund pyetjen, se e kuptoj që të gjithë jeni lodhur. Këtu thuhet të konfirmojnë nëse informacioni është i plotë dhe i saktë. Mund të mos ketë fare informacion. Në radhë të parë të deklarojë nëse ka ose jo informacion, se nuk mund të ketë informacion për një njeri që nuk është përgjuar, por po zgjerohet rrethi për një kategori shumë të madhe njerëzish.

Arben Rakipi – Unë e mendoj që Shërbimi Informativ Shtetëror do të konfirmojë për aq sa është e mundur të konfirmojë deklarinimin e bërë.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Unë nuk e kuptoj këtë gjë, Xhon. Byroja Kombëtare e Hetimit dhe Shërbimi Informativ Shtetëror i dorëzojnë nga një raport secili autoritetit kompetent të emërtesës dhe drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Pra, byroja drejtorit? Mos e keni gabim? Te pika “c” thoni që Byroja Kombëtare e Hetimit, po heq për një moment pjesën tjetër të fjalisë, i dorëzojnë një raport autoritetit kompetent emërtesës dhe drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Si nga byroja? Mirë shërbimi është një organ i jashtëm, por këta kujt ia dërgojnë? Ia dërgojnë vetes së tyre raportin? Është një gjë që rregullohet. Pra, është lapsus. Dakord.

Miratohet neni 53 me ndryshimet.

Neni 54. Mbikëqyrja e vazhdueshme.

Vasilika Hysi – Lidhur me nenin 3 te mbikëqyrja e vazhdueshme thuhet nga cilido prokuror i prokurorisë. Oficeri përgjegjës i Byrosë Kombëtare të Hetimit, nëse nga vëzhgimi i vazhdueshëm i informacionit që mbështet... raporton atë dyshim një prokurori çfarëdo.

Fatmir Xhafaj – Ne sikur e lamë që do ta zgjidhim atje te oficeri përgjegjës se kujt do t’i raportojë dhe si do të raportojë.

Vasilika Hysi – Çdo prokurori, apo do të kemi...?

Fatmir Xhafaj – Kujt t’i dalë përpara...

Aty ju keni thënë 10 prokurorë. Në këta 10 prokurorë, në qoftë se ai ka diçka, atij që preferon do t’ia bëjë këtë gjë apo atij që është i gatshëm?

Jon Smibert – *(përkthen përkthyesja)* Edhe një herë, do të jetë mjaft pragmatike. Si mund të përcaktosh dikë nëse ai person tek i cili do të bëhet raportimi, ai person i cili nuk është i përfshirë... Nëse unë jam duke dëgjuar për shembull Arbenin, sigurisht që unë nuk do të raportoj tek Arbeni.

Fatmir Xhafaj – Siç ka ky, është dhe një prokuror tjetër me përjashtimin kur flitet për të. Pra, meqenëse ju morët emra, unë jam oficer përgjegjës dhe jam duke ushtruar detyrën, ndërkohë ju jeni prokurori që po këto 6 muaj keni detyrimin që të më dëgjoni mua për raportimet që kam. Nëse mua më del diçka duke ju përgjuar ju që keni shkelur ligjin, atëherë unë kam detyrimin që të mos shkoj te ju, por të shkoj te prokurori pasardhës që ka këtë të drejtë që do të bëjë shërbimin. Unë do të shkoj ku të dua, por janë 10 prokurorë. Unë zgjedh atë prokuror që e kam mik dhe i them që po ta jap ty, por mbuloje, fjala vjen. Po bëj avokatin e djallit

Arben Rakipi – Domethënë termi “çfarëdo” do kuptuar jo me prokurorin “çfarëdo”, çfarë i del përpara, por do kuptuar që ky person oficerin nuk mund ta mbajë për vete...

Fatmir Xhafaj – E para, ai e ka detyrim.

E dyta, ku e ka detyrimin të shkojë jo çfarë do ai.

Arben Rakipi– Termi “çfarëdo” do të thotë në prokurori.

Fatmir Xhafaj – Te kush?

Arben Rakipi – Domethënë të gjithë prokurorët, përveç atij eventualiteti që u tha duhet dhe mund të marrin dhe ta trajtojnë këtë informacion. Rëndësi për të ka që të raportojë në lidhje me shkeljet.

Fatmir Xhafaj – Ta rregullojmë këtë mënyrë raportimi. Kemi një oficer përgjegjës që ka 6 muaj në këtë detyrë. Ndërkohë vëmë dhe një prokuror që me short ka 6 muaj me detyrën. Nëse bëhet fjalë për cilindo prokuror tjetër, ai duhet të shkojë te ky prokuror. Nëse bëhet fjalë për këtë prokuror, do të shkojë tek ai që e ka pasur 6-mujorin e mëparshëm. Por të jetë e institucionalizuar kjo, se kështu me çfarëdo, kudo, për cilindo. Shiheni këtë gjë.

Po, zoti Smibert.

Jon Smibert – *(përkthen përkthyesja)* Ose mund të jetë që ju i raportoni kryetarit apo ndonjë prokuror tjetër, i cili mund të jetë një prokuror i thjeshtë apo prokuror në detyrë, apo dikujt tjetër nëse dhe ky prokuror është i përfshirë, me qëllim që të jetë sa më e lehtë për ta përfshirë aty.

Fatmir Xhafaj – Dakord neni 54 me riformulimin. Hiqeni këtë me “çfarëdo”, “kushdo” dhe “ngado”.

Neni 55. Kontrolli dhe vëzhgimet që kryhen nga Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave.

Vasilika Hysi – Është i njëjti diskutim që ne bëmë në parim për mbikëqyrësin. Në këtë rast një përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Parave i zgjedhur me short për 2 vjet ushtron kontrollin e çdo lloj llogarie transaksioni të stafit dhe të familjarëve të afërm. Në parim ajo që do të diskutojmë është se ky pozicion do të lihet 2 vjet apo do të mbështesim atë idenë që hodhi zoti Xhon...

Fatmir Xhafaj – Nuk është i brendshëm ky. Ky mund të rrijë 2 vjet, sepse ata 5 veta janë gjithsej atje te drejtoria...

Vasilika Hysi – Nuk e kam idenë si është drejtoria prandaj po ju pyes. Do ta lëmë 2 vjet?

Fatmir Xhafaj – Mos pyet më mirë si është, por thuaj si do të jetë. Se si është dhe si ka qenë një herë...

Jon Smibert – *(përkthen përkthyesja)* E ndajmë dhe e bëjmë 1 vit?

Fatmir Xhafaj – Shikojeni se mund të rrijë dhe me 2 vjet, sepse ky është një institucion që bën detyrën e zakonshme në fund të fundit. Bën detyrën e zakonshme, por thjesht është i fokusuar gjatë këtyre 2 vjetëve te kjo punë. Se nuk ka dhe shumë njerëz atje. Aq janë të gjithë dhe aq pak janë si numër, pak janë të saktë. Pas 2 vjetësh do t'ju bjerë juve dhe **Korës** ta bëni atë detyrë. Të vijë dhe zoti Rakipi për ndihmë. Unë do të jem në pension, nuk do të jem më në politikë. Mund dhe të më kërkoni ndihmë. Por avokat do të jem.

Dakord me nenin 55 bashkë me ndryshimet.

Neni 56. Kontrolllet dhe vëzhgimet që kryhen nga Byroja Kombëtare e Hetimit.

Vasilika Hysi – Ka ndonjë redaktim të vogël. E vetmja pyetje është për pikën 5. Aty ku thuhet: “oficeri përgjegjës nuk dëgjon telefonatat që shkelin të drejtën e jetës private të personave që u kanë dhënë miratim paraprak nga vëzhgimi”. Pyetja ime është: kush e kontrollon respektimin e kësaj të drejte? Ky është një parim, por askush nuk e di që gjatë komunikimeve del në telefonatë një person që nuk ka dhënë pëlqimin paraprak.

Fatmir Xhafaj – Edhe sot ai mund të dëgjojë gjëra private dhe i fshin. E ka të drejtën edhe sot. Edhe sot në dijeninë time këtë gjë bën. Ai mban të regjistruara, të zbardhura, vetëm ato gjëra që kanë lidhje me çështjen. Apo jo zoti Rakipi?

Dakord me nenin 56.

Neni 57. Mbrojtja e të dhënave.

Vasilika Hysi – Kam vetëm një pyetje për saktësi. Të dhënat personale për foljen “mbahen”, fjala është thjesht për ruajtjen dhe përpunimin. Unë mendoj që duhet të jetë dhe ruajtje dhe përpunim, dhe asgjësimi. Gjithçka duhet të jetë në bazë të ligjit “Për të dhënat personale”.

Fatmir Xhafaj – Të dhënat personale trajtohen në përputhje me...

Vasilika Hysi – Të përdorim terminologjinë që ka ligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Fatmir Xhafaj – Dakord ta gjejmë te ligji. Përputheni këtë me ligjin.

Vasilika Hysi - Më tepër e bëra këtë pyetje për ekspertët. Mos keni pasur ndonjë kuptim për të devijuar nga ligji?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Dakord me nenin 57 bashkë me këtë sugjerim.

Neni 58. Raportimi i informacionit dhe i provave te një prokuror jo i përfshirë i prokurorisë së posaçme.

Vasilika Hysi – Kjo është ajo që ne diskutuam deri tani, rregulli që krijohet për të raportuar...

Fatmir Xhafaj – Të vëmë një rregull këtu siç folëm. Të lutem zoti Rakipi më ndihmoni. Hiqeni titullin “raportimi”. Shkruajeni shkurt “raportimi i informacionit dhe i provave”. Pastaj se, ku këtë e shpjegon dispozita.

Miratohet me ndryshimet.

Neni 59. Shkarkimi për shkeljen e kushteve të besimit dhe të konfidencialitetit.

Vasilika Hysi – Nuk ka ndonjë gjë, vetëm teori, riformulime...

Fatmir Xhafaj – Riformulime, saktësime gjuhësore.

Dakord me nenin 59.

Kalojmë te kreu 9. Dispozita përfundimtare. Neni 60. Buxheti fillestar. Te neni 60 do të fusni të gjitha çfarë janë për buxhetin dhe do të bëni një ligj. Buxheti. Dhe aty do të vendosni një pikë që do të jetë buxheti fillestar.

Vasilika Hysi – Ndoshta si riformulimi që kanë përgatitur dhe e kanë dërguar.

Fatmir Xhafaj – Por është edhe një takim sot për çështjen...

Atëherë të gjitha çfarë janë për buxhetin do të futen në një nen të vetëm, ku futet edhe buxheti fillestar që të kemi konceptin e buxhetit. Pra, gjithçka për buxhetin te një nen. Po të jetë

e nevojshme, le të bëhen dy, por mirë është që të jenë në një vend, jo të shtrirë në të gjithë ligjin. Sa që duket sikur ka shumë buxhete, shumë njerëz që merren me buxhetin dhe krijojnë një lloj kakofonie.

Dispozita kalimtare.

Vasilika Hysi – Për dispozitat kalimtare kam 3 çështjet e para. Ne kemi marrë një letër nga Gjykata e Krimeve të Rënda nga zoti Sandër Simoni. Nuk e di nëse ju jeni njohur me përmbajtjen e letrës. Ai ka shprehur opinionin, shqetësimet e tij, si dhe të gjyqtarëve lidhur me nenin 167 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve, prokurorëve”. Do të doja opinionin tuaj pasi ne nuk jemi shprehur për letrën. E para.

E dyta, lidhur me statusin e prokurorëve për krimet e rënda që parashikohet në nenin 168. Për dispozitat kalimtare për ligjin “Për statusin e gjyqtarit, prokurorit” kemi letrën të hapur, zoti kryetar, në qoftë se ju kujtohet. Në këtë kuadër do të ishte me interes dhe kemi kërkuar të dëgjojmë opinionin tuaj lidhur me dispozitat për paragrafin e dytë. Gjithashtu rezervojmë të drejtën që neni të ndryshojë në varësi të ndryshimit të renditjes së neneve të ligji “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve”, meqenëse ka një ndryshim të numrit të neneve.

Lidhur me paragrafin 4 ju keni thënë që brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji duhet të jetë siguruar një ambient i përshtatshëm pune për Byronë Kombëtare të Hetimit. Pra, i është vënë kusht qeverisë që të ketë një mjedis. Nga pikëpamja kushtetuese ne kemi një detyrim që ky ligj ka faturë financiare dhe ne nuk kemi folur më duket në takimin që bëmë. Folëm për buxhetet dhe pagat, por nuk folëm për mjedise dhe pajisjen e mjedisëve. Unë nuk kam ndonjë informacion. Në qoftë se ka kryetari informacion dakord jam.

Dhe e fundit, besoj se duhet të kemi një dispozitë ku do të ngarkojmë Këshillin e Ministrave, institucionet që do të nxjerrin aktet nënligjore dhe afatet e nxjerrjes së akteve nënligjore.

Fatmir Xhafaj – Ky është para nenit 61. Aktet nënligjore.

Vasilika Hysi – Në këtë ligj ka shumë referenca për vendime që duhet t’i marrë Këshilli i Ministrave, por ka dhe referime që duhet t’i marrin institucionet e tjera, si Këshilli i Lartë i Prokurorisë etj. Sipas rregullit kushtetues është që ligji duhet të përmbajë saktësisht kush duhet të bëjë çfarë dhe brenda të cilit afat. Pra, këtu duhet të jemi të përcaktuar. Duke kaluar në të gjithë ligjin duhet të nxjerrim konkretisht duke iu referuar paragrafëve të çdo neni se çfarë do të bëjë Këshilli i Ministrave, brenda të cilës periudhë.

Fatmir Xhafaj – Para nenit 61, siç është dispozita kalimtare, krijohet, hartohet një ligj i ri, aktet nënligjore, ku në parashikim të Kushtetutës listohen të gjitha aktet, nenet për të cilat do të nxirret një akt, në bazë në zbatim të të cilit do të nxirret akti dhe institucioni që do të nxjerrë aktin përkatës. Dhe pastaj do të vijnë dispozitat kalimtare. Me dispozitat kalimtare jeni të qetë me shqetësimin që është ngritur edhe nga Gjykata e Krimeve të Rënda?

Arben Rakipi - Çështja e dispozitave kalimtare. Do ta filloj nga pika 5 lidhur me 300-ditëshin, unë mendoj se hyrja në fuqi varet shumë nga aktiviteti i përditshëm dhe do të varet shumë nga procesi i vetingut dhe i emërimit të personave që nuk e kam idenë sa zgjasin. Mbase do të ishte mirë që në vend të 300-ditëshit të referonim një afat i cili të lidhë pikërisht me përfundimin e këtyre dy proceseve bazike.

Fatmir Xhafaj – Dakord. A do të bëni vetë ju një rishikim, një diskutim për ta kuptuar me kolegët? Që lidhen me ligjin tjetër?

Arben Rakipi – Ndërsa për çështjet aktuale që u tha për letrën kjo është një gjë që mbase del nga kompetenca jonë për ta vlerësuar, por kjo është një gjë që duhet bërë, është një gjë e madhe që fillon nga e para. Rrjedhimisht gjyqtarët dhe prokurorët që punojnë në këto struktura aktuale do të kalojnë të gjithë në këtë proces.

Fatmir Xhafaj – Gjithsesi ngelet për t'u riformuluar neni 61, duke parë në konsideratë sa qëndrojnë dhe shqetësimet që janë ngritur nga gjyqtarët e Gjykatës së Krimeve të Rënda për të reflektuar nëse ka diçka që duhet të reflektohet në ligj. Jam dakord me zotin Rakipi. Nuk ka rëndësi se çfarë je, prokuror i Prokurorisë së Krimeve të Rënda, gjyqtar i Gjykatës të Krimeve të Rënda, do t'i nënshtrohesh vetingut, vlerësimit. Po që se do ta meritojë kushdo, le të jetë pjesë e kësaj strukture shumë të rëndësishme dhe gjithashtu me shumë përgjegjësi.

Dakord.

E mbyllim dhe nenin e fundit të këtij procesi kaq të gjatë të shqyrtimit nen për nen të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”. Besoj se është bërë një punë e mirë, pak intensive, me pak debat, por gjithmonë në funksion të qëllimit të mirë, të përbashkët, për të nxjerrë një ligj të mirë, efikas dhe jetëgjatë, natyrisht të kuptueshëm dhe të zbatueshëm nga organet përgjegjëse ligjzbatuese.

Unë dëshiroj të falënderoj shumë për zemërisht ekipin e ekspertëve të nivelit të lartë që ka punuar me këtë projektligj, i cili është një risi në vetvete si pjesë e reformës në drejtësi. Është një ligj që mirëpritet jo thjesht nga ne këtu që e mbështesim, por, në radhë të parë, nga qytetarët

shqiptarë, sepse është ndër ato ligje ku shpresojmë t'i japë fund një dukurie në mënyrë të veçantë jo vetëm intensitetit dhe cilësisë së luftës kundër kimit të organizuar, por veçanërisht luftës kundër korrupsionit, sidomos korrupsionit të zyrtarëve të lartë.

Dëshiroj të falënderoj zotin Smibert për punën shumë të përkushtuar që ka bërë në këtë proces. Kemi gjëra që në të shumtën e rasteve na bashkojnë me këtë ligj, qoftë qëllimi, qoftë mënyra si janë thënë gjërat. Gjërat që na ndajnë janë gjëra shumë të vogla, janë gjëra teknike që unë besoj se do të reflektohen në ditët në vijim. Gjithsesi është bërë një punë shumë e mirë dhe meriton një vlerësim jo thjesht vlerësimin tim si kryetar i komisionit, por edhe të kolegëve deputetë me të cilët kam pasur rast të ndaj këtë opinion gjatë këtyre ditëve.

Dëshiroj të vlerësoj, gjithashtu, rolin dhe kontributin e zonjës Bumçi, kontributin e zotit Rakipi dhe të gjithë kolegëve të tjerë, ekspertë të nivelit të lartë që janë angazhuar në këtë proces, për aq sa kanë qenë të përfshirë.

Gjithashtu, dua të falënderoj bashkëpunëtorët tuaj të sekretariatit teknik, stafet tuaja që kanë bërë një punë shumë intensive, shumë serioze, si dhe përgjegjësinë tyre për ta vazhduar ende këtë gjë deri në momentin e votimit nën për nën. Ata kanë një përgjegjësi specifike për t'i zbardhur me shumë kujdes të gjitha këto çfarë u trajtuan sot.

Natyrisht një falënderim i shkon edhe të gjithë atyre që kanë marrë pjesë në tryezat publike, apo që kanë qenë pjesë e grupit të *think tank*-eve të këtij proces, apo ata që kanë dhënë kontribute përmes komunikimit *online* lidhur me përmbajtjen e këtij projektligji.

Edhe një herë faleminderit të gjithëve që ishit sot këtu! Faleminderit edhe dy zonjave simpatike të përkthimit që për orë të tëra veshët e tyre janë bërë copë! Faleminderit teknikës, si dhe stafit tonë!

Ditën e premte do të mbledhemi në orën 10:00 për projektligjet që janë në vazhdim dhe konkretisht projektligji “Për organet e mirëqeverisjes”.

Mirupafshim!

MBYLLET MBLEDHJA

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga stafi teknik i angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë